



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport për auditimin e ushtruar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“Auditim i përputhshmërisë” në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit

Tiranë, qershor 2026

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore.....	4
3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit	6
II. HYRJA	10
1. Objektivat dhe qëllimi.....	10
2. Identifikimi i çështjes.....	10
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	11
4. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:	11
5. Kriteret e vlerësimit	11
6. Standardet e auditimit	12
7. Metodot e auditimit	12
8. Dokumentimi i auditimit.....	13
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	13
1. Informacion i Përgjithshëm mbi subjektin.....	13
2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.	13
2.1 Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit	13
2.2 Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.....	41
2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare	48
2.4 Auditimi i prokurimeve të fondeve publike.....	54
2.5 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.....	96

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

a. Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 1232/1 prot., datë 23.10.2024, i ndryshuar, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditori Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK), për periudhën 01.10.2017 deri me datën 30.09.2024.

b. Përshkrim i shkurtër i institucionit ku është e mundur të specifikohet dhe buxheti:

Komisioni i Pavarur i Kualifikimi është një institucion Kushtetues, një nga tre institucionet e Rivlerësimit, i krijuar pas ndryshimeve të vitit 2016, si pjesë e Paketës Ligjore për Reformën në Drejtësi. Puna e institucionit bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Institucioni përbëhet nga dymbëdhjetë komisionerë të cilët janë përzgjedhur nga Kuvendi me Vendim më datën 17 qershor 2017 si dhe nga stafi administrativ dhe ndihmës.

Afati kushtetues i funksionimit për këtë institucion të përkohshëm është pesë vite, afat i cili është shtyrë me 2 vite në bazë të rishikimeve Kushtetuese dhe bazuar në nenin 179/b KPK mbaron detyrimin kushtetues të funksionimit në 31.12.2024, për rrjedhojë edhe aktiviteti financiar i mbylljes së institucionit si rregull duhet të përkohet me këtë datë.

Referuar nenit 179/b, pika 8, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë mandati i anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit përfundon në datën 31.12.2024.

Shpenzimet për paga, sigurime, mallra dhe shërbime, si dhe investime (llogaria 600; 601; 602; 606 dhe 231) mbulohet me financim të brendshëm nga fondet buxhetore, Referuar Ligjit nr. 84/2016 “Për Rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” neni 19 “Buxheti i institucioneve të rivlerësimit” pika 1, ku përcaktohet se “*Buxheti i institucioneve të rivlerësimit financohet nga Buxheti i Shtetit, në të cilin ato pasqyrohen si institucione të veçanta*”.

Struktura buxhetore e KPK për hartimin e PBA-së paraqitet në një program, me kod buxhetor 03330 “Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

c. Rëndësia e auditimit.

Rëndësia e auditimit të përputhshmërisë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për periudhën e aktivitetit nga krijimi i këtij institucioni e deri me 30.09.2024, konsiston në faktin se KPK krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor i cili dikton kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore, ku KPK është subjekt i auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, por edhe në faktin se referuar nenit 179/b, pika 8 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përfundoi mandatin kushtetues në datën 31.12.2024.

d. Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i këtij auditimi ishte dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën e auditimit nga data 01.10.2017 deri me datën 30.09.2024.

Për të gjitha problematikat e konstatuara grupi i auditimit ka dalë me konkluzionet përkatëse, referuar çështjeve të trajtuara si më poshtë:

1) Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit.

- Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.
- Realizimi i planit të buxhetit.
- Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore.

2) Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.

3) Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

4) Prokurimet e fondeve publike:

- Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik. (2017-2024/09).
- Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave/punëve dhe shërbimeve.

5) Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

e. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave.

Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nga grupi i auditimit është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash, në aspektin sasior dhe cilësor.

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve. Zgjedhja i transaksioneve të kryera përgjatë vitit 2017-2024 është bërë bazuar në ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit” dhe ISSAI 1530 “Shënime praktike mbi ISA 530”.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme si: *Kontrolli aritmetik, Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët, Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve, Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.*, të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

f. Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se KPK-ja për periudhën në auditim nga 01.10.2017 deri me 30.09.2024, në opinionin tonë, kemi konstatuar se veprimtaria e institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në përgjithësi është kryer në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore

- Nga auditimi i hartimit dhe zbatimit të buxhetit të shtetit u konstatua se, PBA-të e përgatitura nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit në të dy fazat strategjike dhe teknike janë paraqitur kërkesa buxhetore në tejkallim të tavanit të miratuar. Gjithashtu, kërkesat shtesë buxhetore kanë ndryshuar nga faza strategjike në fazën teknike, duke ndryshuar vlerat e politikave, pa argumentuar dhe analizuar këto ndryshime, për të cilat nuk ka argumente dhe një analizë pse kanë ndryshuar kërkesat, si dhe indikatorët të qartë mbi përlllogaritjen e kërkesave shtesë të bëra nga KPK-ja, në fazën teknike. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” pika 3 “Hapat ndër-institucionale për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm”.

- Nga analiza e zërave të investimeve të parashikuara në PBA ka mospërputhje të ndarjes mes politikave të reja dhe atyre ekzistuese, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” pika 4.5 “Hapat për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit” paragrafi 3.4 “Ndarja e kërkesave buxhetore sipas politikave ekzistuese dhe politikave të reja”, si dhe udhëzimet plotësuese vjetore “Për përgatitjen e dokumenteve të PBA-së”, pika 3.

- Nga auditimi zbatimi i buxhetit të shtetit u konstatua se, KPK në fund të vitit ushtrimor 2023 nuk ka raportuar detyrimet e prapambetura në lidhje me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të akumuluar në vlerën 43,842,082 lekë, të krijuara si rezultat i zbatimit të vendimit të

Gjykatës Kushtetuese nr. 35, datë 22.11.2022, si dhe vlerën prej 7,450,951 lekë, e cila ka të bëjë me vlerën neto të pagave, sipas përlllogaritjes së detyrimeve për periudhën shtator 2022 - dhjetor 2022. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme” paragrafi III “Përgjegjësitë e strukturave përfshirëse për raportim dhe publikim”; me udhëzimin nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, si dhe Udhëzimin të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 58 dhe 186.

- Nga auditimi me përzgjedhje i procedurave të prokurimit për periudhën e auditimit, u konstatuan parregullsi të vogla por jo materiale, kryesisht në dokumentimin e procesit dhe devijime procedurale në fazat e ndryshme të procesit, si hartimi i nevojave, përlllogaritja e fondit limit, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, si dhe zbatimi i kontratave dhe marrja në dorëzim e furnizimeve dhe shërbimeve. Përkatësisht:

- Jo të gjitha procedurat e prokurimit të kryera nga/ për llogari të KPK ishin të pasqyruara në Regjistrat e realizimit të procedurave të prokurimit publik, për vitet përkatëse, në mospërputhje me nenin 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, Udhëzimin e APP nr. 2, datë 27.01.2015 (për sa kohë ka qenë në fuqi) dhe Udhëzimin e APP nr. 04, datë 18.06.2021, mbi hartimin e regjistratit të parashikimeve dhe të realizimeve;
- Praktikë e procedurave të prokurimit ishin të painventarizuara dhe të paarkivuara, duke riskuar dëmtimin dhe humbjen e dokumentacionit, në kundërshtim me nenin 21 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”;
- Në 5 raste, KPK nuk ka dokumentuar mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit për procedurën e prokurimit, në mospërputhje me nenin 59, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, nenin 2, pika 2, gërma ç (për sa kohë ka qenë në fuqi) dhe nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021;
- Në 8 raste, KPK nuk ka argumentuar teknikisht kriteret e kualifikimit të vendosura, në mospërputhje me nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, nenin 78, pika 2, dhe nenin 2, pika 2, gërma c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021;
- Në 4 raste, KPK nuk ka dokumentuar ofertën e skualifikuar, duke mos administruar dhe bërë pjesë të praktikës dokumentacionin fizik të paraqitur nga OE dhe procesverbalin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës së skualifikuar, në mospërputhje me nenin 12, pika 2, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, si dhe nenin 2, pika 2, gërma ë (për sa kohë ka qenë në fuqi), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021;
- Në 14 raste, marrja në dorëzim e furnizimit/ shërbimit nuk është kryer në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, sa i përket (i) përbërjes së Komisionit të marrjes në dorëzim ose (ii) administrimit të dokumentacionit shoqërues të mallrave të furnizuara.

- Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave rezultoi se:

- KPK nuk ka hartuar një procedurë të shkruar, sa i përket rekrutimit të punonjësve administrativë, për të përcaktuar hapat dhe elementët proceduralë që do të ndiqeshin për këtë kategori punonjësish.
- KPK nuk ka hartuar një procedurë të shkruar, sa i përket veprimtarisë së komitetit Ad-Hoc për administrimin e procesit të emërimeve në KPK, në mbështetje të nenit 179/b e të aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 3, të nenit 69, pikës 3 dhe 4 të nenit 18, pikës 1, 2 të nenit 22 dhe gërmës dh) të nenit 21 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të pikës 1 të nenit 9 dhe të nenit 22 të rregullores për veprimtarinë e komisionit të pavarur të kualifikimit, si dhe në zbatim të përcaktimeve të Manualit Financiar dhe Kontrollit.

3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

Mbështetur në ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, për periudhën 01.10.2017 deri në 30.09.2024, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të kriterëve të vlerësimit, përfshirë kuadrin ligjor dhe rregullativ që lidhet dhe ndikon në përdorimin e fondeve/ burimeve të këtij institucioni.

Auditimi është kryer nëpërmjet zbatimit të procedurave të përcaktuara, me qëllim sigurimin e evidencave të nevojshme për vlerësimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë së ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e këtij konkluzioni.

Bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e subjektit Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, rezultuan mangësi referuar kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si vijon:

1. Nga auditimi i hartimit dhe zbatimit të buxhetit të shtetit u konstatua se, në dokumentet e PBA-së të përgatitura nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në të dy fazat strategjike dhe teknike janë paraqitur kërkesa buxhetore në tejkalim të tavanit të miratuar. Gjithashtu, kërkesat shtesë buxhetore kanë ndryshuar nga faza strategjike në fazën teknike, duke ndryshuar vlerat e politikave, pa argumentuar dhe analizuar këto ndryshime, arsyet pse kanë ndryshuar kërkesat, apo paraqitjen e indikatorëve të qartë mbi përlllogaritjen e kërkesave shtesë të bëra nga KPK-ja, në fazën teknike.

- Nga analiza e zërave të investimeve të parashikuara në PBA ka mospërputhje të ndarjes mes politikave të reja dhe atyre ekzistuese.

- Nga auditimi i zbatimit të buxhetit të shtetit u konstatua se, KPK në fund të vitit ushtrimor 2023 nuk ka raportuar detyrimet e prapambetura në lidhje me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të akumuluar në vlerën 43,842,082 lekë, të krijuara si rezultat i zbatimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 35, date 22.11.2022, si dhe vlerën prej 7,450,951 lekë, e cila ka të bëjë me vlerën neto të pagave, sipas përlllogaritjes së detyrimeve për periudhën shtator 2022 - dhjetor 2022.

Gjatë periudhës 2022–2024, buxheti i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ka pësuar një sërë ndryshimesh të ndjeshme, të reflektuara kryesisht në zërin "Paga dhe sigurime" (artikujt 600 dhe 601), të cilat kanë ardhur si rrjedhojë e:

- Vendimit nr. 36/2022 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 93/2017, "Këshilltari ligjor dhe ekonomik të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas rastit, përfitojnë një pagesë shtesë për shkak të vështirësisë në punë. Pagesa shtesë është jo më shumë se 3 paga mujore dhe jepet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të mbledhjes së anëtareve të Komisionit", i cili parashikonte pagesë shtesë për vështirësinë në punë", dhe që ka sjellë nevojë për fonde të reja.

- Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 35, date 22.11.2022, e cila ka detyruar rishikimin dhe korrigjimin e strukturës së pagave për magistratët dhe këshilltarët ligjorë, me efekt prapaveprues që nga viti 2017.

- Ligjit nr. 33/2023 “Për një ndryshim të ligjit 99/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme, në disa institucione të administratës publike”, të cilat kanë sjellë rritje të pagave dhe përmirësim të trajtimit financiar të punonjësve të administratës publike.

2. Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës rezultoi se:

- KPK nuk ka hartuar një procedurë të shkruar, sa i përket rekrutimit të punonjësve administrativë, për të përcaktuar hapat dhe elementët proceduralë që do të ndiqeshin për këtë kategori punonjësish.

- KPK nuk ka hartuar një procedurë të shkruar, sa i përket veprimtarisë së komitetit Ad-Hoc për administrimin e procesit të emërimeve në KPK, në mbështetje të nenit 179/b e të aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 3, të nenit 69, pikës 3 dhe 4 të nenit 18, pikës 1, 2 të nenit 22 dhe germës dh) të nenit 21 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të pikës 1 të nenit 9 dhe të nenit 22 të rregullores për veprimtarinë e komisionit të pavarur të kualifikimit, si dhe në zbatim të përcaktimeve të Manualit Financiar dhe Kontrollit.

3. Nga auditimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Nga auditimi i dietave brenda vendit u konstatua se pagesat e dietave janë kryer në shumicën e rasteve pas muajit gusht 2018 referuar VKM Nr.158, datë 25.04.2002 “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 404, datë 24.10.1991 “Për trajtimin e personaliteteve të larta shtetërore” në ndryshimet përkatëse, si dhe për caktimin e dietës ditore të ministrave, zëvendësministrave dhe personave të tjerë, të barazuar me ta”, i cili është mbështetur në Ligjin Nr.8379, datë 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar ligj i cili është shfuqizuar nga Ligji Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Për sa më sipër, përlllogaritja e dietave nuk është realizuar bazuar VKM-së Nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar, ku dhe në kapitullin VIII është përcaktuar së Vendimi Nr.228, datë 13.4.2001 i Këshillit të Ministrave “Për dietat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre” të ndryshuar, si edhe çdo vendim apo akt tjetër që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen, të cilat kanë rezultuar me një diferencë për të gjithë periudhën nën auditimit me një efekt financiar në vlerën prej 262,200 lekë .

4. Nga auditimi me përzgjedhje i procedurave të prokurimit për periudhën e auditimit, u konstatuan parregullsi, kryesisht në dokumentimin e procesit dhe devijime procedurale në fazat e ndryshme të procesit si: hartimi i nevojave, përlllogaritja e fondit limit, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, si dhe zbatimi i kontratave dhe marrja në dorëzim e furnizimeve dhe shërbimeve, përkatësisht:

- Jo të gjitha procedurat e prokurimit të kryera nga/ për llogari të KPK ishin të pasqyruara në regjistrat e realizimit të procedurave të prokurimit publik, për vitet përkatëse, në mospërputhje me nenin 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, Udhëzimin e APP nr. 2, datë 27.01.2015 (për sa kohë ka qenë në fuqi) dhe Udhëzimin e APP nr. 04, datë 18.06.2021, mbi hartimin e regjistrit të parashikimeve dhe të realizimeve.

- Praktikant e procedurave të prokurimit ishin të painventarizuara dhe të paarkivuara, duke riskuar dëmtimin dhe humbjen e dokumentacionit, në kundërshtim me nenin 21 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

- Nuk është dokumentuar mënyra e përlllogaritjes së fondit limit për procedurën e prokurimit, në mospërputhje me nenin 59, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, (për sa kohë ka qenë në fuqi) dhe nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, konkretisht:

Për vitin 2018, procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt (i) “Blerje televizorësh”, me fond limit 500,000 lekë pa TVSH.

Për vitin 2019, procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt (i) “Shpenzime për mobilim zyre”, me fond limit 700,000 lekë pa TVSH; (ii) “Blerje kancelari”, me fond limit 800,000 lekë pa TVSH.

Për vitin 2020, procedurat e prokurimit me vlerë të vogël me objekt (i) “Blerje maska dhe doreza në kuadër të masave mbrojtëse për shëndetin Anti - Covid, për anëtarët e Komisionit dhe stafin e tij, për vitin 2020”, me fond limit 795,000 lekë pa TVSH; (ii) “Blerje covers (kapuçë/ mbështjellës) një përdorimesh për mikrofonat dhe kufje të seancave publike që zhvillon KPK, për vitin 2020”, me fond limit 798,750 lekë pa TVSH.

-Nuk janë argumentuar teknikisht kriteret e kualifikimit të vendosura, në mospërputhje me nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 dhe nenin 2, pika 2, germa c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, konkretisht:

Për vitin 2019, procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt (i) “Riparim (mirëmbajtje) pajisjesh elektronike”, me fond limit 600,000 lekë pa TVSH (*procedurë e anuluar për shkak të pandemisë COVID*); (ii) “Mirëmbajtje e pajisjeve elektronike”, me fond limit 200,000 lekë pa TVSH

Për vitin 2020, procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt (i) “Shpenzime orendi zyre”, me fond limit 450,000 lekë pa TVSH; “Blerje pjesë ndërrimi për fotokopje drum, fuser, roller, etj.”, me fond limit 800,000 lekë pa TVSH.

Për vitin 2023, procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt (i) “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve elektronike”, me fond limit 998,800 lekë pa TVSH; (ii) “Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës”, me fond limit 691,167 lekë pa TVSH; (iii) “Blerje tonerash për printera”, me fond limit 997,462 lekë pa TVSH.

Për vitin 2024, procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt (i) “Blerje tonerash për fotokopje”, me fond limit 274,470 lekë pa TVSH.

- Nuk është dokumentuar oferta e skualifikuar, duke mos administruar dhe bërë pjesë të praktikës dokumentacionin fizik të paraqitur nga O.E dhe procesverbalin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës së skualifikuar, në mospërputhje me nenin 12, pika 2, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, nenin 2, pika 2, germa e (për sa kohë ka qenë në fuqi), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, konkretisht:

Për vitin 2019, procedurat e prokurimit me vlerë të vogël me objekt (i) “Mobilim zyrash (karrige zyre profesionale)”, me fond limit 252,000 lekë pa TVSH; (ii) “Riparim (mirëmbajtje) pajisjesh elektronike”, me fond limit 600,000 lekë pa TVSH (*procedurë e anuluar për shkak të pandemisë COVID*).

Për vitin 2020, procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje pjesë ndërrimi për fotokopje drum, fuser, roller, etj.”, me fond limit 800,000 lekë pa TVSH.

Për vitin 2024, procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje SSD, sata cable, USB 3.0 docking dhe RAM 8GB DD R4-2400 Mhz”, me fond limit 175,547 lekë pa TVSH.

-Marrja në dorëzim e furnizimit/ shërbimit nuk është kryer në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, sa i përket (i) përbërjes së Komisionit të Marrjes në Dorëzim ose (ii) administrimit të dokumentacionit shoqërues të mallrave të furnizuara, si më poshtë:

Për vitin 2018

- Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje rafte metalike për arkivën”, me fond limit 333,333 lekë pa TVSH, bashkëlidhur procedurës mungon procesverbali i marrjes në dorëzim të mallrave me O.E “GP” sh.p.k me vlerë kontrate të lidhur prej 345,600 lekë, veprime në kundërshtim me paragrafin 37.

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje bojë për fotokopje”, me fond limit 150,000 lekë pa TVSH, bashkëlidhur procedurës mungon procesverbali i marrjes në dorëzim të mallrave me O.E “K” sh.p.k me vlerë kontrate të lidhur prej 153,360 lekë, veprime në kundërshtim me paragrafin 37.

-Në zbatimin e kontratës me objekt Loti III “Blerje auto veturë me kalueshmëri të lartë SUV për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, me vlerë kontrate të lidhur prej 3,240,000 lekë me

TVSH me O.E “HAA” sh.p.k, në komisionin e marrjes në dorëzim nuk ka në përbërje specialist fushe veprime në kundërshtim me paragrafin 43.

Për vitin 2019

-Në procedurën e prokurimit me objekt “*Mirëmbajtje e pajisjeve elektronike*”, me fond limit 200,000 lekë pa TVSH, bashkëlidhur procedurës mungon procesverbali i marrjes në dorëzim të artikujt/ shërbimi me OE “A” sh.p.k me vlerë kontrate të lidhur prej 232,800 lekë, veprime në kundërshtim me paragrafin 37.

-Në zbatimin e kontratës me objekt “Blerje tonerash për printera”, me vlerë kontrate të lidhur prej 6,091,200 lekë me TVSH, me OE “IO” sh.p.k, në komisionin e marrjes në dorëzim nuk ka në përbërje specialist fushe veprime në kundërshtim me paragrafin 43 si dhe ky komision nuk shprehet mbi cilësinë e mallrave të furnizuar dhe nuk ka administruar dokumentacionin shoqërues të tyre në kundërshtim me paragrafin 42.

-Në zbatimin e kontratës me objekt “*Shpenzime për blerje pajisje elektronike*”, për vitin 2019, me vlerë kontrate të lidhur prej 1,417,800 lekë me TVSH, me OE “C.C.S” sh.p.k, proces verbali i marrjes në dorëzim bashkëlidhur U.SH është nënshkruar nga një punonjës i KPK dhe një përfaqësues i OE dhe i AKSHIT, dhe jo nga komisioni i marrjes në dorëzim.

Për vitin 2020

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje maska dhe doreza në kuadër të masave mbrojtëse për shëndetin Anti - Covid, për anëtarët e Komisionit dhe stafin e tij, për vitin 2020”, me fond limit 795,000 lekë pa TVSH, me OE “AM” me vlerë kontrate të lidhur prej 547,200 lekë, komisioni marrjes në dorëzim nuk ka administruar dokumentacionin shoqërues të artikujve në kundërshtim me paragrafin 42.

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pjesë ndërrimi për fotokopje drum, fuser, roller, etj.”, me fond limit 800,000 lekë pa TVSH, me OE “EH” me vlerë kontrate të lidhur prej 892,800 lekë, komisioni marrjes në dorëzim nuk ka administruar dokumentacionin shoqërues të artikujve në kundërshtim me paragrafin 42.

-Në zbatimin e kontratës me objekt “Shpenzime për blerje kompjuterësh”, me vlerë kontrate të lidhur prej 1,382,400 lekë me TVSH, me BOE “IS&GJK” sh.p.k, në komisionin e marrjes në dorëzim nuk ka në përbërje specialist fushe veprime në kundërshtim me paragrafin 43 si dhe ky komision nuk shprehet mbi cilësinë e mallrave të furnizuar dhe nuk ka administruar dokumentacionin shoqërues të artikujve në kundërshtim me paragrafin 42.

Për vitin 2021

- Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kancelari të ndryshme dhe letër A4”, me fond limit 800,000 lekë pa TVSH, me OE “LD” me vlerë kontrate të lidhur prej 544,340 lekë, komisioni marrjes në dorëzim nuk ka administruar dokumentacionin shoqërues të artikujve në kundërshtim me paragrafin 42.

- Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje tonera – bojë për fotokopje”, me fond limit 225,000 lekë pa TVSH, me OE “IO” me vlerë kontrate të lidhur prej 227,600 lekë, komisioni marrjes në dorëzim nuk ka administruar dokumentacionin shoqërues të artikujve në kundërshtim me paragrafin 42.

- Në procedurën e prokurimit me objekt “*Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës*”, me fond limit 800,000 lekë pa TVSH, me OE “EH” me vlerë kontrate të lidhur prej 868,800 lekë, komisioni marrjes në dorëzim nuk ka administruar dokumentacionin shoqërues të artikujve në kundërshtim me paragrafin 42.

- Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje tonera për printer”, me fond limit 610,000 lekë pa TVSH, me OE “EH” me vlerë kontrate të lidhur prej 700,800 lekë, komisioni marrjes në dorëzim nuk ka administruar dokumentacionin shoqërues të artikujve në kundërshtim me paragrafin 42.

- Në zbatimin e kontratës me objekt “Shpenzime për blerje kompjuterësh”, me vlerë kontrate të lidhur prej 1,798,920 lekë me TVSH me OE “CCS” sh.p.k, komisioni i marrjes në dorëzim

nuk rezulton të ketë administruar dokumentacionin shoqërues të artikujve, si certifikata cilësie, certifikata origjine, raport teste, si dhe çdo dokument tjetër që shërben për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike dhe cilësinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë AK, në kundërshtim me paragrafin 42.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit me në Programin e Auditimit nr. 1232/1 prot., datë 23.10.2024, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, nga data 28.10.2024 deri më datën 21.02.2025, për periudhën e auditimit 01.10.2017 deri me datën 30.09.2024, u krye auditimi i Përputhshmërisë, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A.B, (përgjegjës grupi)
2. D.P, anëtar
3. J.G, anëtar
4. N.M, anëtar
5. R.K, anëtar
6. P.K, anëtar

1. Objektivat dhe qëllimi

Objekti i kryesor i auditimit është vlerësimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në raport me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu veprimtarinë e institucionit, procedurat e prokurimit dhe shpenzimet vjetore të institucionit. Nëpërmjet auditimit të përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të akteve ligjore e nënligjore, për periudhën e aktivitetit të audituar.

Qëllimi i auditimit është raportimi mbi konkluzionet e auditimit dhe vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga KPK-ja, gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me legjislacionin në fuqi, vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi; vlerësimi dhe evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndosh financiar, përdorimi me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike.

2. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar i Auditimit ka synuar të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësi të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që burojnë nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Fushëveprimi i këtij auditimi ka qenë vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së KPK-së, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Përputhshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive përkatëse të KPK-së, të cilat realizojnë koordinimin dhe zbatimin e strategjive që orientojnë në hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme të institucionit. Sipas përcaktimit të ISSAI 100 “*Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi*”, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit,

analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Drejtimi i KPK-së është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare dhe njerëzore në përputhje me Kushtetutën, politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

4. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia jonë është që të konkludojmë në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, procedurat e prokurimit publik dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin, me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e KPK-së është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH-së kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 *“Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”*, paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore, si më poshtë:

- Ligji nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*;
- Ligji 10296, datë 08.07.2010 *“Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, i ndryshuar;
- Udhëzimet standard të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.
- Rregullore e brendshme *“Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”*, miratuar me vendimin nr.

7, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH-së;

- Akte të tjera ligjore/nënligjore në zbatim të ligjeve të sipërcituar.

6. Standardet e auditimit

ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodat e auditimit

Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë të sektorit publik”.

- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërive ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi* është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione* janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit të përputhshmërisë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 245, datë 29.12.2022, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren dhe pas njohjes me observacionet e subjektit të audituar mbi Akt-Konstatimet e hartuara nga grupi i auditimit, u hartua dhe u dërgua pranë KPK-së Projekt Raporti i Auditimit. Në përfundim të afatit 30-ditor të parashikuar pas njohjes me Projekt Raportin e Auditimit, subjekti i audituar në këtë fazë nuk ka paraqitur observacione lidhur me konstatimet dhe qëndrimet e grupit të auditimit. Në vijim të sa më sipër, u hartua Raporti Përfundimtar i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i Përgjithshëm mbi subjektin

Komisioni i Pavarur i Kualifikimi është një institucion Kushtetues, një nga tre institucionet e Rivlerësimit, i krijuar pas ndryshimeve të vitit 2016 si pjesë e Paketës Ligjore për Reformën në Drejtësi. Puna e institucionit bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Institucioni përbëhet nga dymbëdhjetë komisionerë, të cilët janë përzgjedhur nga Kuvendi me Vendim më datën 17 qershor 2017, këshilltarët ligjorë dhe ekonomikë, si dhe nga stafi administrativ.

Afati kushtetues fillestar i funksionimit të këtij institucioni të përkohshëm ishte pesë vite, i shtyrë me 2 vite në bazë të rishikimeve Kushtetuese dhe bazuar në nenin 179/b, deri në 31.12.2024, për rrjedhojë edhe aktiviteti i mbylljes së institucionit si rregull duhet të përkohë me këtë datë.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1 Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- Programet Buxhetore Afatmesëm;

- Projektbuxheti për vitin 2017-2024, si dhe shkresat e ndryshimit të buxhetit gjatë vitit ushtritor;
- Raportet e monitorimit 4, 8 dhe 12-mujore të realizimit të buxhetit.

a. Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Shpenzimet për paga, sigurime, mallra dhe shërbime, si dhe investime (llogaria 600; 601; 602; 606 dhe 231) mbulohet me financim të brendshëm nga fondet buxhetore, Referuar Ligjit nr. 84/2016 “Për Rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” neni 19 “Buxheti i institucioneve të rivlerësimit” pika 1, ku përcaktohet se “*Buxheti i institucioneve të rivlerësimit financohet nga Buxheti i Shtetit, në të cilin ato pasqyrohen si institucione të veçanta*”.

Struktura buxhetore e KPK për hartimin e PBA-së paraqitet në një program, me kod buxhetor 03330 “Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

Planifikimi buxhetor i vitit 2019-2021

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dërguar kërkesat për “Projekt Buxhetin për vitin 2019-2021”, mbështetur në formatin udhëzues për kryerjen e parashikimit të shpenzimeve si dhe zbatim të VKM-së nr.128, datë 07.3.2018 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021”, si dhe Udhëzimit nr. 7/1, datë 28.02.2018 “Për programit buxhetor afatmesëm 2019-2021”.

Me shkresën nr. 3699, datë 25.04.2018, KPK ka dërguar në MFE “Programi buxhetor afatmesëm” (faza e parë/ strategjike).

Nga KPK bazuar në tavanet e përgatitore janë paraqitur kërkesa të shtuara buxhetore në politikat ekzistuese por dhe në politikat e reja.

- Në lidhje me kërkesat shtesë përtej tavanëve për politikat ekzistuese nga KPK:

Për Artikulli 606 & 601 “Paga dhe sigurime” është kërkuar rritje në vlerën 65,352 mijë lekë, si rezultat i planifikimit të rritjes së personeli prej 10 punonjësish.

- Për Artikulli 231 “Shpenzime për investime” është kërkuar rritje në vlerën 4,000 mijë lekë, si rezultat i planifikimit të rritjes investimeve në lidhje me blerje pajisjesh dhe shpenzimeve për rikonstrukcion.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II^{të} të PBA 2019-2021

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 janë miratuar me VKM-në nr. 476/2018 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021”, ku për KPK nuk ka pasur ndryshime me tavanet fillestare, edhe pse nga KPK ka pasur kërkesa shtesë si për shpenzimet ekzistuese dhe për ato të reja, për të tre vitet 2019-2021.

- Në lidhje me kërkesat shtesë përtej tavanëve për politikat e reja nga KPK:

Për Artikulli 606 & 601 “Paga dhe sigurime” është kërkuar rritje në vlerën 30,00 mijë lekë, si rezultat i planifikimit të rritjes së personeli prej 16 punonjësish dhe rrjedhimisht dhe rritje të llogarisë 601 në vlerën 3,600 mijë lekë.

Me shkresën nr. 5736 prot., datë 09.08.2018 të KPK janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit të vitit 2019 dhe relacioni shoqërues në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, pra brenda afatit dhe sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin plotësues nr.7/2, datë 09.07.2018 “Për përgatitjen e PBA 2019-2021”.

Planifikimi buxhetor i vitit 2020-2022 faza e parë.

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dërguar kërkesat për “Projekt Buxhetin për vitin 2020-2022”, mbështetur në formatin udhëzues për kryerjen e parashikimit të shpenzimeve si dhe zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 13.03.2019 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022”, si dhe Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2019 “Për programit buxhetor afatmesëm 2020-2022”.

Me shkresën nr. 2519/4, datë 26.04.2021, KPK ka dërguar në MFE “Programi buxhetor afatmesëm” (faza e parë/ strategjike).

Nga KPK bazuar në tavanet e përgatitore janë paraqitur kërkesa të shtuara buxhetore në politikat ekzistuese.

Në lidhje me kërkesat shtesë përtej tavanëve për politikat ekzistuese KPK:

- Për Artikulli 606&601 “Paga dhe sigurime” kërkohet rritje në vlerën 35,300 mijë lekë.

Pasi nga KPK është planifikuar dhe marrë në konsideratë si pjesë e pagës bruto edhe pagesa e vjetërsisë për Këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor (KNJSHL), si dhe është planifikuar dhënia e dy pagesave në vit për vështirësi (sipas ligjit 84/2016 me dy paga mujore bruto) për KNJSHL, pagesa e orëve jashtë orarit zyrtar për KNJSHL, dhe Stafin Administrativ .

- Për Artikulli 602, “Mallra dhe shërbime te tjera”, kërkohet rritje prej 960 mijë lekë, vlerë e cila është përlllogaritur duke marrë parasysh fondin buxhetor për të njëjtin artikull për vitin 2019, rregulluar me normën e inflacionit (3%) .

- Për Artikulli 231 “Investime”, kërkohet rritje prej 2,000 mijë lekë, për “Blerje pajisje orendi zyre dhe kompjuterike”.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II^{të} të PBA 2020-2022

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 janë miratuar me VKM-në nr. 523, datë 25.7.2019 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2020-2022”, ku për KPK ka pasur ndryshime me tavanet fillestare, në zërin “Investime” nga 2,000 mijë lekë në 4,000 mijë lekë.

Nga KPK në këtë fazë është bërë ndryshimi i formatit nr. 3, ku kërkesat e bëra në fazën e parë kanë kaluar si politika të reja.

Me shkresën nr. 5356/3, datë 02.09.2019, KPK ka dërguar në MFE “Programi buxhetor afatmesëm” (faza e II/ teknike).

Bashkëlidhur PBA-së në të dy fazat mungojnë Shtojcat nr.1/A; Pasqyra nr.1 “Të ardhurat e veta”; Pasqyra nr.2, pasqyra nr.2/1, si dhe pasqyra nr.2/2 “Buxheti 2020, Buxheti 2021, Buxheti 2022”; Pasqyra nr.3 “Përmbledhëse e pagave”; Pasqyra nr. 4 “Numri i Punonjësve”; Pasqyra nr.5, “Shpenzimet mujore për grup artikull”.

Planifikimi buxhetor i vitit 2021-2023.

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dërguar kërkesat për “Projekt Buxhetin për vitin 2021-2022”, mbështetur në formatin udhëzues për kryerjen e parashikimit të shpenzimeve si dhe zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave VKM-në nr. 577, datë 22.07.2020 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023”, si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021-

2023”.

Me shkresën nr. 5562, datë 25.08.2020, KPK ka dërguar në MFE “Programi buxhetor afatmesëm”.

Nga KPK bazuar në tavanet e përgatitore janë paraqitur kërkesa të shtuara buxhetore;

Në lidhje me kërkesat shtesë përtej taveve për **politikat të reja** KPK:

- Për Artikulli 606&601 “Paga dhe sigurime” kërkohet rritje në vlerën 28,340 mijë lekë.

Pasi nga KPK është planifikuar dhe marrë në konsideratë si pjesë e pagës bruto edhe pagesa e vjetërsisë për Këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor (KNJSHL), si dhe është planifikuar dhënia e dy pagesave në vit për vështirësi (sipas ligjit 84/2016 me dy paga mujore bruto) për KNJSHL, pagesa e orëve jashtë orarit zyrtar për KNJSHL, dhe Stafin Administrativ .

- Për Artikulli 231 “Investime”, kërkohet rritje prej 2,000 mijë lekë, për “Blerje pajisje orendi zyre dhe kompjuterike”.

Planifikimi buxhetor i vitit 2022-2024

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dërguar kërkesat për “Projekt Buxhetin për vitin 2022-2024”, mbështetur në formatin udhëzues për kryerjen e parashikimit të shpenzimeve si dhe zbatim të VKM nr. 119, datë 03.03.2021 “Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024” dhe Udhëzimit nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.

Me shkresën nr. 3128, datë 12.04.2021, KPK ka dërguar në MFE “Mbi dorëzimin e kërkesave të programit Buxhetor Afatmesëm 2022 – 2024” (faza e parë/ strategjike).

Nga KPK bazuar në tavanet e përgatitore janë paraqitur kërkesa të shtuara buxhetore në politikat ekzistuese por dhe në politikat e reja.

Në lidhje me kërkesat shtesë përtej taveve për **politikat e reja**:

- Për Artikulli 606&601 “Paga dhe sigurime” kërkohet rritje në vlerën 21,800 mijë lekë.

Nga KPK janë bërë kërkesa shtesë duke krahasuar fondin e pagave dhe sigurimeve të vitit paraardhës 2021 dhe taveve të miratuara me VKM nr. 119, datë 03.03.2021.

- Për Artikulli 231 “Investime”, kërkohet rritje prej 3,000 mijë lekë, për “Blerje pajisje orendi zyre dhe kompjuterike” nga 2,000 mijë lekë.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II^{të} të PBA 2022-2024

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 janë miratuara me VKM nr. 440, datë 22.07.2021 “Për miratimin e taveve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, ku për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit ka pasur ndryshime me tavanet fillestare të miratuara me VKM-në me nr. 119, datë 03.03.2021, ku për zërin shpenzime kapitale nga fondi tavan prej 2,000 mijë lekë është pakësuar në zero lekë.

Me shkresën nr. 5934 prot., datë 30.08.2021 të KPK, janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit të vitit 2022 dhe relacioni shoqërues në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, pra brenda afatit dhe sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin plotësues nr.19, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e PBA-së 2022-2024”.

Në lidhje me kërkesat shtesë përtej taveve për **politikat e reja**

- Për Artikulli 600&601 “Paga dhe sigurime” kërkohet rritje në vlerën 53,682 mijë lekë.

Pasi nga KPK është planifikuar dhe marrë në konsideratë si pjesë e pagës bruto edhe pagesa e vjetërsisë për Këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor (KNJSHL), si dhe është planifikuar

dhënien e dy pagesave në vit për vështirësi (sipas ligjit 84/2016 me dy paga mujore bruto) për KNJSHL, pagesa e orëve jashtë orarit zyrtar për KNJSHL, dhe Stafin Administrativ .

Nga KPK është argumentuar fakti se për vitin 2021 i është akorduar fonde për paga në shumën 177,800 mijë lekë, si dhe për “Kontributet e sigurimeve” vlera e akorduar për vitin 2021 ka qenë në vlerën 15,400 lekë, vlerë e cila është përdorur 100% gjatë vitit 2021.

- Për Artikulli 231 "Investime", kërkohet rritje prej 5,000 mijë lekë, për “Blerje pajisje orendi zyre dhe kompjuterike” nga zero lekë që është sipas tavanëve të miratuara me VKM-në nr. 440, datë 22.07.2021.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I^e të PBA 2023-2025

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dërguar kërkesat për “Projekt Buxhetin për vitin 2023-2025”, mbështetur në formatin udhëzues për kryerjen e parashikimit të shpenzimeve si dhe zbatim të VKM nr. 130 datë 02.03.2022 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025” dhe Udhëzimit nr. 9, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor Afatmesëm 2023-2025”.

Me shkresën nr. 1533, datë 14.04.2022, KPK ka dërguar në MFE “Mbi dorëzimin e kërkesave të programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025” (faza e parë/ strategjike).

Nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit bazuar në tavanet e përgatitore janë paraqitur kërkesa të shtuara buxhetore në politikat ekzistuese por dhe në politikat e reja.

Në lidhje me kërkesat shtesë përtej tavanëve:

- Për Artikulli 600&601 “Paga dhe sigurime” kërkohet rritje të fondit përtej tavanëve.

Nga KPK janë bërë kërkesa shtesë duke krahasuar fondin e pagave dhe sigurimeve të vitit paraardhës 2022 dhe tavanëve të miratuar me VKM-në nr. 130 datë 02.03.2022.

Për artikulli 600 është kërkuar shtesë fondi prej 23,000 mijë lekë, ku nga KPK është argumentuar se vetëm për të mbuluar fondin e pagave të vitit 2023 duhet një shtesë prej 4,000 mijë lekë krahasuar me tavanet.

Në lidhje me kërkesat shtesë përtej tavanëve për politikat e reja:

- Për të mbuluar shpenzimet e dy pagesave në vit për vështirësi (sipas ligjit 84/2016 me dy paga mujore bruto) për KNJSHL, pagesa e orëve jashtë orarit zyrtar për KNJSHL, dhe Stafin Administrativ duhet një shtesë prej 19,000 mijë lekë, si dhe për artikulli 601 është kërkuar shtesë fondi prej 1,900 mijë lekë.

- Për artikullin 602 “Mallra dhe shërbime” është kërkuar shtesë fondi prej 6,000 mijë lekë për të mbuluar shpenzimet për vjetërsi, sipas Vendimit nr. 1653, datë 30.05.2022, Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, të drejtën dhe legjitimitetin e vjetërsisë në punë, në masë 2% të pagës referuese bazë.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës II të PBA 2023-2025

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 janë miratuar me VKM nr. 535 datë 29.07.2022 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, ku për Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka pasur ndryshime me tavanet fillestare të miratuara me VKM me nr. 130 datë 02.03.2022, si më poshtë:

000/lekë

Artikulli	Viti 2023		2024		2025	
Faza	Strategjike	Teknike	Strategjike	Teknike	Strategjike	Teknike
600-606	194,200	214,200	174,200	214,200	194,200	214,200
230-231	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000
Totali	196,200	216,200	176,200	216,200	196,200	216,200

Me shkresën nr. 3116/1 prot., datë 11.08.2022 të KPK, janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit të vitit 2023 dhe relacioni shoqërues në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, pra brenda afatit dhe sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 9, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor Afatmesëm 2023-2025”.

Nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit bazuar në tavanet e përgatitore janë paraqitur kërkesa të shtuara buxhetore në politikat në politikat e reja edhe në fazën teknike të ndryshuara nga faza strategjike përkatësisht:

Në lidhje me kërkesat shtesë përtej taveve për politikat e reja:

- Për Artikulli 600&601 “Paga dhe sigurime” kërkohet rritje të fondit përtej taveve dhe kërkesave të fazës së parë strategjike në shumë prej 97,550 mijë lekë.

Kërkesat shtesë vijë në zbatim të:

- Vendimit nr.36/2022 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.93/2017, strukturën e re dhe nivelin e pagave të 76 punonjësve të përhershëm të KPK-së” pikat I, II, III.

- Vendimit nr. 36/2022 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.93/2017, e cila sanksionon “Punonjësit e administratës të Komisionit përfitojnë shtesën mujore për natyrë të veçantë pune në masën 10% të pagës për pozicion apo të pagës bazë për klasë. Punonjësit administrativë, të cilët sipas këtij vendimi përfitojnë shtesa të tjera të së njëjtës natyre të përcaktuara në të, do të përfitojnë vetëm njërën prej shtresave, atë me vlerë më të madhe” pika V.

- Vendimit nr.27, datë 28.6.2022 të Mbledhjes së Komisionit, marrë në zbatim të vendimin nr.1653 datë 30.5.2022 të Gjykatës Administrative, e cila vendosi: “Rillogaritjen e pagës G3 të anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke përfshirë elementin e vjetërsisë në punë, në masën 2% të pagës referuese bazë, për çdo vit shërbimi në funksion, sipas nenit 12/3 të ligjit nr.96/2016”.

Si dhe në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 36/2022 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 93/2017, “Këshilltari ligjor dhe ekonomik të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas rastit, përfitojnë një pagesë shtesë për shkak të vështirësisë në punë. Pagesa shtesë është jo më shumë se 3 paga mujore dhe jepet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të mbledhjes së anëtarëve të Komisionit”.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës I të PBA-së 2024-2026

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dërguar kërkesat për “Projekt Buxhetin për vitin 2024-2026”, mbështetur në formatin udhëzues për kryerjen e parashikimit të shpenzimeve si dhe zbatim të VKM nr. 195, datë 05.04.2023 “Për miratimin e taveve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e PBA 2024-2026”.

Me shkresën nr. 1783, datë 25.04.2023, KPK ka dërguar në MFE “Mbi dorëzimin e kërkesave të programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026” (faza e parë/strategjike).

Nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit bazuar në tavanet e përgatitore janë paraqitur kërkesa të shtuara buxhetore në politikat ekzistuese por dhe në politikat e reja.

- Për Artikulli 600&601 “Paga dhe sigurime” kërkohet rritje të fondit përtej taveve dhe kërkesave të fazës së parë strategjike në shumë prej 53,270 mijë lekë.

Kërkesat shtesë vijë në zbatim të:

- Vendimit nr.36/2022 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin e Kuvendit nr.93/2017, strukturën e re dhe nivelin e pagave të 76 punonjësve të përhershëm të KPK-së" pikat I, II, III.

- Vendimit nr. 36/2022 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.93/2017, e cila sanksionon "Punonjësit e administratës të Komisionit përfitojnë shtesën mujore për natyrë të veçantë pune në masën 10% të pagës për pozicion apo të pagës bazë për klasë. Punonjësit administrativë, të cilët sipas këtij vendimi përfitojnë shtesa të tjera të së njëjtës natyre të përcaktuara në të, do të përfitojnë vetëm njëherë prej shtresave, atë me vlerë më të madhe" pika V.

- Vendimit nr.27, datë 28.6.2022 të Mbledhjes së Komisionit, marrë në zbatim të vendimin nr.1653 datë 30.5.2022 të Gjykatës Administrative, e cila vendosi: *"Rillogaritjen e pagës G3 të anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke përfshirë elementin e vjetërsisë në punë, në masën 2% të pagës referuese bazë, për çdo vit shërbimi në funksion, sipas nenit 12/3 të ligjit nr.96/2016"*.

Sipas përlllogaritjeve të realizuara nga KPK rezulton se fondi buxhetor për paga për të mbuluar nevojat për 2024 duhet të jetë në shumën prej 235,200 mijë lekë.

Si dhe në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 36/2022 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 93/2017, "Këshilltari ligjor dhe ekonomik të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas rastit, përfitojnë një pagesë shtesë për shkak të vështirësisë në punë. Pagesa shtesë është jo më shumë se 3 paga mujore dhe jepet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të mbledhjes së anëtarëve të Komisionit". Sipas përlllogaritjeve të realizuara nga KPK rezulton se fondi i munguar për të mbuluar nevojat për 2024 është në shumën prej 31,000 mijë lekë.

Për të mbuluar nevojat për 2024 për shpenzimet "Paga" kërkohet fondi shtesë në shumën prej 48,900 mijë lekë përtej tavanëve. Si rrjedhojë e vendimeve sa më sipër kërkohet fond shtesë për të mbuluar dhe shpenzimet e artikullit 601 "Sigurime" në shumën 4,370 mijë lekë.

- Gjithashtu në zbatim të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 35, datë 22.11.2022, me objekt "Shfuqizimi i nenit 12, pika 5, shkronja "a", të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar me nenin 2, pika 1, të ligjit nr. 50/2021, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë", si dhe Vendimit të Komisionit nr. 4 datë 31.1.2023, KPK ka bërë përlllogaritjet sipas viteve, ku kërkohen fonde shtesë për mbulimin e tyre në vitin 2024 si më poshtë:

Për vitin 2017 kërkohet një fond shtesë në zërin shpenzime korrente prej rreth 0.35 milion lekë; për vitin 2018, kërkohet një fond shtesë afërsisht në shumën 22,000 mijë lekë; për vitin 2019 në shumën 29,800 mijë lekë; për vitin 2020 afërsisht në shumën 28,600 lekë; për vitin 2021, kërkohet afërsisht në shumën 36,000 mijë leke; për vitin 2022, kërkohet afërsisht në shumën 38,500 mijë lekë dhe për vitin 2023, kërkohet afërsisht në shumën 53,000 mijë lekë. Fonde shtesë për mbulimin e detyrimeve për periudhën 2018-2023 janë përlllogaritur në total 208,000 mijë lekë, përkatësisht 200,900 mijë lekë për artikullin 600 dhe 7,100 mijë lekë për artikullin 601.

Fondi shtesë në total për vitet 2017 - 2023, për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, është përlllogaritur afërsisht në shumën 208,000 mijë lekë.

Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës II të PBA-së 2024-2026

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 janë miratuar me VKM nr. 456, datë 19.07.2023 *"Për miratimin e tavanëve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026"*, ku kërkesat e shtesë të kërkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në fazën strategjike nuk janë marrë parasysh. Me shkresën nr. 3483 prot., datë 21.08.2023 të KPK janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit të vitit 2024

dhe relacioni shoqërues në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, pra brenda afatit dhe sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 22, datë 07.07.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor Afatmesëm 2024-2026”.

- Për Artikulli 600&601 “Paga dhe sigurime” kërkohet rritje të fondit përtej tavanëve dhe kërkesave të fazës së parë strategjike në shumë prej 66,810 mijë lekë.

Kërkesat shtesë vijnë në zbatim të:

Ligjit 33/2023 “Për një ndryshim të ligjit 99/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar pika a “paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorëve, e cila është e njëjte me shumëzimin e koeficientit 0.36 me pagën e Presidentit të Republikës”;

- VKM-së nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabinetëve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”;

- VKM-së nr. 326, datë “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”.

- Si dhe në zbatim të pikës IV të Vendimit nr. 36/2022 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 93/2017, “Këshilltari ligjor dhe ekonomik të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas rastit, përfitojnë një pagesë shtesë për shkak të vështirësisë në punë. Pagesa shtesë është jo më shumë se 3 paga mujore dhe jepet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të mbledhjes së anëtareve të Komisionit”. Sipas përlllogaritjeve të realizuara nga KPK rezulton se fondi i munguar për të mbuluar nevojat për 2024 është në shumën prej 31,000 mijë lekë. Në total kërkohet një fond shtesë mbi tavanet për shumën prej 58,700 mijë lekë.

Si rrjedhojë e vendimeve sa më sipër kërkohet fonde shtesë për të mbuluar dhe shpenzimet e artikullit 601 “Sigurime” në shumën 8,110 mijë lekë.

Konkluzion:

- Nga grupi i auditimit u konstatua se, PBA-të e përgatitura nga KPK në të dy fazat strategjike dhe teknike janë paraqitur kërkesa buxhetore në tejkallim të tavanit të miratuar.

Gjithashtu kërkesat shtesë buxhetore kanë ndryshuar nga faza strategjike në fazën teknike, duke ndryshuar vlerat e politikave për të cilat nuk ka argumente dhe një analizë pse kanë ndryshuar kërkesat, si dhe indikatorët të qartë mbi përlllogaritjen e kërkesave shtesë të bëra nga KPK, në fazën teknike.

Kostot për njësi janë rritur nga viti në vit duke ulur sasinë e “dosjeve të shqyrtuara”, për të cilën nuk ka asnjë argument.

Sa më sipër, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” pika 3 “Hapat ndërinstitutionale për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm”, ku përcakton se:

Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm bëhet në dy faza:

- Faza e parë e përgatitjes së projekt-dokumentit të programit buxhetor afatmesëm njihet si faza strategjike:

- Vendimet më të rëndësishme në nivel strategjik dhe buxhetor, do të merren gjatë fazës strategjike dhe do të përkthehen në tavanë të qëndrueshme dhe të pandryshueshme të shpenzimeve që duhet të respektohen gjatë fazës teknike. Gjithashtu është e rëndësishme që të gjitha vendimet kryesore strategjike/prioritare për financimin e politikave të reja të merren gjatë fazës strategjike, duke përfshirë dhe vendimet për investime të reja publike.

- Faza e dytë e përgatitjes së dokumentit të rishikuar të programit buxhetor afatmesëm quhet faza teknike e përgatitjes së buxhetit (vjektor):

Duke marrë parasysh që vendimet strategjike për buxhetin afatmesëm merren gjatë fazës së parë të përgatitjes së buxhetit, **objektivi i fazës së dytë është përpunimi i detajeve teknike të**

buxhetit brenda tavanëve të qëndrueshme të shpenzimeve të vendosura gjatë fazës strategjike. Objektivi kryesor i kësaj faze është të sigurojë që vendimet e marra gjatë fazës strategjike të zbatohen dhe që ligji vjetor i buxhetit të përgatitet në mënyrë efektive.

- Nga analiza e zërave të investimeve të parashikuara në PBA ka një mospërputhje të ndarjes së tyre mes politikave të reja dhe atyre ekzistuese, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” pika 4.5 “Hapat për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit” paragrafi 3.4 “Ndarja e kërkesave buxhetore sipas politikave ekzistuese dhe politikave të reja”, si dhe udhëzimet plotësuese vjetore “Për përgatitjen e dokumenteve të PBA-së”, pika 3.

- Sipas Udhëzimeve plotësuese vjetore për “Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm”, ku përcakton se “Të gjitha njësitë e Qeverisjes Qendrore, do të përgatisin kërkesa buxhetore për PBA-të, përmes sistemit AFMIS dhe moduleve respektive të përgatitjes së PBA dhe PIM. Raportet e kërkesave buxhetore të gjeneruara përmes sistemit AFMIS do të dorëzohen zyrtarisht në Ministrinë përgjegjëse për financat”, nga auditimi u konstatua se KPK ka përgatitur kërkesave buxhetore për fazën strategjike dhe teknike jashtë sistemit AFMIS dhe PIM.

Me shkresën me nr.5349 date 11.10.2022 të Degës së Thesarit, KPK është njoftuar që në muajin nëntor 2022 duhet të fillojë përdorimin Live në Web Portal (WP).

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me shkresën nr. 3885, datë 17.10.2022 dërguar në MFE në lidhje me përdorimin e portalit sqaron se:

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), është institucion shtetëror i pavarur i krijuar në mbështetje të nenit 179/b të Kushtetutës, si dhe ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokuroreve në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka në strukturën e tij një punonjëse specialiste finance/buxheti, e cila është me raport për një periudhë 1 vjeçare, duke filluar nga mesi i muajit shtator 2022.

Me ndryshimet Kushtetuese të bëra gjatë vitit 2022, mandati i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit përfundon me datën 31.12.2024, pra gjithsej edhe 26 muaj.

Sa më sipër KPK ka kërkuar Ministrinë së Financës dhe Ekonomisë, që KPK të mos përdori sistemin Live në Web Portal (WP).

MFE me shkresën nr. 1906/1, datë 20.10.2022 protokolluar në KPK me shkresën me nr. 3885/2, datë 24.10.2022 pranon kërkesën e KPK për shtyrjen e afatit në aksesimin në portal deri në momentin e paraqitjes në punë të punonjësës me pozicion “Specialist Finance”.

Degës së Thesarit, me shkresën me nr.3740, datë 28.07.2023 , protokolluar në KPK me nr. 3351, datë 01.08.2023 është kërkuar që në zbatim të Udhëzimit të MFE nr. 17, datë 06.07.2021 “Për një ndryshim të udhëzimit nr. 13, datë 10.03.2020 “Për një ndryshim të udhëzimit nr. 24, datë 29.08.2019 “Për përdorimin e arkivës elektronike në procesin e ekzekutimit të buxhetit të shtetit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, në muajin shtator 2023 duhet të filloni përdorimin Live në Web Portal (WP).

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me shkresën nr. 3351/1, datë 01.08.2023 dërguar në MFE për dijeni degës së thesarit në lidhje me përdorimin e portalit kërkon mospërdorimin e portalit për faktin se mandati i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit përfundon me datën 31.12.2024, pra gjithsej edhe 16 muaj.

MFE me shkresën nr. 14332/1, datë 11.08.2023 protokolluar në KPK me shkresën me nr. 3351/2, datë 15.08.2023 pranon kërkesën e KPK për mos aksesimin në portal.

b. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Viti 2017

Në zbatim të Ligjit nr. 130, datë 13.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, i ndryshuar; Udhëzimit plotësues të MF nr. 8, datë 13.01.2017 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017”, të vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me nr. 93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, referuar Aktit normativ nr. 3, datë 06.11.2017, me shkresën nr.15688/2, datë 05.11.2017 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është dërguar miratimi i detajimit të fondeve buxhetore në vlerën 52,177 mijë lekë përkatësisht 51,177 lekë shpenzime korrente dhe 1,000 mijë lekë shpenzime kapitale.

Me shkresën nr. 16148/95, datë 06.12.2017 është dërguar miratimi i detajimit të investimeve “Blerje pajisje zyre dhe elektronike” me kodin e projektit M030018 në vlerën 1,000 mijë lekë.

Viti 2018

Në zbatim të Ligjit nr. 109, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018” dhe Udhëzimit të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;

- Me shkresën me nr.19433, datë 28.12.2017 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 2418, datë 27.12.2017 është dërguar detajimi i buxhetit për vitin 2018.

- KPK me shkresën nr. 1643, datë 07.02.2018 dërguar Ministrisë së Financave është kërkuar çelja e investimeve për buxhetin e 2018, artikulli 231 në shumën prej 450,000 lekë për blerje fjalorësh dhe përmbledhje ligjore për krijimin e fondit të bibliotekës.

- KPK me shkresën nr. 1619, datë 07.02.2018 dërguar Ministrisë së Financave është kërkuar çelja e investimeve për buxhetin e 2018, artikulli 231 në shumën prej 400,000 lekë për blerje dollapësh metalik.

- Me shkresën nr.19433/244, datë 20.02.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 2071, datë 22.02.2018 është dërguar detajimi i limitit mujor të fondeve buxhetore për vitin 2018.

- Me shkresën nr. 2799/1, datë 22.02.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 2134, datë 26.02.2018 është dërguar detajimi i buxhetit të viti 2018 për shpenzimet kapitale.

Në detajimin e shpenzimeve kapitale është çelur dhe projekti me kodin M630009 “Fondi i ngrire” në shumën prej 14,150 mijë lekë.

- KPK me shkresën nr. 2306, datë 05.03.2018 dërguar Ministrisë së Financave është kërkuar çelja e investimeve për buxhetin e 2018, artikulli 231 në shumën prej 600,000 lekë për blerje e njëmbëdhjetë televizorëve (pajisje audio vizuale).

- KPK me shkresën nr. 2305, datë 05.03.2018 dërguar Ministrisë së Financave është kërkuar çelja e investimeve për buxhetin e 2018, artikulli 231 në shumën prej 408,000 lekë për “Rikonstruksionin e sallës së madhe të seancave dëgjimore”.

- Me shkresën nr. 5356/1, datë 28.03.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 2471/2, datë 30.03.2018 është dërguar detajimi i buxhetit të viti 2018 për shpenzimet kapitale mbështetur në kërkesën KPK nr. 2471, datë 13.03.2018 për çeljen e projektit me kodin M630012 “Blerje makine për institucionin” në shumën prej 3,600 mijë lekë.

- Me shkresën nr. 7747/1, datë 08.05.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 3489/2, datë 10.05.2018 është dërguar ç’ ngurtësimi i fondit për shpenzimet kapitale të viti 2018, mbështetur në kërkesën KPK nr. 3489, datë 17.04.2018 për kalimin e fondit nga projektin M630009 tek projekti M630002 “Blerje pajisje zyrash (tapet)” në shumën prej 120 mijë lekë.

- Me shkresën nr. 5697, datë 06.08.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është dërguar reflektimi i ndryshimeve të aktit normativ nr. 1, datë 26.07.2018, me pakësimin e artikullit 600 “Paga” në shumën 7,000 mijë lekë, dërguar ndryshimi në degën e thesarit me shkresën nr. 14875/66, datë 22.08.2018.
- KPK me shkresën nr. 7030, datë 19.10.2018 dërguar Ministrisë së Financave është kërkuar çelja e investimeve për buxhetin e 2018, artikulli 231 në shumën prej 550,000 lekë për blerje “Orendi mobilim zyrash”. Me shkresën nr. 18824/1, datë 06.11.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dërguar në degën e thesarit është kërkuar rialokimi i fondit nga projekti M630009 “Fondi i ngrirë” tek projekti M630002 “Blerje pajisjesh zyre”, në shumën prej 550,000 lekë.
- Me shkresën nr. 14250/13, datë 20.12.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është dërguar reflektimi i ndryshimeve të aktit normativ nr. 12, datë 19.12.2018,
- KPK me shkresën nr. 8537, datë 21.12.2018 dërguar Ministrisë së Financave është kërkuar transferim fondesh nga artikulli 602 “Mallra e shërbime” në artikullit 600 “Paga” në shumën 3,000 mijë lekë, kjo si rezultat i ndryshimeve të aktit normativ nr. 12, datë 19.12.2018, ku KPK i është pakësuar zëri fondi paga, e cila nuk është marrë në konsideratë nga MFE pasi kërkesa është jashtë afateve të përcaktuara në nenin 48, të ligjit 9936/2008.
- Me shkresën nr. 22452/92, datë 31.12.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është dërguar në degën e thesarit detajimi i ndryshimit të buxhetit për shpenzimet korrente, pakësim të artikullit 600 në shumën prej 13,000 mijë lekë dhe pakësim të artikullin 602 në shumën prej 15,000 mijë lekë, sipas aktit normativ nr. 12, datë 19.12.2018.
- Me shkresën nr. 22452/80, datë 31.12.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është dërguar në degën e thesarit detajimi i ndryshimit të buxhetit për shpenzimet kapitale pakësim të projektit M630009 “Fond i ngrirë” në shumën prej 7,000 mijë lekë, sipas aktit normativ nr. 12, datë 19.12.2018.
- Me shkresën nr. 23015/1, datë 31.12.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është dërguar akordimi i fondit të veçantë për vitin 2018 në vlerën 6,800 mijë lekë, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 813, datë 31.12.2018 "Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e Fondit të Veçante" i ndryshuar, si dhe në vijim të shkresës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 8742/1 Prot., datë 31.12.2018, nëpërmjet të cilës është kërkuar akordimi i fondit të veçante për shpërblimin e punonjësve të këtij institucioni, në zbatim të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", i ndryshuar, si dhe të Udhëzimit Plotësues të Financave dhe Ekonomisë, nr.2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”.

Viti 2019

- Në zbatim të Ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019” dhe Udhëzimit të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;
- Me shkresën nr.22760/1, datë 27.12.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 173, datë 10.01.2019 është dërguar detajimi i buxhetit për vitin 2019-2021.
 - Me shkresën nr.22760/319, datë 19.02.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është dërguar detajimi i buxhetit për shpenzime kapitale.
 - “Blerje pajisje zyre dhe kompjuteri” me kod M630002 në shumën prej 3,800 mijë lekë dhe “Krijimi i fondit të bibliotekës” me kod M630008 në shumën prej 200 mijë lekë.
 - Me shkresën nr.22760/331, datë 21.02.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 1769, datë 22.02.2019 është dërguar detajimi i limitit mujor të fondeve buxhetore për vitin 2019.
 - KPK me shkresën nr. 1934, datë 09.03.2019 dërguar Ministrisë së Financave është kërkuar shtesë fondi për vitin 2019, për mbulimin e shpenzimeve për “Paga dhe Sigurime Shoqërorë”

për 10 muajt e mbetur për vitin 2019, përafërsisht në shumë 300 mijë leke.

Zëri Paga Art. 600 në shumën 250 mijë leke dhe zëri “Sigurime Shoqërorë” Art.601, në shumën 500 mijë lekë.

Me vendimin nr. 102 datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.16, datë 16.01.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për punonjësit me kontrate të përkohshme për vitin 2019, në njësitë e qeverisjes qendrore", institucionit të KPK, iu miratuan 5 punonjës me kontrate të përkohshme, përkatësisht një pozicion protokoll/arkiva; 2 specialist për sekretarinë gjyqësore dhe 2 specialist për redaktimin.

- Me shkresën nr. 4230, datë 12.03.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 22357, datë 25.03.2019 është dërguar detajimi i fondit të veçantë për vitin 2019 në shumën 155 mijë lekë.

- Me shkresën nr. 22760/361, datë 27.03.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 22471, datë 29.03.2019 është dërguar detajimi i buxhetit për vitin 2019-2021 për shpenzime korrente.

- Me shkresën nr. 205666/2, datë 19.11.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 7086/3, datë 20.11.2019 është dërguar miratimi i ndryshimit të fondeve buxhetore përkatësisht shtesë të zërit “Shpenzime personeli” dhe pakësim të zërit “Shpenzime operative” në vlerën 8,000 mijë lekë. (7,500 mijë llogaria 600 dhe 500 mijë llogaria 601).

Ndryshimet sa më sipër kanë ardhur si rezultat miratimit të pagesave shtesë për këshilltarët e Njësisë së Shërbimi Ligjor, bazuar në ligjin nr.84/2018 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ku në pikën 5, të nenit 29 parashikohet: "Këshilltari ligjor dhe ekonomik përfiton përkatësisht 80% të pagës mujore përkatëse të anëtarit të institucionit të rivlerësimit. Ata përfitojnë një pagesë shtesë për shkak të vështirësisë, sipas rastit", si dhe kërkesave KPK për ndryshim të limit mujor për paga dhe shpenzime sipas kërkesave nga KPK përkatësisht me shkresën nr. 22760/4, datë 18.07.2019 në vlerën 5,100 mijë shtesë zërit “Shpenzime personeli” për muajin gusht dhe pakësim të po këtij zëri për muajin nëntor dhjetor, miratuar me shkresën e MFE me nr. 13700/1 datë 19.07.2019, si dhe shkresës nr. 5804, datë 16.09.2019 në vlerën 8,000 mijë shtesë zërit “Shpenzime personeli” për muajin tetor dhe nëntor dhe pakësim të po këtij zëri për muajin dhjetor.

- Me shkresën nr. 20818/1, datë 21.11.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është dërguar akordimi i fondit të veçantë për vitin 2019 në vlerën 9,000 mijë lekë, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 13.11.2019 “Për një shtesë të fondeve buxhetore për Institucionet e Sistemit të Drejtësisë për vitin 2019” në zbatim të ligjit nr. 99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019", i ndryshuar, si dhe të Udhëzimit Plotësues të Financave dhe Ekonomisë, nr.21, datë 17.01.2019 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”.

- Me shkresën nr. 17343/2, datë 08.10.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë protokolluar në KPK me nr. 6431, datë 11.10.20219 është dërguar reflektimi i ndryshimeve të aktit normativ nr. 2, datë 02.10.2019, ku nuk ka pasur efekt në ndryshimin e buxhetit për KPK-në.

Viti 2020

Në zbatim të Ligjit nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020” dhe Udhëzimit të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;

- Me shkresën me nr. 8160, datë 26.12.2019 të KPK-së drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është dërguar detajimi i buxhetit për vitin 2020-2022.

- Me shkresën me nr.24325/134, datë 30.01.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 8160/2, datë 03.02.2020 është dërguar detajimi i buxhetit për vitin 2020-2022 në lidhje me shpenzimet korrente.

- Me shkresën me nr.24325/159, datë 05.02.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë,

është dërguar detajimi i buxhetit për shpenzime kapitale.

“Blerje pajisje zyre dhe kompjuteri” me kod M630002 në shumën prej 4,000 mijë lekë.

- Me shkresën nr. 24325/204, datë 19.02.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 1940, datë 20.02.2020 është dërguar detajimi i limitit mujor të fondeve buxhetore për vitin 2020.

- Me shkresën nr. 3860, datë 20.02.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 2035, datë 25.02.2020 është dërguar detajimi i fondit të veçantë për vitin 2020 në shumën 150 mijë lekë.

Ndryshimet buxhetore:

- KPK me shkresën nr. 6128, datë 13.10.2020 dërguar Ministrisë së Financave është kërkuar transferimi fondi në vlerën 6,000 mijë lekë nga zëri 602 “Mallra dhe shërbime” në zërin “Paga dhe Sigurime Shoqërorë”. (Zëri Paga Art. 600 në shumën 5,500 mijë leke dhe zëri “Sigurime Shoqërorë” Art.601, në shumën 500 mijë lekë).

Me shkresën nr. 19098/1, datë 22.10.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 6728/3, datë 28.10.2020 është dërguar miratimi i ndryshimit të fondeve buxhetore përkatësisht shtesë të zërit “Shpenzime personeli” dhe pakësim të zërit “Shpenzime operative” në vlerën 6,000 mijë lekë.

Viti 2021

Në zbatim të Ligjit nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe Udhëzimit të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;

- Me shkresën me nr.23724/96, datë 18.01.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 8308/2, datë 19.01.2021 është dërguar detajimi i buxhetit për vitin 2021-2023 në lidhje me shpenzimet korrente.

- Me shkresën me nr.433/2, datë 20.01.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është dërguar detajimi i buxhetit për shpenzime kapitale, “Blerje pajisje zyre dhe kompjuteri” me kod M630002 në shumën prej 5,000 mijë lekë.

- Me shkresën nr. 23724/152, datë 20.01.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 489, datë 21.01.2020 është dërguar detajimi i limitit mujor të fondeve buxhetore për vitin 2020.

- Me shkresën me nr.24462/26, datë 29.01.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në është dërguar miratimi i detajimit të numrit të punonjësve në total 76 punonjës.

- Me shkresën nr. 1381/45, datë 16.03.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 2816, datë 25.03.2021 është dërguar detajimi i fondit të veçantë për vitin 2021 në shumën 150 mijë lekë.

Ndryshimet buxhetore:

- KPK me shkresën nr. 1487, datë 12.02.2021 dërguar Ministrisë së Financave është kërkuar transferimi fondi në vlerën 960 mijë lekë nga projekti M63002 “Blerje pajisje zyre dhe kompjuterike” në projektin M630008 “Rikonstruksioni ambientesh” për faktin se KPK i është shtuar një numër punonjësish prej 12 Këshilltar të Njesisë së Shërbimit Ligjor, ku lind nevoja e shtimit të posteve të punës, e cila kërkon punime dhe rikonstruksion të ambienteve të brendshme.

Me shkresën nr. 3097/1, datë 22.02.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 1699, datë 23.02.2021 është dërguar miratimi i transferimeve të fondeve buxhetore.

- KPK me shkresën nr. 4005, datë 25.05.2021 dërguar Ministrisë së Financave është kërkuar fondi në vlerën 2,000 mijë lekë për projekti M630002 “Blerje kamerash sigurie” të cilat janë djegur dhe duhet të zëvendësohen, si dhe zëvendësimin e 8 hard disqeve aktual për të rritur kapacitetin e periudhës së regjistrimit dhe ruajtjes së materialeve filmike nga 9 ditë në dy muaj. Fondi i çelur për investime janë prokuruar dhe realizuar dhe një pjesë janë në proces prokurimi.

Për shkak të rëndësisë kombëtare që ka procesi i rivlerësimit, situata e krijuar me mungesën e kamerave cënon sigurinë kombëtare, por dhe jetën e anëtarëve të komisionit dhe personelit të tij të garantuar në zbatim të nenit 25 të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Me shkresën nr. 11661, datë 28.06.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 4972, datë 28.06.2021 janë dërguar ndryshimet e Aktit Normativ nr. 26, datë 22.06.2021, ku nuk ka pasur ndryshime të fondeve buxhetore për KPK.

- KPK me shkresën nr. 7112, datë 19.10.2021 dërguar Ministrisë së Financave është kërkuar transferimi fondi në vlerën 2,000 mijë lekë nga zëri 602 "Mallra dhe shërbime" në zërin "Kontribute për Sigurime Shoqërorë", pasi nuk ka fonde të mjaftueshme për mbulimin e periudhës tetor dhe nëntor.

Viti 2022

Në zbatim të Ligjit nr.115, datë 16.11.2021 "*Për buxhetin e vitit 2022*" dhe Udhëzimit të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*";

- Me shkresën nr.22922/107, datë 29.12.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 2, datë 05.01.2022 është dërguar miratimi i detajimit të fondeve buxhetore për vitin 2022-2024.

- Me shkresën nr.22922/96, datë 18.01.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 180, datë 20.01.2022 është dërguar detajimi i buxhetit për vitin 2022-2024 në lidhje me shpenzimet korrente.

- Me shkresën nr.23379/40, datë 31.01.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 374, datë 02.02.2022 në është dërguar miratimi i detajimit të numrit të punonjësve në total 76 punonjës.

- Me shkresën nr. 3956, datë 01.03.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 899, datë 02.03.2022 është dërguar detajimi i fondit të veçantë për vitin 2022 në shumën 200 mijë lekë.

- Me shkresën nr.6380, datë 07.04.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 81470, datë 11.04.2022 është dërguar detajimi i buxhetit për shpenzime kapitale, "Blerje pajisje zyre" me kod M630002 në shumën prej 2,000 mijë lekë.

Ndryshimet buxhetore:

Me shkresën nr. 4934/3, datë 17.03.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 1141, datë 15.11.2021 është dërguar miratimi i ndryshimit të fondeve buxhetore, referuar aktit normativ nr. 3, datë 12.03.2022; pakësim të zërit 600 "Paga" në shumën prej 4,475 mijë lekë; zërin 601 "Kontributet e sigurimeve" në shumën prej 508 mijë lekë dhe zërin 602 "Mallra e shërbime" në shumën prej 3,750 mijë lekë.

- KPK me shkresën nr. 2331, datë 13.06.2022 dërguar Ministrisë së Financave është kërkuar shtesë fondi për zërin "Paga" në shumën prej 93,000 mijë lekë dhe zërin "Sigurime shoqërorë" në shumën prej 10,000 mijë lekë, kjo si rezultat:

- I pakësimit të fondeve nga akti normativ nr. 3, datë 12.03.2022;

- Vendimit nr. 36/2022 "*Për disa shtesa dhe ndryshime të Vendimit të kuvendit nr. 93/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të kualifikimit" i ndryshuar në pikën V ku përcaktohet se: Punonjësit administrative të Komisionit përfitojnë shtesë mujore për natyrë të veçantë pune në masën 100% të pagës për pozicion apo pagës bazë klase. Punonjësit administrative, të cilët sipas këtij vendimi përfitojnë shtesa të tjera të së njëjtës natyrë të përcaktuara në të, do të përfitojnë vetëm njëerën prej shtesave, atë me vlerë më të madhe*";

Në zbatim të pikës V për 36 Këshilltarë të Njësisë së Shërbimit Ligjor është afërsisht 8,000 lekë në muaj, në shumën 24,000 mijë lekë, si dhe një fond shtesë zëri 601 në shumën prej 2,500 mijë lekë.

- KPK me shkresën nr. 2861, datë 18.07.2022 dërguar Ministrisë së Financave është kërkuar shtesë fondi për zërin “Paga” në shumën prej 93,000 mijë lekë dhe zërin “Sigurime shoqërore” në shumën prej 10,000 mijë lekë kjo si rezultat:

Vendimit nr. 1653, datë 30.05.2022, Gjykatë së Shkallës së Parë Tiranë, të drejtën dhe legjitimitetin e vjetërsisë në punë, në masë 2% të pagës referuese bazë, për çdo vit shërbimi në funksion (neni 12/3 i ligjit nr. 96/2016) komisionerit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili është titull ekzekutiv bazuar nenit 45, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar dhe nenin 510 të Kodit të Procedurave Civile dhe si e tillë është detyrueshëm për tu zbatuar nga pala e paditur, institucionit KPK-së.

Me vendimin e Komisionit, si organ më i lartë vendimmarrës i KPK-së me nr. 27, datë 26.06.2022 ka vendosur përllogaritjen e pagës së anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Njesisë së shërbimit Ligjor, si dhe kryerjen e pagesës së tyre nga fondet e buxhetit 2022, duke përfshirë elementin e vjetërsisë në punë, në masë 2% të pagës referuese bazë, për çdo vit shërbimi në funksion, sipas nenit 12/3 i ligjit nr. 96/2016, e cila kërkon një fond shtesë për zërin 600 “Paga” në shumën prej 4,000 mijë lekë dhe zërin 601 “Kontribute për sigurime” në shumën prej 500 mijë lekë. Kjo kërkesë është ridërguar nga KPK me nr. 3712, datë 05.10.2022.

- Me shkresën nr. 14405/5, datë 03.08.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 3075, datë 05.08.2022 është dërguar detajimi i ndryshimeve të fondeve buxhetore, referuar aktit normativ nr. 12, datë 29.07.2022; shtesë të zërit 600 “Paga” në shumën prej 30,000 mijë lekë.

- Me shkresën nr. 20213/2, datë 11.11.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 4437, datë 14.11.2022 është dërguar miratimi i transferimit të fondeve nga zëri 602 “Mallra e shërbime” në shumë 7,500 mijë lekë, përkatësisht në zërin 600 “Paga” në shumën prej 7,000 mijë lekë dhe zërin 601 “Kontribute të sigurimeve” në shumën prej 500 mijë, referuar kërkesës së KPK-së me nr. 4150, datë 01.11.2022 “Për transferim fondesh”.

- Me shkresën nr. 23/1, datë 11.01.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 5179/2, datë 20.01.2023 është dërguar transferimi i fondit nga zëri “Paga” në shumën prej 9,300 mijë lekë dhe zërin 601 “Kontribute të sigurimeve” në shumën prej 700 mijë, në zërin 606, në zbatim të VKM-së me nr. 898, datë 29.12.2022 “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësisë të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e krizës”.

Viti 2023

Në zbatim të Ligjit nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe Udhëzimit të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;

- Me shkresën me nr.23774, datë 28.12.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 4, datë 04.01.2023 është dërguar miratimi i detajimit të fondeve buxhetore për vitin 2023-2025.

- Me shkresën me nr.23774/40, datë 20.01.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 222, datë 23.01.2023 është dërguar detajimi i buxhetit për vitin 2023-2025 në lidhje me shpenzimet korrente.

- Me shkresën me nr.23774/83, datë 25.01.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 296, datë 26.01.2023 është dërguar miratimi i detajimit mujor të shpenzimeve.

- Me shkresën nr. 23172/1, datë 30.01.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 899, datë 02.03.2022 është dërguar detajimi i buxhetit për vitin 2023-2025 në lidhje me shpenzimet kapitale. “Blerje pajisje zyre dhe kompjuteri” me kod

M630002 në shumën prej 2,000 mijë lekë.

- Me shkresën nr. 1052, datë 07.02.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 512, datë 08.02.2023 është dërguar miratimi i detajimit të numrit të punonjësve në total 76 punonjës.

- Me shkresën nr. 4530, datë 07.03.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 1104, datë 08.03.2023 është dërguar detajimi i fondit të veçantë për vitin 2023 në shumën 200 mijë lekë.

Ndryshimet buxhetore:

- KPK me shkresën nr. 468, datë 06.02.2023 dërguar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë është kërkuar miratim fondi shtesë për zërin "Paga" në shumën prej 72,000 mijë, në zbatim të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 35, datë 22.11.2022, me objekt "Shfuqizimi i nenit 12, pika 5, shkronja "a", të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar me nenin 2, pika 1, të ligjit nr. 50/2021, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë", si dhe Vendimit të Komisionit nr. 4 datë 31.1.2023, e cila ka të bëjë me shtesën e pagës për diplomën në shumën prej 14,000 lekë me efekt prapaveprues nga viti 2017. Në kërkesën për fonde KPK ka përfshirë detyrimet e lindura për vitin 2018 dhe 2019, si dhe diferencat për vitin 2023. KPK me shkresën nr. 624, datë 13.02.2023, dërguar Ministrisë së Financave është kërkuar avancim plan thesari për vitin 2023.

- Me shkresën nr. 2342/1, datë 21.02.2023 të Ministrisë së Financave dërguar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për dijeni KPK-së, sqaron se ligji i buxhetit miratohet nga Parlamenti dhe nuk mund të ndryshohet nga MFE. Për zbatimin e Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 35, datë 22.11.2022, për kompetencë janë përcjellë shkresat e dërguara nga sistemi i drejtësisë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

- KPK me shkresën nr. 1893, datë 03.05.2023 dërguar Ministrisë së Financave ka kërkuar transferim fondesh nga zëri "Mallra e shërbime" në zërin "Paga" në shumën prej 5,750 mijë lekë, ku në zbatim të VKM-së nr. 56, datë 01.02.2023 "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023, në njësitë e qeverisjes qendrore" për komisionin janë miratuar tetë punonjës me kontratë, të cilat janë përballuar me fondet e çelura për "Paga" dhe "Sigurimeve".

- KPK me shkresën nr.1320, datë 21.03.2023 dhe me shkresën nr. 1956, datë 08.05.2023 dërguar Ministrisë së Financave ka kërkuar shtesë fondesh për periudhën buxhetore për vitet 2017-2023.

Në vijim të shkresës nr. 3206/1 prot., datë 3.3.2023, "Mbi kërkesat për fonde shtesë", të MFE-së drejtuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për vitet 2017 - 2023, si rrjedhojë e hyrjes në fuqi të vendimit nr.35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese, kërkesat për fonde shtesë të ndara sipas viteve janë;

Për vitin 2017, në vijim të vendimit të Kuvendit me nr. 93/2017, "Për miratimin e strukturës organizative, organikes dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit", Komisionit i janë miratuar 12 komisionerë dhe 16 këshilltarë të Njesisë së Shërbimit Ligjor.

Gjatë vitit 2023, bazuar në kategorinë e pagës referuese I-b dhe shtesën e pagës për diplome në shumën 14,000 lekë, janë paguar detyrimet e vitit 2017 për 12 komisionerë dhe 8 këshilltarë në shumën prej 7,1 milionë lekë, të cilët janë ende në marrëdhënie pune me Komisionin.

Ndërsa për 7 këshilltarë të tjerë të rekrutuar gjatë vitit 2017, të cilët nuk janë në marrëdhënie pune me Komisionin, por që u lind e drejta për ta përfituar këtë shtesë dhe kanë bërë kërkesa individuale pranë Komisionit, por nuk janë paguar, kërkohet një fond shtesë në zërin shpenzime korrente prej rreth 0.35 milion lekë.

Për vitin 2018, Komisioni ka përlllogaritur diferencën e pagave, bazuar në kategorinë e pagës

referuese I-b dhe shtesën e pagës për diplome në shumën 14,000 leke, nga ku rezultoi se kërkohet një fond shtesë në zërin shpenzime korrente në shumën prej rreth 20,000 mijë lekë. Komisioni gjatë vitit 2018 ka urdhëruar dhe paguar një page bruto mujore shtesë për pagesën e vështirësisë për këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, si dhe ka përfituar me VKM-në nr. 813, date 31.12.2018, një shpërblim nga fondi i veçantë si për komisionerët ashtu edhe këshilltarët. Fondi shtesë për këto dy pagesa është përlllogaritur në shumën 2,000 mijë lekë. Fondi total shtesë në zërin shpenzime korrente për vitin 2018 kërkohet afërsisht në shumën 22,000 mijë lekë.

Për vitin 2019, në vijim të vendimit të Kuvendit me nr. 100/2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 93/2017, për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit", gjatë vitit 2019, Komisioni ka pasur 12 komisionerë dhe 24 këshilltarë në Njësinë e Shërbimit Ligjor.

Komisioni ka përlllogaritur diferencën e pagave, bazuar në kategorinë e pagës referuese I-b dhe shtesën e pagës për diplome në shumën 14,000 lekë, nga ku rezultoi se kërkohet një fond shtesë në zërin shpenzime korrente në shumën rreth 27,400 mijë lekë. Komisioni gjatë vitit 2019 ka urdhëruar dhe paguar dy paga bruto mujore për pagesën e vështirësisë për këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor. Fondi shtesë për këto dy pagesa është përlllogaritur në shumën 2,4 milionë lekë. Fondi total shtesë në zërin shpenzime korrente për vitin 2019 kërkohet afërsisht në shumën 29,800 mijë lekë.

Për vitin 2020, Komisioni ka përlllogaritur diferencën e pagave, bazuar në kategorinë e pagës referuese I-b dhe shtesën e pagës për diplomë në shumën 14,000 lekë, nga ku rezultoi se kërkohet një fond shtesë në zërin shpenzime korrente afërsisht në shumën 27,400 mijë lekë.

Komisioni gjatë vitit 2020 ka urdhëruar dhe paguar një page bruto mujore për pagesën e vështirësisë për këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor. Fondi shtesë për këto dy pagesa është përlllogaritur në shumën 1,200 mijë lekë. Fondi total shtesë në zërin shpenzime korrente, për vitin 2020 kërkohet afërsisht në shumën 28,600 lekë.

Për vitin 2021, Komisioni ka pasur 12 komisionerë dhe 36 këshilltarë në Njësinë e Shërbimit Ligjor. Komisioni ka përlllogaritur diferencën e pagave, bazuar në kategorinë e pagës referuese I-b dhe shtesën e pagës për diplomë në shumën 14,000 lekë, nga ku rezultoi se kërkohet një fond shtesë në zërin shpenzime korrente afërsisht në shumën 34,500 mijë lekë.

Komisioni gjatë vitit 2021 ka urdhëruar dhe paguar një page bruto mujore për pagesën e vështirësisë për këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor. Fondi shtesë për këtë pagesë është përlllogaritur në shumën 1,500 mijë lekë. Fondi total shesë në zërin shpenzime korrente për vitin 2021 kërkohet afërsisht në shumën 36,000 mijë lekë.

Për vitin 2022, Komisioni ka përlllogaritur diferencën e pagave, bazuar në kategorinë e pagës referuese I-b dhe shtesën e pagës për diplomë në shumën 14,000 lekë, nga ku rezultoi se kërkohet në fond shtesë në zërin shpenzime korrente afërsisht në shumën 35,000 mijë lekë.

Komisioni gjatë vitit 2022 ka urdhëruar dhe paguar dy paga bruto mujore për pagesën e vështirësisë për këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor. Fondi shtesë për këtë pagesë është përlllogaritur në shumën 3,500 mijë lekë. Fondi total shesë në zërin shpenzime korrente për vitin 2021 kërkohet afërsisht në shumën 38,500 mijë lekë.

Për vitin 2023, fondi për shpenzime personeli, akorduar Komisionit për vitin 2023 është në shumën 239,550 mijë lekë.

Gjatë vitit 2023, Komisioni ka paguar shumën prej 7,100 mijë lekë për diferencat e munguara për vitin 2017, si dhe ka kryer pagesat e pagave, bazuar në kategorinë e pagës referuese I-b dhe shtesën e pagës për diplome në shumën 14,000 lekë.

Në vijim të vendimit të Kuvendit nr. 36/2022, Komisioni gjatë vitit 2023 ka të drejtën për të paguar deri në tri paga bruto mujore për pagesën e vështirësisë për këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor. Pra, fondi për shpenzime personeli për vitin 2023 duhet të jetë në shumën

293,000 mijë lekë. Fondi total shtesë në zërin shpenzime personeli për vitin 2023 kërkohet afërsisht në shumën 53,000 mijë lekë, e ndarë në zërin "Paga" Art. 600, në shumën 51,500 mijë lekë dhe në zërin "Sigurime shoqërore dhe shëndetësore" Art. 601 në shumën 1,500 mijë lekë.

- KPK me shkresën nr. 1772, datë 25.04.2023 dërguar Ministrisë së Financave është kërkuar avancim plan thesari për vitin 2023, duke pakësuar muajin dhjetor dhe shtuar muajin maj në shumën prej 2,000 mijë lekë, në zbatim të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 35, date 22.11.2022, me objekt "Shfuqizimi i nenit 12, pika 5, shkronja "a", të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar me nenin 2, pika 1, të ligjit nr. 50/2021, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë", si dhe Vendimit të Komisionit nr. 4 date 31.1.2023.
- KPK me shkresën nr. 2445, datë 02.06.2023 dërguar Ministrisë së Financave ka kërkuar avancim plan thesari për vitin 2023, duke pakësuar muajin dhjetor dhe shtuar muajin qershor në shumën prej 7,000 mijë lekë, në zbatim të nenit 1 të ligjit 33/2023 "Për një ndryshim të ligjit 99/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar pika a "paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorëve, e cila është e njëjtë me shumëzimin e koeficientit 0.36 me pagën e Presidentit të Republikës".
- KPK me shkresën nr. 2781, datë 21.06.2023 dërguar Ministrisë së Financave ka kërkuar shtesë fondi për periudhën prill-dhjetor 2023, në zbatim të ligjit 33/2023 "Për një ndryshim të ligjit 99/2016....." si dhe VKM-së nr. 326, datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme, në disa institucione të administratës publike", ku efekti financiar i ri përlllogaritur është në shumën prej 45,000 mijë lekë nga të cilat 40,000 mijë për zërin "Paga" dhe 5,000 mijë në zërin "Sigurime".

Me shkresën nr. 11487/1, datë 10.07.2023 të MFE, protokolluar në KPK me nr. 2781/2, datë 12.07.2023 është miratuar alokimi i fondeve në shumën prej 5,820 mijë lekë për zërin "Paga" dhe shumën prej 580 mijë lekë për zërin "Sigurime".

- KPK me shkresën nr. 2867, datë 29.06.2023 dërguar Ministrisë së Financave ka kërkuar avancim plan thesari për muajin qershor në shumën prej 13,125 mijë lekë, duke pakësuar muajin dhjetor, miratuar me shkresën nr. 11869/1, datë 29.06.2023, protokolluar në KPK me nr. 2867/2, datë 03.07.2023.
- Nga MFE është dërguar shkresa me nr. 14844/1, datë 18.08.2023, protokolluar në KPK me nr. 3479, datë 21.08.2023 akordim fondesh për rritjen e pagave të magjistratëve përkatësisht në shumën prej 32,000 mijë lekë për zërin "Paga" dhe shumën prej 3,000 mijë lekë për zërin "Sigurime". në zbatim të VKM-së nr.437, datë 19.07.2023 "Për shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për disa institucione të pavarura, të krijuara me ligj" ku në pikën 7 është përcaktuar shtimi i fondit prej 35,000 mijë lekë për KPK.
- KPK me shkresën nr.3929, datë 29.09.2023 dërguar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave ka kërkuar shtesë fondesh për periudhën buxhetore për vitin 2023 për periudhën 2018-2022, në shumën prej 155,000 mijë lekë në zbatim të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 35, datë 22.11.2022, me objekt "Shfuqizimi i nenit 12, pika 5, shkronja "a", të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar me nenin 2, pika 1, të ligjit nr. 50/2021, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë", ku është bërë shtesa e pagës për diplomë në shumën prej 14,000 lekë, si dhe shtesë fondi në shumën prej 14,300 mijë lekë për përballimin e shpenzimeve për dy paga mujore bruto në zbatim të Vendimit nr. 36/2022 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 93/2017, "Këshilltari ligjor dhe ekonomik të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas rastit, përfitojnë një pagesë shtesë për shkak të vështirësisë në punë. PAGESA shtesës është jo më shumë se 3 paga mujore dhe jepet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të mbledhjes së anëtareve të Komisionit".
- Me shkresën nr. 19139/2, datë 24.10.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë,

protokolluar në KPK me nr. 4324, datë 26.10.2023 është dërguar ndryshimet e Aktit Normativ nr. 5, datë 18.10.2023, ku nuk ka pasur ndryshime të fondeve buxhetore për KPK.

- KPK me shkresën nr. 4331, datë 26.10.2023 dërguar Ministrisë së Financave është kërkuar transferimi fondi në vlerën 5,000 mijë lekë nga zëri “Mallra dhe shërbime” dhe 1,000 mijë lekë nga zëri “Sigurime” në zërin “Paga”, miratuar me shkresën nr. 19696/1, datë 03.11.2023.

- Me shkresën nr. 22656/4, datë 18.12.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në KPK me nr. 4796, datë 18.12.2023 është dërguar ndryshimet e Aktit Normativ nr. 6, datë 14.12.2023, ku nuk ka pasur ndryshime të fondeve buxhetore për KPK.

- KPK me shkresën nr. 4882, datë 26.10.2023 dërguar Ministrisë së Financave është kërkuar detajimi i limitit mujor të fondit shtesë të miratuar me VKM-në nr. 755, datë 20.12.2023 në shumën prej 60,000 mijë lekë. MFE me shkresën nr. 23934, datë 29.12.2023, protokolluar në KPK me nr. 2, datë 03.01.2024 dërgon miratimin e fondit sipas artikujve përkatësisht për artikullin 600 në shumën prej 59,000 mijë lekë dhe për artikullin 601 në shumën prej 1,000 mijë lekë.

- KPK me shkresën nr. 63, datë 11.01.2024 dërguar Ministrisë së Financave është kërkuar shtesë fondesh në vlerën prej 522,470 lekë, në zbatim të VKM-së me nr.795, datë 28.12.2023 *“Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të acquis (screening), në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian”*.

- KPK me shkresën nr. 3, datë 03.01.2024 dërguar Ministrisë së Financave është kërkuar akordim fondi shtesë në shumën prej 40,000 mijë lekë dhe për një përdorim më efektiv të fondeve buxhetore transferimin e fondeve nga artikulli 601 në shumën prej 1,960 mijë lekë në artikullin 600.

Nga MFE me shkresën nr. 154/1, datë 09.01.2024, protokolluar në KPK me nr. 57, datë 11.01.2024 është dërguar akordimi i fondeve në shumën prej 40,000 mijë lekë për artikullin 600, në zbatim të VKM-së 834, datë 28.12.2023 *“Për një ndryshim të VKM-së nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin e përdorimit të fondit të veçantë”, pika 3 “Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i shtohet fondi prej 40 000 000 (dyzet milionë) lekë, në zërin e shpenzimeve të personelit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023. Ky fond përballohet nga fondi rezervë i buxhetit dhe përdoret për pagesën e diferencës së pagës së magjistratit, sipas arsytimit të bërë nga Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 35/2022”*.

Viti 2024

Në zbatim të Ligjit nr.97/2023 *“Për buxhetin e vitit 2024”* si dhe Udhëzimit të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”* i ndryshuar; Udhëzimit të MF, nr.1, datë 24.01.2024 *“Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”*.

- KPK me shkresën me nr.4779, datë 18.12.2023 drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është dërguar detajimit i fondeve buxhetore për vitin 2024-2026.

- Me shkresën me nr.23917, datë 28.12.2023 të Ministrisë së Financave, protokolluar në KPK me nr.21, datë 08.01.2024 është dërguar miratimi i detajimit të fondeve buxhetore për vitin 2024-2026.

- Me shkresën me nr.23917/121, datë 30.01.2024 të Ministrisë së Financave, protokolluar në KPK me nr. 299, datë 01.02.2024 është dërguar miratimi i detajimit të limitit mujor për vitin 2024.

- Me shkresën me nr. 23917/90, datë 29.01.2024 të Ministrisë së Financave, protokolluar në KPK me nr. 248,30.01.2024 është dërguar detajimi i shpenzimeve korrente. për vitin 2024.

- Me shkresën me nr.693/1, datë 15.01.2024 të Ministrisë së Financave, protokolluar në KPK me nr. 108, datë 18.01.2024 është miratuar akordimi i fondit në vlerën prej 522,470 lekë, në zbatim të VKM-së me nr.795, datë 28.12.2023 *“Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të acquis (screening), në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian”*.

- Me shkresën nr. 23215/34, datë 13.02.2024 të Ministrisë së Financave, protokolluar në KPK me nr. 494, datë 15.02.2024 është dërguar miratimi i detajimit të numrit të punonjësve në total 76 punonjës.
- Me shkresën nr. 23917/147, datë 08.02.2024 të Ministrisë së Financave, protokolluar në KPK me nr. 425, datë 12.02.2024 është dërguar detajimi i buxhetit për vitin 2024-2026 në lidhje me shpenzimet kapitale “Blerje pajisje zyre dhe kompjuteri” me kod M630002 në shumën prej 2,000 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 391/2, datë 25.03.2024 të Ministrisë së Financave, protokolluar në KPK me nr. 880, datë 27.03.2024 është dërguar detajimi i fondit të veçantë për vitin 2024 në shumën 200 mijë lekë.

Ndryshimet buxhetore:

- Me shkresën nr. 11696/38, datë 12.09.2024 të Ministrisë së Financave protokolluar në KPK me nr. 1926, datë 16.09.2024 është dërguar detajimi i ndryshimit të buxhetit për shpenzimet korrente, sipas aktit normativ nr. 3, datë 28.08.2024 shtesë të artikullit 600 në shumën prej 4,000 mijë lekë.
- Me shkresën nr. 9587/1, datë 26.07.2024 të Ministrisë së Financave është dërguar akordim fondesh për artikullin 600 në shumën prej 1,400 mijë lekë dhe për artikullin 601 në shumën prej 100 mijë lekë, në zbatim të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", i ndryshuar, Vendimit nr. 421, datë 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.5.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi page të Zëvendësministrit, Funkionarëve të Kabineteve, Prefektit, Nënprefektit, Nëpunësve Civile dhe Nëpunësve në disa institucione të administratës publike", Vendimit nr. 422, datë 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në Vendimin nr. 326, datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr. I, datë 24.01.2024, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024", si dhe të shkresës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 1710, datë 08.07.2024.

c. Realizimi i planit të buxhetit

Viti 2017

Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikujve për vitin 2017 rezulton si vijon:

Llogaria ekonomike	Plani fillestar	Realizimi faktik	% e realizimit
600.Paga	42,782	27,987	65%
601. Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	2,895	1,703	59%
602. Mallra dhe shërbime	5,500	1,732	31%
604. Transferta të brendshme			
231.Investim me financim të brendshëm	1,000	807.6	81%
231.Investim me financim të huaj	0	0	
TOTALI	52,177	32,230	62%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të KPK

Buxheti i planifikuar është realizuar në masën 62% ndaj buxhetit total.

Për vitin 2017 nga KPK janë realizuar investime me financim të brendshëm projektet si më poshtë:

- M630018 “Blerje pajisje kompjuterike 12 copë” në shumën prej 807,600 lekë.

Viti 2018

Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikujve për vitin 2018 rezulton si vijon:

Llogaria ekonomike	Plani	Realizimi faktik	% e realizimit
600.Paga	128,100	126,133	98%
601. Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	10,900	10,013	92%
602. Mallra dhe shërbime	17,000	13,985	82%
606. Transferta për buxhet familjar dhe individ	80	80	100%
231.Investim me financim të brendshëm	8,000	5,965	75%
231.Investim me financim të huaj			
TOTALI	164,080	156,175	95%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të KPK

Buxheti i planifikuar është realizuar në masën 95% ndaj buxhetit total.

Për vitin 2018 nga KPK janë realizuar investime me financim të brendshëm projektet si më poshtë:

- M630005 “Krijim fondi bibliotekë” në shumën prej 439,198 lekë;
- M630001 “Blerje rafte metalike për arkivin” në shumën prej 345,600 lekë;
- M630002 “Blerje pajisje zyre, tavolina” në shumën prej 327,960 lekë dhe “Blerje dhe vendosje skeleteri xhami” në shumën prej 120,000 lekë;
- M630012 “Blerje televizorësh” në shumën prej 522,000 lekë;
- M630008 “Riorganizimi i sallave të gjyqit/seancave dëgjimore” në shumën prej 336,000 lekë;
- M630023 “Blerje tapeti - rrugice për shkallet” në shumën prej 120,000 lekë;
- M630020 “Blerje makine për institucionin” në shumën prej 3,240,000 lekë;
- “Blerje dhe vendosje skeleteri xhami” në shumën prej 120,000 lekë;
- M630018 të cilat kanë të bëjnë me blerjet nën 100,000 lekë si:
 - “Blerje diktofon recorder/Regjistruues zëri” në shumën prej 23,571 lekë;
 - “Blerje ekran projektimi” në shumën prej 68,000 lekë;
 - “Blerje materiale elektronike për sallën e dëgjimit” në shumën prej 115,662 lekë;
 - “Blerje fshesë me korrentë” në shumën 40,000 lekë;
 - Blerje “Bolieri” në shumë 10,000 lekë;
 - “Blerje switch për zyrën e protokoll arkivin” në shumën prej 46,800 lekë;
 - “Likuidim programi për protokollin digjital” në shumën prej 116,400 lekë;
 - “Likuidim bazash për mikrofon” në shumën prej 99,600 lekë.

Viti 2019

Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikujve për vitin 2019 rezulton si vijon:

Në mijë lekë

Llogaria ekonomike	Plani	Realizimi faktik	% e realizimit
600.Paga	158,600	158,529	99.9%
601. Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	14,000	13,628	97%
602. Mallra dhe shërbime	24,000	22,414	93%
606. Transferta për buxhet familjar dhe individ	223	189.5	85%
231.Investim me financim të brendshëm	4,000	2,949	74%
231.Investim me financim të huaj			
TOTALI	200,823	197,709	98%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të KPK

Buxheti i planifikuar është realizuar në masën 95% ndaj buxhetit total.

Për vitin 2019 nga KPK janë realizuar investime me financim të brendshëm projektet si më poshtë:

- M630002 “Mobilim zyrash” në shumën prej 538,200 lekë dhe “Pajisje elektronike” në shumën prej 1,417,800 lekë.

Blerje “Programi alpha web” në shumën prej 294,000 lekë; “Grirëse dokumentesh” në shumën prej 380,400 lekë; “Karrige zyre profesionale” në shumën prej 273,600 lekë; “Pompë uji elektrike” në shumën prej 45,000 lekë.

Viti 2020

Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikujve për vitin 2020 rezulton si vijon:

Në mijë lekë

<i>Llogaria ekonomike</i>	<i>Plani</i>	<i>Realizimi faktik</i>	<i>% e realizimit</i>
600.Paga	148,300	148,283	100%
601. Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	13,900	13,392	96%
602. Mallra dhe shërbime	24,000	22,305	93%
606. Transferta për buxhet familjar dhe individ	150	50	33%
231.Investim me financim të brendshëm	4,000	1,834	46%
231.Investim me financim të huaj			
TOTALI	190,350	185,864	98%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të KPK

Buxheti i planifikuar është realizuar në masën 98% ndaj buxhetit me ndryshime.

Për vitin 2020 nga KPK janë realizuar investime me financim të brendshëm projektet si më poshtë:

- M630002 “Pajisje elektronike” në shumën prej 1,382,400 lekë, si dhe “Mobilim zyrash” në shumën prej 451,800 lekë.

Viti 2021

Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikujve për 12-mujorin e vitit 2021 rezulton si vijon:

Në mijë lekë

<i>Llogaria ekonomike</i>	<i>Plani</i>	<i>Realizimi faktik</i>	<i>% e realizimit</i>
600.Paga	177,800	177,798	100%
601. Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	17,400	16,852	97%
602. Mallra dhe shërbime	35,500	25,236	71%
606. Transferta për buxhet familjar dhe individ	150		0%
231.Investim me financim të brendshëm	5,000	3,663	73%
231.Investim me financim të huaj			
TOTALI	235,850	223,549	95%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të KPK

Buxheti i planifikuar për vitin 2021 në KPK është realizuar në masën 95% ndaj buxhetit me ndryshime.

Për vitin 2021 nga KPK janë realizuar investime me financim të brendshëm projektet si më poshtë:

- M630002 “Mobilje zyrash” në shumën prej 684,000 lekë, si dhe “Pajisje elektronike” në shumën prej 2,026,920 lekë, nga të cilat 50 copë UPS në shumë prej 228,000 lekë dhe 19 copë laptop në shumën prej 1,798,920 lekë.

- M630008 “Rikonstruktion zyrash kati II” në shumën prej 952,355 lekë.

Viti 2022

Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikujve për 12-mujorin e vitit 2022 rezulton si vijon:

Në mijë lekë

<i>Llogaria ekonomike</i>	<i>Plani</i>	<i>Realizimi faktik</i>	<i>% e realizimit</i>
600.Paga	202,225	202,201	100%
601. Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	19,610	19,607	100%
602. Mallra dhe shërbime	26,250	25,924	99%
606. Transferta për buxhet familjar dhe individ	10,200	9,893	97%
231.Investim me financim të brendshëm	2,000	754	38%
231.Investim me financim të huaj			
TOTALI	260,285	258,379	99%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të KPK

Buxheti i planifikuar për vitin 2022 në KPK është realizuar në masën 99% ndaj buxhetit me ndryshime.

Për vitin 2022 nga KPK janë realizuar investime me financim të brendshëm projektet si më

poshtë:

- M630002 “Blerje dhe montim raftesh metalike për arkive” në shumën prej 753,952 lekë.

Konstatim:

Nga auditimi i raporteve të monitorimit rezultoi se, nga KPK nuk janë plotësuar anekset e specifikuar në Udhëzimin e MFE-se nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të Buxhetit në NJQQ” pika 49, si dhe Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Raportet e monitorimit nuk përfshijnë informacion mbi arritjet në terma sasiorë dhe vlerorë të produkteve të realizuara, si dhe nuk janë identifikuar mosarritjet, ku të shpjegohen dhe shkaktohen e tyre, duke propozuar në të njëjtën kohë masa për përmirësimin e situatës.

Nga institucioni në raportet e monitorimit nuk janë cituar detyrimet e prapambetura që institucioni ka ndaj punonjësve apo dhe ndaj palëve të treta.

Viti 2023

Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikujve për 12-mujorin e vitit 2023 rezulton si vijon:

Në mijë lekë

Llogaria ekonomike	Plani	Realizimi faktik	% e realizimit
600.Paga	360,642	360,635	100%
601. Sigurime Shogërore dhe Shëndetësore	25,830	23,870	92%
602. Mallra dhe shërbime	28,750	28,306	98%
606. Transferta për buxhet familjar dhe individ	200	50	25%
231.Investim me financim të brendshëm	2,000	0	0%
231.Investim me financim të huaj			
TOTALI	417,422	412,861	99%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të KPK

Buxheti i planifikuar për vitin 2023 në KPK është realizuar në masën 99% ndaj buxhetit me ndryshime. Për vitin 2023 nga KPK nuk është realizuar asnjë investim.

8-mujorin i vitit 2024

Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikujve për 8-mujorin e vitit 2024 rezulton si vijon:

Në mijë lekë

Llogaria ekonomike	Plani	Realizimi faktik	% e realizimit
600.Paga	265,700	169,154	64%
601. Sigurime Shogërore dhe Shëndetësore	26,050	16,851	65%
602. Mallra dhe shërbime	33,750	8,601	25%
606. Transferta për buxhet familjar dhe individ	200	30	15%
231.Investim me financim të brendshëm	2,000	60	0%
231.Investim me financim të huaj			
TOTALI	327,700	194,696	59%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të KPK

Zbatimi i buxhetit për paga.

1. Gjatë viteve objekt auditimi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit janë marrë vendime “Dhënie e një page shtesë për vështirësi Njesisë Ligjore të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” në përpjesëtim me kohën e punës së ushtruar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. të parashikuar nga pika 5 e nenit 29 të ligjit 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të rregullores për “Veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” në përpjestim me kohën e punës së ushtruar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit çdo gjashtë muaj përkatësisht me vendimin:

- Nr.71, datë 21.12.2018 në vlerë financiare 3,344,595 lekë, për 15 Këshilltar;
- Nr.36, datë 16.07.2019 në vlerë financiare 4,719,595 lekë, për 24 Këshilltar;
- Nr.72, datë 20.11.2019 në vlerë financiare 4,998,311 lekë, për 24 Këshilltar;
- Nr.63, datë 10.11.2020 në vlerë financiare 4,552,365 lekë, për 21 Këshilltar;
- Nr.67, datë 29.10.2021 në vlerë financiare 6,680,744 lekë, për 33 Këshilltar;
- Nr.25, datë 28.06.2022 në vlerë financiare 7,581,082 lekë, për 34 Këshilltar;

- Nr.44, datë 18.11.2022 në vlerë financiare 7,901,955 lekë, për 35 Këshilltar;
- Nr.37, datë 17.07.2023 në vlerë financiare 8,088,192 lekë, për 33 Këshilltar;
- Nr.60, datë 23.11.2023 në vlerë financiare 8,409,881 lekë, për 33 Këshilltar;
- Nr.17, datë 08.07.2024 në vlerë financiare 9,318,052 lekë, për 35 Këshilltar.

2. Shpërblime në fund të vitit

-Me Vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr.55 prot., 5169/1, datë 30.12.2022 mbështetur në vendimin nr. 898, datë 29.12.2022 të Këshillit të Ministrave “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësisë të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës” vendosi “Për miratimin e masës së mbështetjes financiare të menjëhershme për vitin 2022 nga fondet buxhetore të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”. Sipas këtij vendimi jepet masa për mbështetje financiare të menjëhershme, nga fondet buxhetore të miratuara për KPK për vitin 2022 të jetë:

- a) Për të gjithë stafin administrativ mbështetës dhe komisionerët, ndihma financiare të jetë në masën e një page bruto;
- b) Për të gjithë punonjësit me kontratë pune të përkohshme (6 orë), me afat të caktuar, ndihma financiare të jetë në masën 20,000 (njëzetë mijë) lekë;
- c) Punonjësit që janë aktualisht në leje lindje dhe ato të punësuar rishtazi që punojnë për një periudhë jo më shumë se 3 muaj, me kohë të plotë dhe afat të caktuar, ndihma financiare të jetë në masën 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
- d) Të gjithë këshilltarët në njësinë e shërbimit ligjor, përfitojnë ndihmë financiare në masën 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

Në zbatim të vendimit sa më sipërm me urdhër shpenzimet nr. 244-246, datë 30.12.2022 është paguar shuma prej 9,893,043 lekë.

- Me Vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr.77 prot., 9755/1, datë 20.12.2021 mbështetur në vendimin nr.801, datë 20.12.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.929, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për krijimi dhe përdorimin e fondit të veçantë” i ndryshuar komisioni ka vendosur:

- a) Miratimin e një shpërblimi për vitin 2021 Komisionerëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
- b) Shpërblimin e një page mujore.
- c) Efektet financiare përballohen nga buxheti i vitit 2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Si dhe vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr.78 prot., nr. 9798, datë 22.12.2021 mbështetur në vendimin nr. 801, datë 20.12.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.929, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për krijimi dhe përdorimin e fondit të veçantë” i ndryshuar komisioni ka vendosur:

1. Miratimin e shpërblimit për vitin 2021, Njesisë së Shërbimit Ligjor dhe stafin administrativ të Komisionit të Pavarur të Kualifikimi.
2. Njesisë së Shërbimit Ligjor i jepet shpërblimi në masën 25% të pagës mujore.
3. Stafit administrativ i jepet shpërblim në masën e një page mujore.
4. Punonjësve me kohë të prove u jepet shpërblim në masën 10,000 lekë.
5. Efektet financiare përballohen nga buxheti i vitit 2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Në zbatim të vendimeve sa më sipër është paguar shuma prej 8,689.818 lekë.

- Me Vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr.127 prot., nr. 8742/1, datë 31.12.2018 mbështetur në vendimin nr. 813, datë 31.12.2018 “Për një ndryshim në vendimin nr.929, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” i ndryshuar komisioni ka vendosur:

- Miratimin e shpërblimit për vitin 2018 për Komisionerët, Njesisë së Shërbimit Ligjor dhe stafin administrativ të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në masën e një page neto mujore. Në zbatim të vendimit sa më sipër është paguar shuma prej 5,273,193 lekë.

- Me Vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr.65 prot., nr. 4857/1, datë 30.12.2023 mbështetur në VKM-së 834, datë 28.12.2023 “Për një ndryshim të VKM-së nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin e përdorimit të fondit të veçantë” i ndryshuar komisioni ka vendosur:

1. Miratimin e shpërblimit për vitin 2023 për të gjithë Komisionerët në masën e një page mujore neto.

2. Miratimin e një shpërblimi për vitin 2023 për të gjithë stafin e personelit administrativ të përhershëm deri në masën e një page mujore neto në varësi të shumës në dispozicion, si dhe deri në masën 10 mijë lekë për të gjithë punonjësit me kontratë pune të përkohshme, me afat të caktuar.

Në zbatim të vendimit sa më sipër është paguar shuma prej 8,689.818 lekë.

3. Nga auditimi i detyrimeve të lindura sipas Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 35, datë 22.11.2022, me objekt "Shfuqizimi i nenit 12, pika 5, shkronja "a", të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar me nenin 2, pika 1, të ligjit nr. 50/2021, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë", si dhe Vendimit të Komisionit nr. 4 date 31.1.2023, ku nga KPK është bërë përlllogaritjet sipas viteve ka rezultuar një detyrim prej 144,650 mijë lekë.

- Me urdhrin nr. 131, datë 26.12.2023 prot., nr. 4818/4 “*Llogaritjen e pagave për komisionerët dhe këshilltarët e njesisë së shërbimit ligjor me page referuese bazë kategorinë i-b dhe shtesën për page diplomë sipas grupit 1*” ku në mbështetje të nenit C të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 13, pika "c" e ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", në zbatim dhe arsyetim të vendimit nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese, si dhe vendimit nr. 63, datë 22.12.2023, të Mbledhjes së Komisionit, është urdhëruar:

1. Paga për Komisionerët dhe këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor të llogaritet sipas vendimit nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese. Formula e parashikuar në zbatim të vendimit të Mbledhjes së Komisionit nr.63, datë 22.12.2023, sipas legjislacionit në fuqi për pagat, do të jete i nivelit të kategorisë I-b, duke shtuar edhe pagesën për diplomë sipas grupit të diplomës 1 (një), në masën 14,000 lekë.

2. Pagesën e një pjese të diferencës së pagës së komisionerëve dhe këshilltarëve të njesisë së shërbimit ligjor që janë larguar dhe që punojnë aktualisht për periudhën 2017 - 2020.

3. Vlerat përkatëse të ekzekutohen në 2 këste.

4. Për ekzekutimin e kështit të parë, i cili i korrespondon periudhës 2017-2019, do të përdoren fondet e akorduara nga VKM nr. 755, datë 20.12.2023, i cili do të ekzekutohet brenda vitit 2023.

5. Për ekzekutimin e kështit të dytë, do të përdoret teprica e mbetur nga fondi i akorduar nga VKM nr. 755, datë 20.12.2023, si dhe fondet e planifikuara në buxhetin e vitit 2023, të papërdorura dhe të disponoheshë në zërin "Paga" dhe "Sigurime shoqërorë", i cili do të ekzekutohet brenda datës 15.1.2024.

Në vendimin nr. 65 datë 30.12.2023 prot., 4857/1 citohet se:

Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" të rregullores "Për veprimtarinë e Komisionit" miratuar me vendimin nr. 2, datë 19.7.2017, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në zbatim dhe arsyetim të vendimit nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese, e nenit 179/b, pika 8, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në vijim të pikës 1 dhe 3 të VKM-së 834, datë 28.12.2023 “Për një ndryshim të VKM-së nr. 929,

datë 17.11.2010 "Për krijimin e përdorimit të fondit të veçantë" i ndryshuar dhe për shtesë fondi në buxhetin 2023 miratuar për disa institucione" në mbledhjen e datës 30.12.2023 komisioni ka vendosur:

1. Miratimin e shpërblimit për vitin 2023 për të gjithë Komisionerët në masën e një page mujore neto.
2. Miratimin e një shpërblimi për vitin 2023 për të gjithë stafin e personelit administrativ të përhershëm deri në masën e një page mujore neto në varësi të shumës në dispozicion, si dhe deri në masën 10 mijë lekë për të gjithë punonjësit me kontratë pune të përkohshme, me afat të caktuar.
3. Shpërndarjen e fondit prej 40,000 mijë lekë i dhënë për diferencën e pagesës së pagës sipas vendimit nr. 35, datë 22.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese, bashkuar me pjesën e mbetur ende të pashpërndarë nga fondi 60,000 mijë lekë, sipas VKM-së nr. 755, datë 20.12.2023,, pika 2, germa dh, për komisionerët dhe këshilltarët ligjor për periudhën në vijim.
4. Pika 3 e vendimit nr. 63, datë 22.12.2023 të mbledhjes së komisionerëve revokohet. (3. *Vlerat përkatëse të ekzekutohen në 2 këste. Për ekzekutimin e kështit të parë, i cili i korrespondon periudhës 2017-2019, do të përdoren fondet e akorduara nga VKM nr. 755, datë 20.12.2023, i cili do të ekzekutohet brenda vitit 2023. Për ekzekutimin e kështit të dytë, do të përdoret teprica e mbetur nga fondi i akorduar nga VKM nr. 755, datë 20.12.2023, si dhe fondet e planifikuara në buxhetin e vitit 2023, të papërdorura dhe të disponoheshin në zërin "Paga" dhe "Sigurime shoqërore", i cili do të ekzekutohet brenda datës 15.1.2024).*

Sa më sipër në zbatim të vendimeve të komisionerëve nga Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve janë kryer pagesat ndaj Komisionerëve dhe Këshilltarëve si më poshtë.

Në total në shumë prej 36,998,977 lekë, e cila ka të bëjë me vlerën neto sipas përlllogaritjes së detyrimeve për periudhën 2017 -2019, përkatësisht:

- Me urdhër shpenzimit nr. 331 datë 28.12.2023 në shumën prej 21,188,535 lekë;
- Me urdhër shpenzimit nr. 332 datë 28.12.2023 në shumën prej 14,324,579 lekë;
- Me urdhër shpenzimit nr. 333 datë 28.12.2023 në shumën prej 1,498,864 lekë;

Në total në shumë prej 62,049,309 lekë, e cila ka të bëjë me vlerën neto sipas përlllogaritjes së detyrimeve për periudhën 2020 deri në shtator të 2022, përkatësisht:

- Me urdhër shpenzimit nr. 338 datë 11.01.2024 në shumën prej 32,186,224 lekë;
- Me urdhër shpenzimit nr. 339 datë 11.01.2024 në shumën prej 27,730,171 lekë;
- Me urdhër shpenzimit nr. 340 datë 11.01.2024 në shumën prej 2,132,914 lekë;

Vlera prej 7,450,951 lekë, e cila ka të bëjë me vlerën neto sipas përlllogaritjes së detyrimeve për periudhën shtator të 2022 - dhjetor 2022 është e palikuiduar nga KPK deri me datën 30.09.2024.

Në shtator në listëpagese është përlllogaritur vlera prej 251,902 lekë, e cila ka të bëjë me një diferencë për shtatë këshilltarë ligjor të papërfshirë në likuidimin e realizuar nga KPK në muajin janar të vitit 2024.

KPK me shkresën nr. 4832, datë 27.12.2023 drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë është kërkuar që:

- Bazuar në Aktin Normativ me nr.6 datë 14.12.2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023" të ndryshuar, VKM-së nr.755 datë 20.12.2023 "Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023 për disa institucione të pavarura, të krijuar me ligji" në zbatim dhe arsyetim të vendimit nr.35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese, vendimit të Mbledhjes së Komisionerëve nr. 63, datë 22.12.2023, bashkëpunimin për pasqyrimin e ndryshimeve të nevojshme të deklaratave tatimore në sistemin elektronik të tatimeve (ESIG025), për periudhën nëntor 2017- 2020, sipas listëpagesave të reja të ndryshuara për çdo muaj për Komisionerët dhe Këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor.

- Duke qenë që kjo procedurë sjell si pasoje që në sistem të gjenerohen edhe detyrimet e reja, gjobat dhe interesat sipas ndryshimeve përkatëse, në zbatim të udhëzimit nr. 15, datë 12.06.2023 "Për një shtesë në udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar", pika 114.5, paragrafët "a" dhe "b", përcaktohet se:

"114.5 Gjobat për deklarate të pasaktë dhe pagesë të vonuar të detyrimeve për shkak të ndryshimit të listë pagesave dhe gjobat për deklarim të vonuar të formularëve të të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe të larguarve nga puna, nuk aplikohen për organet e qeverisjes qendrore apo vendore, institucionet kushtetuese dhe institucionet e tjera që financohen nga buxheti i shtetit në rastet e:

a) zbatimit të një akti ligjor apo nënligjor me efekte prapavepruese;

b) zbatimit të një vendimi gjykate të formës së prerë".

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka kërkuar mos aplikimin e gjobave dhe interesave, si dhe heqjen e tyre nga sistemi tatimor për periudhën nëntor 2017 - 2020.

Si dhe në vijim të VKM-së nr.755, datë 20.12.2023, pika 4, theksohet se *"Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e përmendura në pikën 2 për zbatimin e këtij vendimi. Shlyerja e pagesës bëhet nga institucionet e sistemit të drejtësisë brenda datës 15.1.2024"*

- KPK me shkresën nr. 143, datë 22.01.2024 drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë është kërkuar që në vijim të shkresës nr. 4832, datë 27.12.2023 bashkëpunimin për pasqyrimin e ndryshimeve të nevojshme të deklaratave tatimore në sistemin elektronik të tatimeve (ESIG025), për periudhën Janar 2021- Dhjetor 2022, sipas listëpagesave të reja të ndryshuara për çdo muaj për Komisionerët dhe Këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor.

Detyrimet e KPK (principali) për sigurime të lindura në zbatim të vendimit nr.35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese sipas pasqyrimin të ndryshimeve të deklaratave tatimore në sistemin elektronik të tatimeve (ESIG025), rezulton përkatësisht:

- Për periudhën nëntor –dhjetor 2017 në shumën prej 102,300 lekë.
- Për periudhën janar –dhjetor 2018 në shumën prej 7,125,730 lekë.
- Për periudhën janar –dhjetor 2019 në shumën prej 7,890,175 lekë.
- Për periudhën janar –dhjetor 2020 në shumën prej 7,444,533 lekë.
- Për periudhën janar –dhjetor 2021 në shumën prej 10,120,660 lekë.
- Për periudhën janar –dhjetor 2022 në shumën prej 11,158,684 lekë.

- KPK me shkresën nr. 1254, datë 09.05.2024 drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financës është kërkuar që:

Në zbatim të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese me nr. 35, datë 22. 11.2022, si dhe të Vendimit nr. 755, datë 20.12.2023 të Këshillit të Ministrave "Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për disa institucione të pavarura të krijuara me ligj", Vendimit nr. 834, datë 28.12.2023 të Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në Vendimin nr. 929, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçante" i ndryshuar, dhe për shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për disa institucione sipas vendimit të Gjykatës kushtetuese nr.35/2022", Komisionit të Pavarur të Kualifikimit iu akordua shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, shuma prej 100 milion leke.

Në vijim, të shkresës nr. 522 datë 20.2.2024 "Kërkesë për fonde shtesë për vitin 2024", si dhe në zbatim të Vendimit nr. 35, datë 22.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese, ku është kërkuar fondin prej 52 milion lekë në buxhetin e vitit 2024, që do të nevojitet për kryerjen e pagesës për detyrimin e lindur kundrejt tatimeve, si dhe detyrimet e diferencave të pagave për Komisionerët dhe Këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, për një periudhë ende të palikuiduar për vitin 2022 (gjithsej rreth 8 milion lekë).

- Nga Drejtoria e mbledhjes së Detyrimeve të papaguara nga Administrata tatimore me shkresën nr. 39417, datë 15.08.2024 “Njoftim dhe kërkesë për të paguar”, Komisioneri është njoftuar për detyrimin tatimor, në shumën prej 67,435,702 lekë i ndarë në;
- Principal në shumën prej 43,842,082 lekë;
- Gjoha në shumën prej 10,997,219 lekë;
- Interesa në shumën prej 12,596,301 lekë.
- KPK me shkresën nr. 1857, date 20.08.2024 drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë është kërkuar që duke qenë se, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është në vitin e fundit të mandatit të tij kushtetues dhe të përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ku bazuar në nenin 179/b, pika 8 të Kushtetutës ky mandat përfundon me 31.12.2024, miratim fondesh buxhetore për mbylljen e të gjithë detyrimeve institucionale të krijuara dhe që do krijohen deri më datën 31.12.2024, ku janë cituar dhe argumentuar të gjitha nevojat.

Shënim: Të gjitha detyrimet janë likuiduar me datën 31.12.2024 sipas urdhër shpenzimeve me nr. 281-342, datë 31.12.2024 pagese principali në shumën prej 43,842,081 lekë dhe urdhër shpenzimin nr. 359-433, date 31.12.2024 pagesë interesa në shumën prej 12,746,802 lekë, bazuar në Aktin normativ nr.5, datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, i ndryshuar.

Konkluzion:

Nga auditimi i listëpagesave për llogaritjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sigurimin suplementar dhe tatimit mbi të ardhurat personale rezultoi se janë llogaritur në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Nga KPK në zbatim të vendimit nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese janë pasqyruar të gjitha ndryshimet e nevojshme të deklaratave tatimore në sistemin elektronik të tatimeve (ESIG025), për periudhën nëntor 2017- 2022, sipas listëpagesave të ndryshuara për çdo muaj për Komisionerët dhe Këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor.

Konstatim:

Nga auditimi u konstatua se, nga KPK në fund të vitit ushtrimor 2023 nuk janë raportuar detyrimet e prapambetura për sigurimet në vlerën 43,842,082 lekë, si dhe vlera prej 7,450,951 lekë, e cila ka të bëjë me vlerën neto të pagave sipas përlllogaritjes së detyrimeve për periudhën shtator 2022 - dhjetor 2022. *Për këto detyrime është vënë në dijeni MF nëpërmjet shkresave të dërguara nga KPK për alokim fondesh për shlyerjen e tyre.*

KPK nuk ka cituar detyrimet që ka për pagesa për sigurime shoqërore dhe shëndetësore të akumuluar, si rezultat i zbatimit të vendimit nr. 35, date 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese.

Sa më sipër veprimet janë në kundërshtim me:

Udhëzimin e MFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme” paragrafi III “Përgjegjësitë e strukturave përfshirëse për raportim dhe publikim” ku përcaktohet se;

1. Në zbatim të legjislacionit në fuqi struktura përgjegjëse për financat e njësisë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqet menjëherë në strukturën përgjegjëse për Thesarin në degë detyrimet e prapambetura (për të cilat nuk ka fonde disponibel për të kryer regjistrimin në SIFQ dhe pagesën në afatin e miratuar) nëpërmjet dokumentit "Urdhër regjistrimi i detyrimit të prapambetur* (URDP), formati sipas Tabelës 4 të Aneksit 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi. URDP të ketë bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin justifikues.
2. Struktura përgjegjëse për Thesarin në dege, pas kontrollit të ushtruar në zbatim të legjislacionit në fuqi, regjistron në SIFQ detyrimin e paraqitur nga njësia shpenzuese sipas pikës së mësipërme (një ditar për një URDP) në zbatim të udhëzimit nr. 8, prot., nr. 5055, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitës, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare

vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" (ne llogarinë ekonomike 4864-"Shpenzime te periudhave te ardhshme për detyrime te prapambetura"...

- Me udhëzimin nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, si dhe Udhëzimin të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar ku citon:

58. Plani vjetor i buxhetit, i akorduar në nivel titulli, kapitulli dhe artikulli, përfaqëson limitin maksimal të lejuar për t’u shpenzuar nga njësitë shpenzuese. *Gjatë detajimit të planit të buxhetit, njësitë e qeverisjes qendrore më parë detajojnë fonde për të paguar detyrimet e mbartura të viteve të kaluara për të gjitha llojet e shpenzimit.*

186. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, që, për mungesë fondesh buxhetore apo faktorë të tjerë, kanë detyrime të palikuiduara dhe presin për t’u paguar në periudha të ardhshme, duhet të kryejnë **regjistrimin dhe evidentimin në kontabilitet** dhe në SIFQ të këtyre detyrimeve të prapambetura (për këtë qëllim do të shërbejë manuali përkatës i procedurës së regjistrimit dhe evidentimit në kontabilitet dhe në SIFQ).

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme kur paraqesin në degën e thesarit të juridiksionit të tyre urdhër-shpenzimin, i cili lidhet me një regjistrim të mëparshëm në SIFQ si detyrim i prapambetur (në dokumentet justifikuese është shënuar paraprakisht numri i transaksionit (ditarit kontabël) të regjistruar në SIFQ si detyrim i prapambetur), paralelisht paraqesin në degën e thesarit edhe kërkesën për stornimin në SIFQ të regjistrimit të detyrimit të prapambetur. Stornimi i detyrimeve të prapambetura regjistruar me parë në SIFQ duhet të bëhet me kujdes dhe përgjegjësi, në mënyrë që të sigurohet mos dublimi i të dhënave të detyrimeve të prapambetura në kontabilitet. Të njëjtat veprime duhet të kryhen edhe nga institucionet me akses direkt në SIFQ.

Çdo fund muaji, dega e thesarit rakordon me njësitë e qeverisjes së përgjithshme të juridiksionit të saj mbi balancat e detyrimeve të prapambetura të evidentuara në SIFQ. Institucionet me akses direkt në SIFQ kanë përgjegjëshmërinë të sigurojnë saktësinë mbi të dhënat e detyrimeve të prapambetura të evidentuara prej tyre në SIFQ.

Regjistrimet si më sipër do të kryhen gjatë gjithë vitit buxhetor, menjëherë sapo institucioni buxhetor evidenton krijimin e një detyrimi të prapambetur, *gjë e cila nuk është realizuar nga KPK.*

2.2 Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.

Në zbatim të këtij drejtimi të auditimit u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- Strukturat organike të miratuara dhe të dhëna mbi të vëna në dispozicion nga KPK;
- Baza ligjore e nënligjore që specifikon trajtimin e punonjësve të KPK-së;
- Listëpagesat;
- Dosjet e personelit të punonjësve të KPK-së;
- Rekrutimet dhe procedurat e ndjekura, largimet nga puna;
- Vendimet gjyqësore dhe zbatimi i tyre.

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligji nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
- Vendimi nr.93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” i ndryshuar;

- Vendimi nr.100/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”;
- Vendimi nr.83/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” i ndryshuar;
- Vendimi nr.36/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” i ndryshuar;
- Vendimi nr.36/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” i ndryshuar;
- VKM nr.102, datë 27.2.2019 ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.16, datë 16.1.2019 “Për caktimin e numrit të punonjësve me kontratë “Të përkohshme pune për vitin 2019 në njësitë e qeverisjes qendrorë”;
- VKM nr.47, datë 22.1.2020 ‘Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes qendrorë’;
- VKM nr.1151, datë 24.12.2020 ‘Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendrorë’;
- VKM nr.35, datë 19.1.2022 ‘Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2022, në njësitë e qeverisjes qendrorë’;
- VKM nr.56, datë 1.2.2023 ‘Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023, në njësitë e qeverisjes qendrorë’;
- VKM nr.39, datë 24.1.2024 ‘Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024, në njësitë e qeverisjes qendrorë’;
- VKM nr.325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabinetit, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike” I ndryshuar;
- VKM Nr. 326, datë 31.5.2023 “Për pagat e Punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialistëve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”;
- Rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” miratuar me vendimin nr.11, datë 19.02.2018, ndryshuar me vendimin nr.26, datë 28.6.2022;
- Rregullore ‘Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit’ miratuar me vendimin nr.2, datë 19.07.2017, ndryshuar me vendimin nr.11, datë 4.03.2024.

a. Respektimi i strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin:

Struktura organike e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) për periudhën objekt auditimi (01.10.2017 deri më datë 30.09.2024) ka funksionuar në zbatim të Vendimi nr.93/2017, datë 29.9.2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, vendimit nr.100/2018, datë 4.10.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.93/2017 ‘Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit’, vendimit nr.83/2020, datë 23.12.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.93/2017 ‘Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit’, vendimit nr.36/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.93/2017 ‘Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit’ dhe Vendimit nr.36/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin

nr.93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, i ndryshuar.

Nga auditimi rezultoi se:

- Për vitin 2017, numri total i punonjësve në strukturë sipas Vendimit nr.93, datë 29.9.2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, ishte me 12 komisionerë; 16 këshilltar dhe 22 staf administrativ, ndërsa numri faktik i punonjësve rezultoi 43, me 7 vendet vakante, 1 për këshilltar jurist, 1 drejtor i marrëdhënieve me jashtë, 2 specialiste sekretarie gjyqësore, 1 koordinator për marrëdhënien me median dhe jashtë, 1 specialist IT, 1 shofer.

- Në Tetor të vitit 2018 me Vendimin nr.100, datë 4.10.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr.93/2017, datë 29.9.2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, numri i punonjësve në strukturë u miratua me 64 (plani), ku nga ndryshimet në organikë janë shtuar 8 këshilltarë në njësinë e shërbimit ligjor, 4 punonjës në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun, 2 punonjës në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Në fund të vitit 2018 numri faktik i punonjësve është 49, me 15 vendet vakante, 1 për këshilltar jurist, 8 për këshilltar ekonomist, 1 drejtor i Menaxhimit të Çështjeve, 2 specialist sekretare gjyqësore. 2 përkthyes, 1 specialist protokoll arkive.

- Në vitin 2019 institucioni i KPK ka marrë punonjës me kontratë pune të trajtuar sipas vendimit nr.102, datë 27.02.2019, ku rezultoi se janë marrë me kontratë pune 1 specialist për redaktimin e vendimeve, 1 specialist protokoll arkive, 2 specialist për sekretarinë gjyqësore.

Referuar vendimit nr.102, datë 27.02.2019 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2019 në njësitë e qeverisjes qendrore” për KPK janë miratuar 5 pozicione, 1 punonjës protokoll/arkive, 2 specialistë për sekretarinë gjyqësore, 2 specialistë për Redaktim vendimi. Pra rezultoi se (1) pozicion specialist për redaktim vendimi nuk është plotësuar.

Në fund të vitit 2019 numri faktik i punonjësve është 60, me 4 vendet vakante, 1 specialist për redaktimin e vendimeve. 2 përkthyes, 1 specialist protokoll arkive.

- Në fund të vitit 2020 numri faktik i punonjësve është 59, me 5 vendet vakante, 1 këshilltar ekonomik dhe 3 përkthyes dhe një specialist financë/prokurime.

- Në Dhjetor 2020, me Vendimin nr.83/2020, datë 23.12.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr.93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, numri i punonjësve në strukturë ndryshoi me 76 (plani), me efekt datë 01.01.2021.

- Me vendimin nr.1151, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendrore” janë miratuar (6) pozicione për institucionin e Pavarur të Kualifikimit, 1 punonjës mirëmbajtje, 3 sekretar gjyqësor, 1 specialist redaktor, 1 Arkivist. Referuar faktit rezultoi se në KPK janë marrë me kontratë pune për vitin 2021, (2) punonjës mirëmbajtje secili me kontratë pune 2 mujore dhe 8 mujore për 1 vit, (7) sekretarë gjyqësor secili me kontratë me afat të caktuar brenda 1 viti, (1) specialist redaktor, (2) specialist arkiv/protokolli secili me kontratë me afat të caktuar brenda 1 viti.

Në fund të vitit 2021 numri faktik i punonjësve është 73, me 3 vendet vakante përkthyes.

- Me Vendimin nr.36/2022, datë 12.5.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr.93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, numri i punonjësve në strukturë u miratua me 76 (plani), ku janë shtuar dy pozicione jurist, një pozicion specialist financë /prokurime dhe janë zvogëluar në strukturë pozicioni përkthyesi nga pesë në dy.

Në fund të vitit 2022 numri faktik i punonjësve është 73, me 3 vende vakante, një specialist jurist, 2 këshilltar jurist.

- Me vendimin nr.56, datë 1.2.2023 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023, në njësitë e qeverisjes qendrore” janë miratuar (8) pozicione për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, 1 punonjës mirëmbajtje, 3 sekretar gjyqësor, 1 specialist redaktor, 3 arkivist.

Në fund të vitit 2023 numri faktik i punonjësve është 73, me tre vende vakante, një këshilltar jurist, një pozicion sekretar i Kryetarit dhe një specialist financë-buxhet.

- Me Vendimin nr.36/2024, datë 11.4.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr.93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, numri i punonjësve në strukturë nuk ndryshoi, por u miratuan 76 (plani)”

Me vendimin nr.39 datë 24.1.2024 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024, në njësitë e qeverisjes qendrore” janë miratuar (9) pozicione për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, 2 punonjës mirëmbajtje, 4 sekretar gjyqësor, 1 specialist redaktor, 2 arkivist/protokolli. Referuar faktit rezulton se në KPK janë marrë me kontratë pune për vitin 2023, (1) punonjës mirëmbajtje, 4 sekretarë gjyqësor, 1 specialist redaktor, 2 specialist arkiv/protokolli, pra janë marrë 8 punonjës me kontratë pune të përkohshme, 1 pozicion punonjës mirëmbajtje nuk është plotësuar.

- Në 30.09.2024 numri faktik i punonjësve është 74, me 4 vende vakante tre këshilltar jurist, një këshilltar ekonomik¹

b. Planet e Rekrutimit :

Për vitin 2019, 2020, 2021, 2022, 2023 është përcaktuar harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Sipas përshkrimeve të procesit, bazuar në Vendimin e Kuvendit Nr.100/2018, nr.100/2019, nr.83/2020, nr.36/2021, nr.36/2022, me fondet buxhetore për pagat e personelit të KPK për buxhetin e vitit 2019,2020,2021,2022,2023 nëpërmjet specialistes së burimeve njerëzore është vendosur për planin e rekrutimit për vitet 2019; 2020; 2021; 2022 dhe 2023 dhe është urdhëruar fillimi i procedurave përkatëse të rekrutimit.

Tabelë përmbledhëse e strukturës plan/fakt.

Viti	Plan	Fakt	Vakancat
2017	50	43	7
2018	64	49	15
2019	64	60	4
2020	76	73	3
2021	76	73	3
2022	76	73	3
2023	76	73	3
2024	76	74	2

c. Rekrutimet dhe Largimet nga puna.

Gjatë vitit 2017, ka pasur 31 rekrutime të reja.

Për vitin 2018 ka pasur 11 rekrutime të reja, ndërsa ka pasur 8 largime nëpërmjet dorëheqjes.

Për vitin 2019 në KPK ka pasur 18 rekrutime të reja, ndërsa janë marrë me kontratë të përkohshme 5 punonjës. Ka pasur 6 largime për punonjësit të emëruar dhe 5 largime për punonjësit me kontratë pune të përkohshme.

Për vitin 2020 ka pasur 11 rekrutime të reja, ndërsa janë marrë me kontratë të përkohshme 4 punonjës. Ka pasur 13 largime për punonjës të emëruar dhe 4 largime për punonjës me kontratë të përkohshme.

¹ Dy pozicione pune të palotësuar dhe dy pozicione pune me leje lindje, për të cilat gjatë kësaj periudhe duhet të plotësoheshin me punonjës me kontratë. (problematike e hasur në vitin 2024)

Gjatë vitit 2021 ka pasur 24 rekrutime të reja, ndërsa janë marrë me kontratë të përkohshme 12 punonjës. Sa i përket largimeve janë larguar 10 punonjës me emërim dhe 12 punonjës me kontratë të përkohshme.

Gjatë vitit 2022 ka pasur 13 rekrutime të reja, ndërsa janë marrë me kontratë të përkohshme 11 punonjës. Ka pasur 10 largime nga puna dhe 11 largime për punonjësit me kontratë të përkohshme.

Gjatë vitit 2023 ka pasur 12 emërim te reja, ndërsa janë marrë me kontratë të përkohshme 9 punonjës. Ka pasur 16 largime dhe 9 largime të punonjësve me kontratë të përkohshme.

Tabelë përmbledhëse për Rekrutimet dhe largimet nga puna

Viti	Rekrutime			Largime		
	Emërim		Me kontratë të përkohshme	Nga të emëruarit		Kont. Përkohshme
	Staf administrativ	Njësia e Shërbimit Ligjor		Staf administrativ	Njësia e Shërbimit Ligjor	
2017	16	15	-	-		-
2018	8	2	-	6	2	-
2019	7	11	5	3	3	5
2020	4	7	4	5	8	4
2021	7	17	12	6	4	12
2022	11	2	11	6	4	11
2023	1	11	9	6	10	9

Në vijim, u verifikua ekzistenca e rasteve të ndërprerjes së marrëdhënies të punës në mënyrë të njëanshme nga punëmarrësi dhe nuk rezultoi ndonjë rast i zgjidhjes së marrëdhënies së punës nga ana e institucionit. Për të gjithë periudhën objekt auditimi rezultoi se, nga ana e strukturës së audituar nuk ka pasur tejkalim të planeve të rekrutimeve të miratuara.

Procedurat e rekrutimit përfshijnë të gjitha aktivitetet e ndryshme si;

Publikimin në faqen e KPK të vendeve vakante, dhe të QPZ, ndjekja e procedurave të parashikuara në ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, rregulloren “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” dhe rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së KPK”; Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë ;

- Organizimin e konkurseve nëpërmjet ndjekjes së fazave përkatëse, nga komiteti **ad-hoc** i cili zgjidhet rast pas rasti, paraprake dhe fazës përfundimtare, përzgjedhjes;

- Shpalljet e listës së fituesve (për njësinë e shërbimit ligjor) në portalin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ndjekja e afateve kohore për shpalljen e fituesve;

- Emërimin e fituesve në vendet e zgjedhura prej tyre.

Marrëdhëniet e punësimit të punonjësve të institucioneve të rivlerësimit rregullohen sipas ligjit nr.84/2016 ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, Kodit të Punës dhe Rregullores “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” miratuar me vendimin nr.2, datë 19.7.2017.

Grupi i auditimit ka kërkuar nga KPK vënien në dispozicion të praktikës që është ndjekur për kryerjen e procedurave të rekrutimit, dhe nëpërmjet e-mail të datës 17.01.2025, 03.02.2025, znj. S.Sh. (ish-punonjës specialist i Burimeve Njerëzore pranë KPK), ka vënë në dispozicion një përshkrim narrativ e një hartë të procesit të punës, sa i përket rekrutimit të të dy kategorive të punonjësve.

a. Procedura e rekrutimit të punonjësve administrativ

Autoriteti përgjegjës për pranimin në punë të punonjësve është **komiteti ad hoc**, që krijohet pranë çdo institucioni. Ai përbëhet nga 2 anëtarë të Komisionit ose të Kolegjit të Apelimit,

përkatësisht sipas rastit, të zgjedhur më short, si dhe nga Komisioneri Publik më i vjetër në moshë. Në zbatim të nenit 18, pika 4 të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe rregullores “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” miratuar me vendimin nr.2, datë 19.7.2017, nga mbledhja e komisionereve është ngritur komiteti *ad hoc* për përzgjedhjen e “*punonjësve administrativë*” në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.84/2016, është bërë njoftimi publik në faqen zyrtare të KPK-së info@kpk.al dhe në faqen e Qendrës së Botimeve Zyrtare për pozicionin e shpallur vakant në KPK, ku është përcaktuar dhe afati për dorëzimin e dokumenteve të kandidatëve. Më pas komiteti *ad hoc*, pas përfundimit të afatit të aplikimeve, ka marrë në shqyrtim dokumentacionin e kandidatëve aplikantë për pozicionin e shpallur vakant dhe ka renditur kandidatët që plotësojnë kriteret sipas njoftimit publik, si dhe është caktuar data për zhvillimin e intervistës me secilin kandidat që përmbush kriteret.

Komiteti *ad hoc* ka vijuar me mbajtjen e procesverbalit pas realizimit të intervistave duke bërë vlerësimin e kandidatëve dhe shpalljen e kandidatit fitues.

Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është konceptuar urdhri i emërimit në detyrë dhe kontrata e punës, dhe më pas është vijuar me procedurën për firmosjen e kontratës nga ana e kandidatit fitues. Sekretari i Përgjithshëm firmos urdhrat e emërimit dhe kontratat.

Burimet Njerëzore në dosjen e punonjësit administrojnë:

- Dokumentacionin personal.
- Një kopje të urdhrat të emërimit dhe të kontratës.
- Dokumentacionin e procedurës së rekrutimit në një dosje të veçantë.

b. Procedura e rekrutimit për Njësinë e Shërbimit Ligjor

Sa i përket procedurës së rekrutimit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, në nenin 22 të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se procesi i rekrutimit të njësisë së shërbimit ligjor, ku përfshihen këshilltarët ligjorë dhe ekonomikë, bazohet në një procedurë të hapur për përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar dhe se vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga komiteti *ad-hoc* i krijuar për këtë qëllim. Në nenin 22 të Rregullores për veprimtarinë e KPK, të miratuar nëpërmjet Vendimit të KPK nr. 2, datë 19.07.2017, i ndryshuar, përcaktohet se këshilltarët ligjorë dhe ekonomikë emërohen nga mbledhja e komisionereve, pasi kryhet procesi i vlerësimit të tyre nga komiteti Ad-Hoc, sipas nenit 22 të Ligjit 84/2016.

Sa i përket procedurës, për vlerësimin e kandidatëve për “*Këshilltarë të njësisë së shërbimit ligjor*”, komiteti *ad hoc* bazohet në:

- a) dokumentacionin e paraqitur prej tyre për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve formale, të përcaktuara në pikat 2 dhe 3, të nenit 22, të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- b) në seancën dëgjimore që do të zhvillohet me ta.

Nga auditimi rezultoi se në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.84/2016, janë bërë njoftimet publike në faqen zyrtare të KPK-së info@kpk.al dhe në faqen e Qendrës së Botimeve Zyrtare, kur ka pasur shpallje për pozicionet “këshilltar ligjor/ekonomik” në KPK, ku dhe është përcaktuar dhe afati për dorëzimin e dokumenteve të kandidatëve. Në vijim është mbajtur procesverbal i komitetit *ad hoc* për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët aplikantë për pozicionin përkatës. Pas verifikimit të dokumentacionit nga komiteti, janë njoftuar kandidatët që plotësojnë kriteret, për dhënien e intervistës në datën dhe orën e caktuar nga komiteti.

Në vijim, komiteti *ad hoc* ka mbajtur procesverbal ku janë paraqitur kandidatët e kaluar në fazën e intervistës me gojë dhe nga intervistimi, komiteti cakton shpalljen e kandidatit që plotëson kriteret për pozicionin e punës “Këshilltar në Njësinë e Shërbimit Ligjor”.

Komiteti *ad hoc* i drejtohet mbledhjes së komisionerëve, ku relaton për procedurën e zhvilluar dhe bashkëlidh procesverbalin. Mbledhja e komisionerëve shpall kandidaturën fituese. Burimet Njerëzore njoftojnë kandidatin fitues nëpërmjet adresës zyrtare të institucionit të KPK-së: info@kpk.al.

Burimet Njerëzore konceptojnë urdhrin e emërimit në detyrë dhe kontratën e punës, të cilat firmosen nga Kryetari.

Burimet Njerëzore në dosjen e punonjësit administrojnë:

- Dokumentacionin personale.

- Një kopje të urdhrin të emërimit dhe të kontratës.

- Dokumentacionin e procedurës së rekrutimit në një dosje të veçantë.

Për sa i përket dosjeve të personelit u panë rreth 49 dosje nga të cilat 28 janë për Njësinë e Shërbimit Ligjor dhe 21 për stafin administrativ, ku nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes personale të secilit punonjës, rezultoi se këto procedura gjenden të administruara në një dosje të veçantë të administruar nga burimet njerëzore.

Konstatim:

- Nga auditimi rezulton se sa i përket rekrutimit të punonjësve administrativë, nuk rezulton që KPK të ketë hartuar një procedurë të shkruar, ku të jenë përcaktuar hapat dhe elementët proceduralë që do të ndiqen për këtë kategori punonjësish.

- Nga auditimi rezulton se nuk ka një procedurë të shkruar dhe të miratuar (*rregullore, udhëzim*) “Për veprimtarinë e komitetit *ad hoc* për administrimin e procesit të emërimeve në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” të miratuar nga Mbledhja e Komisioneve në mbështetje të nenit 179/b e të aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 3, të nenit 69, pikës 3 dhe 4 të nenit 18, pikës 1, 2 të nenit 22 dhe germës dh) të nenit 21 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të pikës 1 të nenit 9 dhe të nenit 22 të rregullores për veprimtarinë e komisionit të pavarur të kualifikimit, si dhe në zbatim të përcaktimeve të Manualit Financiar dhe Kontrollit.

d. Zbatimi i vendimeve gjyqësore dhe ekzekutimi i tyre.

- Me Vendimin nr. (pa numër), datë 30.05.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Palë paditëse, Valbona Sanxhaktari, palë e paditur Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me objekt: “Detyrimin e palës paditur të paguajë shtesën e vjetërsisë në punë për periudhën Qershor 2018-Dhjetor 2021 (kohë në të cilën është paraqitur kërkesë-padia) në masën 226.752 lekë. Detyrimin e palës së paditur të paguaj në vijim shtesën për vjetërsi në punë.

Bazuar në këtë vendim, me urdhrin nr. 68, datë 17.06.2022, datë 17.6.2022, Kryetari i KPK ka vendosur ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke kryer pagesën e shtesës për vjetërsinë në punë për periudhën Qershor 2018-Dhjetor 2021, në masën 226.752 lekë. Kryerjen e pagesës shtesë për vjetërsinë në punë për periudhën 1 Janar 2022- 31 Maj në masën 47.240 lekë. Pagesa e vjetërsisë së muajit Qershor 2022 e të muajve në vijim do të paguhet si pjesë e pagës bruto mujore.

Sa më sipër nga KPK me urdhër shpenzimin nr. 107, datë 21.06.2022 është bërë likuidimi i detyrimit ndaj gjyqëfituesit në shumën prej 236,193 leke.

- Vendimi nr.91, datë 16.02.2023, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Kërkues, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Persona të tretë, z. S.E, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, çështja me objekt: “*Kërkesë për interpretim të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.3265, datë 13.06.2022*”. Në këtë vendim gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë së palës paditëse, KPK-së, dhe shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës kërkuese.

Sa më sipër, nga KPK me urdhër shpenzimin nr.223, datë 29.08.2023 është bërë likuidimi i detyrimit ndaj gjyqëfituesit në shumën prej 1,274,865 lekë.

- Vendimi nr.4053, datë 05.6.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë paditëse, znj. F.Z, palë e paditur, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me objekt: “Detyrimin e palës së paditur për pagesën e një page mujore të plotë për mosrespektim të afatit të njoftimit prej 1 muaj, në përmbushje të përcaktimeve të neneve 141 dhe 143, pika 1 të Kodit të Punës. Detyrimin e palës së paditur për dhënien e shpërblimit që më takon sipas pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.813, datë 31.12.2018 “Për një ndryshim në vendimin nr.929, datë 17.1.2010 të Këshillit të Ministrave për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” i ndryshuar ka vendosur “Rrëzimin e padisë, shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.

Vendimi nr.114, datë 19.02.2024 i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me palë paditëse, Fjona Zacaj dhe palë të paditur, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me objekt: “Detyrimin e palës së paditur për pagesën e një page mujore të plotë për mosrespektim të afatit të njoftimit prej 1 muaj, në përmbushje të përcaktimeve të neneve 141 dhe 143, pika 1 të Kodit të Punës. Detyrimin e palës së paditur për dhënien e shpërblimit që më takon sipas pikës 1 të vendimit të këshillit të ministrave nr.813, datë 31.12.2018 “Për një ndryshim në vendimin nr.929, datë 17.1.2010 të Këshillit të Ministrave për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar, ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr.4053, datë 5.6.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me këtë ndryshim: Detyrimi i palës së paditur, ti paguajë paditëses shpërblim sipas pikës 1 të VKM nr.813, datë 31.12.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, nga KPK me urdhër shpenzimin nr. 140, datë 27.06.2024 është bërë likuidimi i detyrimit ndaj gjyqëfituesit në shumën prej 233,135 lekë.

2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare

Në zbatim të këtij drejtimi të auditimit u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrjet, fletëdaljet, faturat tatimore dhe urdhër-shpenzimet;
- Transaksionet e llogarive bankare/ ditarët e bankës dhe transaksionet nëpërmjet arkës;
- Pagesa për shërbime e mallra/ shërbime, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme;
- Dokumentacioni shoqërues i marrjes në dorëzim;

Auditimi i këtij drejtimi u bazua në:

- Ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- Udhëzim Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Auditimi u ushtrua me zgjedhje. Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar). “Kampioni i auditimit” dhe ISSAI 1530 “Shënime praktike mbi ISA 530”.

Nga auditimi me zgjedhje mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër-shpenzim, etj.) të realizuara nga Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse të KPK-së, rezultoi se në përgjithësi veprimet janë kryer konform Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

a. Auditimi i transaksioneve të kryera me bankën.

Urdhër-Shpenzimet e përzgjedhura u audituan në funksion të UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e

kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si dokumente autorizues, dokumente vërtetues, dokumente të kontabilitetit, etj., si dhe në përcaktimin e “gjurmëve të auditimit” referuar UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Auditimi u ushtrua me zgjedhje konkretisht, u audituan shpenzimet me anë të bankës të kaluara nëpërmjet Degës së Thesarit Tiranë të kryera për llogari të institucionit të KPK.

Nga grupi i auditimit janë audituar shpenzimet të cilat kanë të bëjnë me *blerje shkresore nën 100,000 lekë, shpenzime dieta jashtë vendit, shpenzime për bileta avioni, shpenzime dieta brenda vendit etj.*, të kryera nga KPK përgjatë viteve 2017 deri me 30.09.2024.

Për vitin 2017, nga KPK janë realizuar blerje shkresore nën 100.000 lekë, në total 3 procedura blerje me vlerë 138,425 lekë.

Për vitin 2018, nga KPK janë realizuar blerje shkresore nën 100.000 lekë, në total 23 procedura me vlerë 1,587,132 lekë. Dieta brenda vendit në total 885,000 lekë.

Dieta jashtë vendit Viti 2018:

Për vitin 2018 janë tërhequr nga banka në total 17,256 lekë, për mbulimin e dietave jashtë vendit nëpërmjet urdhër shpenzimit Nr.53, datë 05.04.2018 me të cilin është kryer konvertim i shumës nga lekë në euro dhe janë kryer pagesat e dietave në përputhje me VKM Nr.870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” dhe me UMF Nr.22, datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e VKM Nr.870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

Për vitin 2019, nga KPK janë realizuar blerje shkresore nën 100.000 lekë, në total 20 procedura me vlerë 1,103,316 lekë dhe 2 procedura me SDB, për blerje biletash në vlerë 270,275 lekë. Dieta brenda vendit në total 568,400 lekë.

Dieta jashtë vendit Viti 2019:

Për vitin 2019 tërhequr nga banka në total 395,634 lekë, për mbulimin e dietave jashtë vendit nëpërmjet urdhër shpenzimeve Nr.72, datë 16.04.2019, Nr. 210, datë 29.10.2019 me të cilin është kryer konvertim i shumës nga lekë në euro dhe janë kryer pagesat e dietave në përputhje me VKM Nr.870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” dhe me UMF Nr.22, datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e VKM Nr.870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

Për vitin 2020, nga KPK janë realizuar blerje shkresore nën 100.000 lekë, në total 19 procedura me vlerë 1,270,739 lekë. Dieta brenda vendit në total 165,800 lekë.

Për vitin 2021, nga KPK janë realizuar blerje shkresore nën 100.000 lekë, në total 17 procedura me vlerë 1,254,347 lekë. Dieta brenda vendit në total 10,000 lekë.

Për vitin 2022, nga KPK janë realizuar blerje shkresore nën 100.000 lekë, në total 11 procedura me vlerë 909,580 lekë dhe 1 procedurë me SDB, për blerje biletash në vlerë 34,196 lekë.

Dieta jashtë vendit Viti 2022:

Për vitin 2022 janë tërhequr nga banka në total 180,030 lekë, për mbulimin e dietave jashtë vendit nëpërmjet urdhër shpenzimeve Nr.198, datë 09.11.2022, Nr. 205, datë 14.11.2022 me të cilin është kryer konvertim i shumës nga lekë në euro dhe janë kryer pagesat e dietave në përputhje me VKM Nr.870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” dhe me UMF Nr.22, datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e VKM Nr.870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

Për vitin 2023, nga KPK janë realizuar blerje shkresore nën 100.000 lekë, në total 17 procedura me vlerë 1,217,263 lekë dhe 1 procedurë me SDB, për blerje biletash në vlerë 195,000 lekë. Dieta brenda vendit në total 29,810 lekë.

Dieta jashtë vendit Viti 2023:

Për vitin 2023 janë tërhequr nga banka në total 1,004,500 lekë, për mbulimin e dietave jashtë vendit nëpërmjet urdhër shpenzimit Nr.276, datë 03.11.2023, me të cilin është kryer konvertim i shumës nga lekë në USD dhe janë kryer pagesat e dietave në përputhje me VKM Nr.870, datë

14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” dhe me UMF Nr.22, datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e VKM Nr.870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

Për periudhën 30.09.2024, nga KPK janë realizuar blerje shkresore nën 100.000 lekë, në total 6 procedura me vlerë 399,655 lekë.

- Për periudhën nën auditim nga KPK janë shpenzuar 18,864,339 lekë për pagesën e shërbimit celular në përputhje me VKM Nr.864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publik” dhe VKM Nr. 673, datë 2.9.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë” i ndryshuar.

- Përgjatë periudhës Mars 2021 deri më 30.09.2024 janë shpenzuar 6,291,371 lekë, për qira ambientesh për stafin mbështetës të KPK, sipas kontratave respektive:

- Midis KPK dhe Igli Skënderi është lidhur kontrata me Nr.1636/6 Prot, datë 08.03.2021 me vlerë qiraje mujore 80,000 lekë/muaj, përfshirë tatimin mbi të ardhurat nga qiraja. Tatime mbi të ardhurat nga qiraja duke qenë detyrim i palës qiradhënëse do të mbahet nga vlera e qirasë dhe do të paguhet nga qiramarrësi në organet tatimore, kontrata e cila është rinovuar më datë 07.04.2022 me Nr. Repertori 1934 dhe Nr. Koleksioni 894.

- Midis KPK dhe Sonila Daja është lidhur kontrata me Nr.1636/7 Prot, datë 08.03.2021 me vlerë qiraje mujore 95,000 lekë/muaj, përfshirë tatimin mbi të ardhurat nga qiraja. Tatime mbi të ardhurat nga qiraja duke qenë detyrim i palës qiradhënëse do të mbahet nga vlera e qirasë dhe do të paguhet nga qiramarrësi në organet tatimore, kontrata e cila është rinovuar më datë 07.04.2022 me Nr. Repertori 1935 dhe Nr. Koleksioni 895.

Për sa më sipër nga grupi janë audituar transaksionet sipas Aneksit 1/1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Konstatim:

Nga auditimi i dietave brenda vendit u konstatua se pagesat e dietave janë kryer në shumicën e rasteve pas muajit gusht 2018 referuar VKM Nr.158, datë 25.04.2002 “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 404, datë 24.10.1991 “Për trajtimin e personaliteteve të larta shtetërore” në ndryshimet përkatëse, si dhe për caktimin e dietës ditore të ministrave, zëvendësministrave dhe personave të tjerë, të barazuar me ta”, i cili është mbështetur në Ligjin Nr.8379, datë 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar ligj i cili është shfuqizuar nga Ligji Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

-Për sa më sipër, përlllogaritja e dietave² nuk është realizuar bazuar VKM-së Nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar, ku dhe në kapitullin VIII është përcaktuar së Vendimi Nr.228, datë 13.4.2001 i Këshillit të Ministrave “Për dietat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre” të ndryshuar, **si edhe çdo vendim apo akt tjetër që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen të cilat kanë rezultuar me një diferencë për të gjithë periudhën nën auditim me efekt financiar në vlerën prej 262,200 lekë.**

Nga auditimi me zgjedhje i urdhër-shpenzimeve, u konstatua se:

Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit, si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Veprimet ekonomike që kryhen nga njësia, si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrime ruajtje, pasqyrohen në dokumentet përkatëse menjëherë pasi kryhet veprimi.

Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet mallra/ shërbime, procesverbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo

² Efekti financiar në lidhje me trajtimin e dietave brenda vendit në bazë të VKM Nr. 158, datë 25.04.2002 është jo material.

shërbimeve) dhe, në çdo rast është respektuar sistemi i dy nënshkrimeve, të nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë, si dhe kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit. Urdhër-shpenzimet janë të kontabilizuara në ditarin e bankës dhe ekstrakti i bankës rakordon me situacionet mujore të rakorduara me degën e thesarit. Faturat janë paguar në respektim të afateve, duke mos tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184 “Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik”, si dhe Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, afatet për autoritet publike, pika a), parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procedimit të pagesës në degën e thesarit”. KPK gjatë periudhës së auditimit nuk ka pasuar akses në SIFQ.

a. Ligjshmëria dhe saktësia e kryerjes së veprimeve nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë:

Veprimet e arkës në valutë në institucion dokumentohen nëpërmjet mandat-arkëtimeve dhe mandat-pagesave të cilat nënshkruhen nga financieri dhe marrësi i paradhënies. Regjistrimet e veprimeve të arkës janë kryer në llogari kontabël të arkës, nga Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse dhe në librin e arkës nga ana e punonjësit të caktuar me përgjegjësinë e lëvizjes së vlerave monetare. Dokumentet e arkës janë shqyrtuar, kontrolluar dhe nënshkruar nga personat e autorizuar: mandatar-arkëtimet nënshkruhen rregullisht nga personi përgjegjës për vlerat monetare dhe nga nëpunësi zbatues; mandat-pagesat nënshkruhen nga nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij, nga zyrtari që ka nënshkruar mandat-pagesën (marrësi) dhe nga personi përgjegjës për lëvizjen e vlerave monetare. Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të arkës në valutë rezultoi se, institucioni respekton përcaktimet në zbatim të parashikimeve të paragrafit Nr. 67 dhe 68 të UMF Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve njësitë e sektorit publik” i ndryshuar dhe sa më sipër është mbajtur libër arke, ku janë regjistruar rregullisht mandat arkëtimet e pagesat dhe janë bërë mbylljet e tij rregullisht çdo muaj.

Nga auditimi, rezultoi se:

- Regjistrimet kontabël në ditarin e arkës janë bërë në mënyrë të rregullt, të kuadruara dhe duke u bazuar në dokumentacionin justifikues përkatës.

Nëpërmjet arkës në valutë janë kryer kryesisht pagesa për shërbime udhëtimi e dieta jashtë vendit. Në të gjitha rastet e audituara, paradhënia ka rezultuar të jetë sistemuar nga Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, menjëherë pas paraqitjes së dokumenteve justifikuese, për shpenzimet e kryera, nga ana e nëpunësit udhëtues, e shoqëruar kjo sipas rastit me “Mandat pagesën” ose “Mandatin e arkëtimit”. Në përfundim të shërbimit, punonjësi dorëzon të firmosur pranë zyrës së financës së njësisë, Urdhër-Shërbimin duke i bashkëngjitur atij autorizimin e titullarit të institucionit qendror, ose të deleguarit të tij, dhe të gjithë dokumentet përkatëse që vërtetojnë shpenzimet e kryera për realizimin e shërbimit jashtë vendit.

Nga testimet e kryera nuk rezultoi të jetë akorduar paradhënie e dytë, pa shlyer paradhënien e parë. Transaksionet financiare, në formën e paradhënies, për udhëtime e dieta, rezultojnë të kryera në zbatim të VKM Nr. 870 datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, si dhe Udhëzimi Nr. 22, datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e vendimit Nr. 870, datë 14.12.2011 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

- Arka është inventarizuar periodikisht çdo muaj duke mos rezultuar me diferenca. Në fund të vitit arka është mbyllur me gjendje zero, përveç vitit 2019, pasi rezulton se me faturën për arkëtim Nr.51, datë 14.09.2020 korrigjim nga vitet e kaluara është kryer derdhje në bankën

RBAL në llogari të degës së thesarit Tiranë me vlerë 48,246 lekë (konvertuar me kursin ditor të bankës, derdhje nga dietat e kthyer për vitin 2019), dhe kjo gjendje është pasqyruar në pasqyrën financiare të vitit 2019 si gjendje.

Për vitin 2023, diferenca nga shpenzimet e dietave jashtë vendit, është kryer me memo kredi date 15.12.2023 dhe me proces verbal datë 21.12.2023 për kthim pjesor fond dietash në valutë i papërdorur në vlerën 188,351.9 lekë (konvertuar me kursin ditor të bankës, derdhje nga dietat e kthyer për vitin 2023)

U shqyrtua libri i arkës në valutë, ku u testuan transaksionet e kryera të regjistruara në librin e arkës, dhe konstatohet se për rastet e tërheqjes së valutës është lëshuar autorizimi për tërheqje valute, nënshkruar rregullisht nga Sekretari i Përgjithshëm i KPK-së. Akordimi i paradhënies për shërbim është mbështetur në urdhrin e lëshuar nga Nëpunësi Autorizues. Praktikrat për likuidimet e kryera për shërbimet jashtë vendit janë hartuar nga personat udhëtues së bashku me dokumentacionin vërtetues përkatës, veprime këto të bazuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 22, datë 10.07.2013, “Mbi zbatimin e Vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, pika 5 e tij. Nga ana e grupit të auditimit konstatohet se nga strukturat e shërbimit të financës së KPK-së janë kryer rakordimet dhe **kontrollat periodike të arkës në lekë dhe valutë kryesisht për shërbime jashtë vendi**. U testuan me zgjedhje kontrollat e kryera nga ana e specialistëve të Drejtorisë Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, mbi kontrollin fizik të gjendjes së arkës në valutë, ku nuk kanë rezultuar diferenca.

Sa më sipër, është vepruar në zbatim të parashikimeve të paragrafit Nr. 80, të UMF Nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

c. Saktësia dhe rregullat e veprimeve të kryera nëpërmjet magazinës:

Mbështetur në dokumentacionin e magazinës si fletë hyrjet dhe fletë daljet, kartelat limit, librin e magazinës dhe ditarin analitik të lëvizjes së vlerave materiale, u konstatua se lëvizja e mallrave, materialeve e inventarëve nëpërmes magazinës në përgjithësi janë shoqëruar me dokumente justifikuese sipas normave dhe procedurave standarde për ruajtjen, dokumentimin, qarkullimin dhe nxjerrjen jashtë qarkullimit të aktiveve në njësitë publike referuar nenit 6, pika 1, germa “dh”, të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar dhe UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Gjithashtu, daljet nga magazina janë kryer me urdhër dorëzimi, ku pajisjet e mallrat e inventarit u janë dhënë punonjësve me kartela personale.

Hyrja e mallrave në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletë-hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletë-hyrjet në përgjithësi, përjashtuar rasteve të trajtuar në pikën 4 të programit të auditimit, si dhe blerjeve shkresore nën 100 mijë lekë, lëshohen nga magazinieri, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu III, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, ndërsa fletë daljet ishin të shoqëruara me dokumente mbështetëse si urdhra dorëzimi, procesverbale etj. Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga administratori i vlerave materiale, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialiste e sektorit të financës.

ç) Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël.

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Nga auditimi u konstatua se KPK ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë

e sektorit publik”, i ndryshuar neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...” dhe neni 31, citohet “ ...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës...”.

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2017-30.09.2024.

Nga KPK është realizuar çdo vit procesi i inventarizimit, siç parashikohet në Paragrafi nr. 74, i UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar që sanksionin se:

“Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”

Regjistrimi i aktiveve është kryer konform Kreut III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre” të UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësite e sektorit publik”, i ndryshuar.

Me Urdhrin e përbashkët midis Ministrisë së Kulturës dhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit Nr. 109 datë 12.02.2018, Nr 1003 Prot, datë 12.02.2018 “Për kalimin kapital të sistemeve kompjuterike dhe pajisjeve të mobilimit të blera në kuadër të procedurave për komisionin e pavarur të Kualifikimit, nga Ministria e Kulturës tek Komisioni i Pavarur i Kualifikimit” është (kërkuar) kryer kalimi kapital i sistemeve kompjuterike, punimeve elektrike si dhe kolaudim, në vlerën 53,713,666 lekë dhe kalimi kapital i pajisjeve të mobilimit në vlerën prej 27,493,788 lekë.

Me memon Nr.3078 Prot, datë 04.04.2018 është kërkuar ngritja e komisionit për marrjen në dorëzim të pajisjeve nga Ministria e Kulturës.

Titullari i KPK me Urdhrin Nr. 43 datë 04.04.2018 “Për krijimin e komisionit për marrjen në dorëzim të mjeteve dhe pajisjeve”, ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim me anëtar; S.N-Kryetar, E.A anëtare, S.SH anëtare, E.D anëtare dhe A.I anëtar.

- Titullari i KPK me Urdhrin Nr. 159 datë 16.12.2019 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit periodik të aktiveve për vitin 2019”, ka ngritur grupin e inventarizimit me anëtarë A.P -Kryetar, E.T anëtare, D.K anëtare, A.D anëtare dhe G.H anëtar. Në zbatim të urdhrin të mësipërm, grupi i inventarizimit me Memon me Nr. 2247 Prot, datë 02.03.2020 ka hartuar relacion për përfundimin e procesit të inventarizimit për vitin 2019 të aseteve të KPK-së.

-Titullari i KPK me Urdhrin Nr. 14 Prot datë 06.01.2021 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit periodik të aktiveve për vitin 2020”, ka ngritur grupin e inventarizimit me anëtarë A.P -Kryetar, Y.SH anëtar, E.A anëtare, E.D anëtare dhe E.D anëtare. Në zbatim të urdhrin të mësipërm, grupi i inventarizimit me shkresën Nr. 14/1 Prot, datë 30.01.2021 ka hartuar raport për mbylljen e inventarizimit periodik të aktiveve 2020.

-Titullari i KPK me Urdhrin Nr. 27 datë 25.02.2022 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit periodik të aktiveve për vitin 2021”, ka ngritur grupin e inventarizimit me anëtarë AP -Kryetar, Y.SH anëtar, E.A anëtare, E.D anëtare dhe E.D anëtare. Në zbatim të urdhrin të mësipërm, grupi i inventarizimit me shkresën Nr. 840/1 Prot, datë 25.03.2022 ka hartuar relacionin për mbylljen e inventarizimit periodik të aktiveve 2020.

-Titullari i KPK me Urdhrin Nr. 102 datë 12.09.2023 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit periodik të aktiveve”, ka ngritur grupin e inventarizimit me anëtarë E.D -Kryetar, E.A anëtare, G.H anëtar, K.Q anëtar dhe Y.SH anëtar. Komisioni i Inventarizimit me shkresën Nr 3670/1 Prot, datë 31.12.2023 ka hartuar “Raport për mbylljen e inventarizimit

periodik të aktiveve për vitin 2023” në të cilin kanë cituar se u krye inventarizimi i aktiveve për çdo punonjës sipas kartelave personale dhe nuk u konstatuan humbje apo shpërdorim si për gjendjen e aktiveve që kanë në ngarkim personeli ashtu dhe për lëvizjen e tyre në rast largimi apo transferimi në një detyrë tjetër. Pas përfundimit të inventarit fizik të aktiveve, kartelat individuale të firmosura nga personeli u hodhën në regjistrin kontabël të aktiveve për vitin 2023. Komisionet e inventarizimit në përfundim të inventarizimit periodik të aktiveve nuk kanë konstatuar diferenca të inventarizimit fizik me ato të regjistruara në kontabilitet, si dhe gjatë viteve objekt auditimi nuk kanë rezultuar aktive të dëmtuara dhe të dala jashtë përdorimi.

2.4 Auditimi i prokurimeve të fondeve publike

Në zbatim të këtij drejtimi të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

1. Regjistrat e parashikimeve/ realizimeve për vitet 2017 - 2024;
2. Urdhra/ Vendime të Titullarit të AK;
3. Dosjet e procedurave të prokurimit;
4. Urdhër shpenzimet përkatëse;
5. Dokumentacioni shoqërues i marrjes në dorëzim;
6. Sistemi elektronik i prokurimeve (SPE).

Mbi procedurat e prokurimit publik në KPK

Pas shqyrtimit të Regjistrave të realizimit të procedurave të prokurimit për vitet periudhë auditimi dhe krahasimeve rast pas rasti me Regjistrat e parashikimit dhe ditarët e bankës, grupi i auditimit ka konstatuar se jo të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara nga KPK ose për llogari të KPK janë pasqyruar në këto regjistra, trajtuar rast pas rasti në vijim për secilin vit. Pas rishikimit me qëllim korrigjimin e të dhënave, Drejtoria Ekonomike në KPK ka pasqyruar vlerat e kontraktuara (pa TVSH) sa i përket procedurave të prokurimit, të ndara sipas llojit, për vitet periudhë auditimi, nga ku pas konfirmimit nga KPK në mënyrë të përmblëdhur paraqiten në vijim:

	Kërkesë për propozim	Blerje me vlerë të vogël	Blerje shkresore (nën 100,000 lekë)	Blerje bileta	TOTALI (lekë pa TVSH)
2017		1,279,700	138,425		1,418,125
2018	2,700,000	3,347,454.85	1,587,132		7,634,586.85
2019	10,650,100	2,510,700	1,103,316	270,275	14,534,391
2020	10,004,100	3,915,222	1,270,739		15,190,061
2021	12,542,536	5,880,228	1,254,347		19,677,111
2022	10,821,600	3,975,336	909,580	34,196	15,740,712
2023	10,655,400	3,912,016	1,217,263.32	195,000	15,979,679.32
2024		1,764,148.50	399,655		2,163,803.50
TOTALI	57,373,736	26,584,805.35	7,880,457.32	499,471	92,338,469.67

Burimi: Drejtoria Ekonomike në KPK

Sa më sipër, vlera totale e kontraktuar nga KPK si Autoritet Kontraktor përgjatë viteve 2017-2024 është 92,338,469.67 lekë pa TVSH. Të gjitha procedurat mbi nivelin e ulët monetar, në vlerën totale prej 57,373,736 lekë pa TVSH, janë kryer nga organi qendror blerës (Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit). Sa i përket sigurimit të jetës dhe/ ose shëndetit për Komisionerët, personat e lidhur me ta, këshilltarët, si dhe punonjësit e KPK, përgjatë viteve periudhë auditimi, vlera totale e kontraktuar është 46,464,536 lekë pa TVSH.

1. Sa i përket **procedurave me vlerë të vogël**, të kryera nga KPK, u krye përzgjedhja bazuar në materialitetin e procedurave, si më poshtë:

Për vitin 2017: nga 1,279,700 lekë të kontraktuar në total nga procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, janë audituar 3 procedura në vlerë totale prej 1,279,700 lekë pa TVSH;

Për vitin 2018, nga 3,347,454.85 lekë pa TVSH të kontraktuar në total, janë audituar 10 procedura në vlerë totale prej 2,594,124 lekë pa TVSH;

Për vitin 2019, nga 2,510,700 lekë pa TVSH të kontraktuar në total, janë audituar 6 procedura në vlerë totale prej 2,237,100 lekë pa TVSH;

Për vitin 2020, nga 3,915,222 lekë pa TVSH të kontraktuar në total, janë audituar 6 procedura në vlerë totale prej 3,305,500 lekë pa TVSH;

Për vitin 2021, nga 5,880,228 lekë pa TVSH të kontraktuar në total, janë audituar 6 procedura në vlerë totale prej 3,638,332 lekë pa TVSH;

Për vitin 2022, nga 3,975,336 lekë pa TVSH të kontraktuar në total, janë audituar 4 procedura në vlerë totale prej 2,498,836 lekë pa TVSH;

Për vitin 2023, nga 3,912,016 lekë pa TVSH të kontraktuar në total, janë audituar 7 procedura në vlerë totale prej 3,551,600 lekë pa TVSH;

Për 9 mujorin e parë të vitit 2024, nga 1,764,148.5 lekë pa TVSH të kontraktuar në total, janë audituar 4 procedura në vlerë totale prej 1,123,946 lekë pa TVSH.

2. Sa i përket **procedurave mbi kufirin e ulët monetar** me autoritet kontraktor KPK, të kryera nga organet qendrore blerëse, u përzgjedhën 100% e kontratave me objekt furnizim me pajisje/ mallra, si dhe u përzgjedhën nëpërmjet kampionimit rastësor marrja në dorëzim dhe zbatimi i kontratave me objekt sigurimin e shëndetit, si më poshtë:

1. Blerje makine për Komisionerin, viti 2018, vlerë totale e kontraktuar 2,700,000 lekë pa TVSH;

2. Blerje pajisje elektronike, viti 2019, vlerë totale e kontraktuar 1,181,500 lekë pa TVSH;

3. Blerje tonera, viti 2019, vlerë totale e kontraktuar 5,076,000 lekë pa TVSH;

4. Blerje PC për nevoja të KPK, viti 2020, vlerë totale e kontraktuar 1,152,000 lekë pa TVSH;

5. Blerje laptop, viti 2021, vlerë totale e kontraktuar 1,499,100 lekë pa TVSH;

6. Loti 2 “Sigurim shëndeti për personat e lidhur me komisionerët, punonjësit e KPK”, viti 2022, vlerë totale e kontraktuar 6,401,436;

7. Loti 3 “Sigurim shëndeti për familjarët e komisionerëve, këshilltarët dhe stafin administrativ të KPK”, viti 2023, vlerë totale e kontraktuar 6,336,000.

Mbi sigurimin e jetës dhe shëndetit

Neni 25 i Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” përcakton se anëtarët e institucioneve të rivlerësimit, personat e lidhur me ta dhe personeli i institucioneve të rivlerësimit gëzojnë të drejtën për mbrojtje të veçantë nga shteti për jetën, shëndetin dhe pasurinë e tyre. Në zbatim e në mbështetje të kësaj dispozite, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka siguruar nëpërmjet procedurave të prokurimit publik (*procedura të kryera nga organi qendror blerës*) shërbimin e sigurimit të jetës dhe/ ose shëndetit për Komisionerët, personat e lidhur me ta, këshilltarët, si dhe punonjësit e KPK, në vlerë totale të kontraktuar **46,464,536** lekë, për të gjithë periudhën objekt auditimi, sipas **Aneksit 2/1** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Praktikat e procedurave të prokurimit për të gjitha vitet periudhë auditimi janë të painventarizuara dhe të paarkivuara, në kundërshtim me nenin 21 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Për vitin 2017

Titullari i AK është znj. GT, me detyrë Kryetar i KPK.

Për vitin 2017, Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël i ngritur me Urdhrin Nr.22, datë 05.12.2017 ka patur në përbërje, E.D-Kryetare, E.D-Anëtare, E.M-Anëtare.

Për vitin 2017, Komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur me Urdhrin Nr. 24, datë 05.12.2017 ka patur në përbërje A.N-Kryetar, E.L-Anëtare, A.I-Anëtare.

Në regjistrin e realizimeve të prokurimit publik për vitin 2017, janë pasqyruar gjithsej 6 procedura prokurimi, 3 procedura prokurimi me vlerë të vogël dhe 3 procedura blerje shkresore nën 100 mijë lekë, me vlerë totale 1,418,125 lekë pa TVSH.

Pas konfirmimit nga KPK, procedurat e prokurimit ku KPK është autoritet kontraktor rezultojnë, si më poshtë:

Lloji i procedurës	Numri i procedurave	Vlera totale e kontraktuar (lekë pa TVSH)
Blerje me vlerë të vogël	3	1,279,700
Blerje shkresore (nën 100.000 leke)	3	138,425
TOTALI	6	1,418,125

Burimi: Drejtoria Ekonomike në KPK, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Dosjet e procedurave të prokurimit nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara, në mospërputhje me nenin 21 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

I. Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “**Blerje Laptop**”, Nr. REF-37290-12-11-2017, me fond limit 800,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën Nr. 886 Prot, datë 11.12.2017 është bërë kërkesë për pajisjen e institucionit me 12 (dymbëdhjetë) laptop për plotësimin e nevojave të institucionit të sapo krijuar.

KBV, ka hartuar proces verbalin më datë 07.12.2017 “Mbi testimin e tregut për marrjen e çmimeve të kompjuterëve (laptop) për përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pajisje elektronike (laptop)”, i cili ka kryer përlllogaritjen e fondit limit duke testuar tregun me 3 operatorë ekonomikë në përputhje me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 59, si dhe duke bashkëlidhur listën me artikuj. Titullari i AK ka miratuar Urdhrin e Prokurimit Nr. 24, datë 11.12.2017, sipas kërkesës së komisionit.

SP i KPK RC ka miratuar ftesën për ofertë Nr. 886/2 Prot, datë 11.12.2017, ku janë pasqyruar specifikimet teknike të mallrave dhe kërkesat e veçanta për kualifikim.

KBV me proces verbalin Nr.1, datë 13.12.2017 ka kryer hapjen dhe vlerësimin e ofertave dhe ka shpallur fitues OE “D.XH” i renditur i pari me ofertë ekonomike 74,000 lekë pa TVSH/njësi. Ky OE është tërhequr nga prokurimi dhe KBV e ka dokumentuar me proces verbalin Nr.2, datë 13.12.2017 këtë fakt duke vijuar me OE “F” i renditur në vend të dytë me ofertë ekonomike 673,000 lekë pa TVSH, i cili është shpallur fitues.

Komisioni i marrjes në dorëzim, me proces verbalin e mbajtur me datë 14.12.2017 ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave.

OE “F” është likuiduar nëpërmjet **Urdhër Shpenzimit Nr. 22, datë 19.12.2017** në vlerën prej **807,600 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes Nr. 1289, datë 14.12.2017. Artikujt janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjes Nr.3 , datë 14.12.2017.

2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “**Blerje letër fotokopje A4 dhe A3**”, Nr. REF-37639-12-12-2017, me fond limit 200,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën Nr. 927 Prot, datë 12.12.2017 është bërë kërkesë për blerje letër A3 dhe A4 për plotësimin e nevojave të institucionit të sapo krijuar.

KBV, ka hartuar proces verbalin me shkresën Nr. 927/3 Prot, datë 12.12.2017 “Mbi testimin e tregut për marrjen e çmimeve të letrës A3 dhe A4 për përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje letër fotokopje”, i cili ka kryer përlllogaritjen e fondit limit duke testuar tregun me 3 operatorë ekonomikë në përputhje me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 59.

Titullari i AK ka miratuar Urdhrin e prokurimit Nr. 26, datë 12.12.2017, për procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës.

SP i KPK RC ka miratuar ftesën për ofertë Nr. 927/2 Prot, datë 12.12.2017, ku pasqyrohen specifikimet teknike të mallrave, grafiku i lëvrimit dhe termat e referencës dhe kërkesat e veçanta për kualifikim.

KBV me proces verbalin Nr.2, datë 15.12.2017 ka shpallur fitues OE “OP” sh.p.k, i renditur i pari me ofertë ekonomike 149,700 lekë pa TVSH.

Komisioni i marrjes në dorëzim me proces verbalin datë 15.12.2017 ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave.

O.E “OP” është likuiduar nëpërmjet **Urdhër Shpenzimit Nr. 23, datë 19.12.2017**, në vlerën prej **179,640 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes Nr. 2605, datë 15.12.2017. Mallrave janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjes Nr. 4, datë 15.12.2017.

3. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje kancelarie”, Nr. REF-39080-12-20-2017, me fond limit 600,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën Nr. 2038/2 Prot, datë 20.12.2017 është bërë kërkesë për blerje kancelarie në total prej 72 artikujsh, për plotësimin e nevojave të institucionit të sapo krijuar.

KBV ka hartuar proces verbalin me shkresën Nr. 2038/1 Prot, datë 20.12.2017 “Mbi testimin e tregut për marrjen e çmimeve të kancelarisë për përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Kancelarie”, i cili ka kryer përllogaritjen e fondit limit duke testuar tregun me 3 operatorë ekonomikë në përputhje me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 59 si dhe duke bashkëlidhur listën me artikuj. Titullari i AK me Urdhrin e Prokurimit Nr. 32, datë 20.12.2017 ka miratuar procedurën për realizimin e blerjes së vogël.

SP i KPK RC ka miratuar ftesën për ofertë Nr. 2038/4 Prot, datë 20.12.2017, ku pasqyrohen specifikimet teknike të mallrave dhe kërkesat e veçanta për kualifikim.

KBV ka mbajtur proces verbalin Nr.1, datë 22.12.2017 “Për hapjen dhe vlerësimin e ofertave të procedurës së prokurimit”, ku është shpallur fitues OE “MB” i renditur i pari me ofertë ekonomike 398,800 lekë pa TVSH, i cili ka bërë njoftim në sistemin SPE tërheqjen nga prokurimi.

KBV ka mbajtur proces verbalin Nr.2, datë 22.12.2017 ku është shpallur fitues OE “PS” i renditur i dyti me ofertë ekonomike 400,500 lekë pa TVSH.

Komisioni i marrjes në dorëzim në proces verbalin Nr.3, datë 27.12.2017 ka konstatuar se mostrat e mallit të kërkuar sipas ftesës për ofertë kishin mangësi dhe nuk përmbushnin specifikimet teknike.

KBV me proces verbalin Nr.4, datë 28.12.2017 ka vijuar me OE e radhës i renditur i treti OE “IO” me ofertë ekonomike 457,000 lekë pa TVSH.

Komisioni i marrjes në dorëzim me proces verbalin Nr.2038/8 Prot, datë 28.12.2017 ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave.

OE “IO” është likuiduar nëpërmjet **Urdhër Shpenzimit Nr. 28, datë 29.12.2017**, në vlerën prej **548,400 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes Nr. 228933292, datë 28.12.2017. Artikujt janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjeve Nr. 7/1, 7/2, 7/3, 7/4, datë 28.12.2017.

Për vitin 2018

Titullari i AK është znj. G.T, me detyrë Kryetar i KPK-së.

Për vitin 2018, Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël i ngritur me Urdhrin Nr.2, datë 05.01.2018 ka patur në përbërje: A.D -Kryetare, E.D -Anëtare, E.M-Anëtare.

Për vitin 2018, nga AK janë ngritur dy Komisione të marrjes në dorëzim përkatësisht: Me Urdhrin Nr. 11, datë 25.01.2018 komisioni i marrjes në dorëzim të prokurimit me objekt “Blerje boje për printer” në përbërje: S.SH-Kryetar, D.K-Anëtare, A.I –Anëtare.

Me Urdhrin Nr. 12, datë 25.01.2018 komisioni i marrjes në dorëzim të prokurimit me objekt “Blerje kancelarie” në përbërje: S.SH-Kryetar, I.S-Anëtare, A.I –Anëtare.

-Nga auditimi i regjistrin të parashikimit është konstatuar se për vitin 2018 nga KPK është ndryshuar 11 herë (për shkak se ky institucion ka qenë i sapo krijuar), rast pas rasti sipas shkresave si vijon:

Me shkresën Nr. 435 Prot, datë 16.01.2018 Titullari i AK ka dërguar regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2018, i cili ka pasur ndryshime ose shtesa rast pas rasti me shkresat Nr. 1622 Prot, datë 07.02.2018; Nr. 1984 Prot, datë 20.02.2018; Nr. 2304 Prot, datë 05.03.2018; Nr. 2323 Prot, datë 06.03.2018; Nr. 2454 Prot, datë 12.03.2018; Nr. 2784 Prot, datë 27.03.2018; Nr. 3076 Prot, datë 04.04.2018; Nr. 3556 Prot, datë 18.04.2018; Nr. 4010 Prot, datë 08.05.2018; Nr. 4366 Prot, datë 28.05.2018; Nr. 5950 Prot, datë 07.09.2018; Nr. 6291 Prot, datë 21.09.2018; Nr. 6710 Prot, datë 09.10.2018; Nr. 1622 Prot, datë 07.02.2018;

Në regjistrin e realizimeve të prokurimit publik për vitin 2018, janë pasqyruar gjithsej 36 procedura prokurimi, 12 prej të cilave procedura prokurimi me vlerë të vogël, me vlerë totale 3,347,454.85 lekë pa TVSH dhe një procedurë prokurimi kërkesë për propozim realizuar nga ABP, si dhe 23 procedura shkresore nën 100 mijë lekë.

Pas konfirmimit nga KPK, procedurat e prokurimit ku KPK është autoritet kontraktor rezultojnë, si më poshtë:

Lloji i procedurës	Numri i procedurave	Vlera totale e kontraktuar (lekë pa TVSH)
Kërkesë për propozim	1	2,700,000
Blerje me vlerë të vogël	12	3,347,454.85
Blerje shkresore (nën 100.000 leke)	23	1,587,132
TOTALI	36	7,634,586.85

Burimi: Drejtoria Ekonomike në KPK, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Dosjet e procedurave të prokurimit nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara, në mospërputhje me nenin 21 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Nga kryqëzimi i të dhënave me ditarin e bankës, grupi i auditimit ka konstatuar se jo të gjitha procedurat e prokurimit të kryera nga KPK dhe/ose për llogari të KPK nga organet qendrore blerëse janë pasqyruar në regjistrin e realizimit.

I. Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “**Blerje kancelarie të ndryshme**”, Nr. REF-68172-05-10-2018, me fond limit 400,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën Nr. 4018/1 Prot, datë 09.05.2018 është bërë kërkesë për blerje kancelarie në total 42 artikuj, për plotësimin e nevojave të institucionit.

KBV, me shkresën Nr. 4018 Prot., datë 09.05.2018 ka hartuar raportin “Mbi specifikimet teknike për objektin e prokurimit “Blerje kancelari”, si dhe ka kryer përllogaritjen e fondit limit duke testuar tregun me 3 operatorë ekonomikë në përputhje me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 59 si dhe duke bashkëlidhur listën me artikuj dhe specifikimet teknike bashkëlidhur lista e mallrave që do të prokurohen.

Titullari i AK GT me Urdhrin e prokurimit Nr. 53, datë 09.05.2018 ka miratuar procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës.

SP i KPK RC ka miratuar ftesën për ofertë Nr. 4018/3 Prot, datë 09.05.2018, ku pasqyrohen specifikimet teknike të mallrave dhe kërkesat e përgjithshme.

KPV, me proces verbalin Nr.4018/6, datë 15.05.2018 ka shpallur fitues OE “NA” sh.p.k, i renditur i pari me ofertë ekonomike 304,330.85 lekë pa TVSH.

Komisioni i marrjes në dorëzim, me proces verbalin Nr.4018/5, datë 15.05.2018 ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave.

OE “NA” është likuiduar nëpërmjet **Urdhër Shpenzimit Nr. 89, datë 24.05.2018**, në vlerën prej **365,197 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes Nr. 884, datë 15.15.2018. Mallrave janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjeve Nr. 18/1, Nr. 18/2, Nr. 18/3 datë 15.15.2018.

2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje kancelari (letër A4)”, Nr. REF-74860-06-14-2018, me fond limit 200,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën Nr. 4699 Prot, datë 13.06.2018 është bërë kërkesë për blerje kancelari letër A4, për plotësimin e nevojave të institucionit.

KPV me shkresën Nr. 4699/1 Prot, datë 13.06.2018 ka hartuar raportin “Mbi specifikimet teknike për objektin e prokurimit “Blerje kancelari letër A4”, si dhe ka kryer përlllogaritjen e fondit limit duke testuar tregun me 3 operatorë ekonomikë në përputhje me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 59 si dhe duke bashkëlidhur listën me artikuj dhe specifikimet teknike bashkëlidhur lista e mallrave që do të prokurohen.

Titullari i AK GT me Urdhrin e prokurimit Nr. 67, datë 13.06.2018 ka miratuar procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës.

SP i KPK RC ka miratuar ftesën për ofertë Nr. 4699/3 Prot, datë 13.05.2018, ku pasqyrohen specifikimet teknike të mallrave dhe kërkesat të veçanta për kualifikim.

KBV ka shpallur fitues OE “4TA” sh.p.k, i renditur i pari me ofertë ekonomike 304,330.85 lekë pa TVSH, por pasi janë paraqitur mostrat, OE është skualifikuar për faktin se nuk përmbushte specifikimet teknike sipas ftesës për ofertë.

KBV ka mbajtur proces verbalin Nr.4699/7, datë 20.06.2018, ku është shpallur fitues OE “PC” i renditur i dyti me ofertë ekonomike 167,898 lekë pa TVSH.

Komisioni i marrjes në dorëzim, me proces verbalin Nr.4699/6 datë 20.06.2018 ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave.

O.E “PC” është likuiduar nëpërmjet **Urdhër Shpenzimit Nr. 110, datë 04.07.2018**, në vlerën prej **201,478 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes Nr. 1236, datë 20.06.2018. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen Nr. 23, datë 20.06.2018.

3. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje kancelari të ndryshme”, Nr. REF-42070-01-25-2018, me fond limit 200,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën Nr. 898 Prot, datë 24.01.2018 është bërë kërkesë për blerje kancelari, për plotësimin e nevojave të institucionit.

Titullari i AK GT Urdhrin e prokurimit Nr. 8, datë 24.01.2018 ka miratuar procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës.

SP i KPK RC ka miratuar ftesën për ofertë Nr. 898/2 Prot, datë 24.01.2018, ku pasqyrohen specifikimet teknike të mallrave.

KBV ka shpallur fitues OE “IO” sh.p.k, i renditur i pari me ofertë ekonomike 132,500 lekë pa TVSH.

Komisioni i marrjes në dorëzim, me proces verbalin Nr.898/5 datë 30.01.2018 ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave.

OE “IO” sh.p.k është likuiduar nëpërmjet **Urdhër Shpenzimit Nr. 13, datë 07.02.2018**, në vlerën prej **159,000 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes Nr. 228937361, datë 30.01.2018. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen Nr. 2/1, Nr. 2/2, datë 30.01.2018.

4. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “**Blerje rafte metalike për arkivën**”, Nr. REF-56158-03-15-2018, me fond limit 333,333 lekë pa TVSH.

Me shkresën Nr. 2369 Prot, datë 07.03.2018 është bërë kërkesë për blerje rafte metalike, sasi 9 copa, për plotësimin e nevojave të punës së zyrës protokoll arkivë .

KPV me shkresën Nr. 2369/1 Prot, datë 07.03.2018 ka hartuar raportin “Mbi specifikimet teknike për objektin e prokurimit “Blerje rafte metalike për arkivën”, si dhe ka kryer përlllogaritjen e fondit limit duke testuar tregun me 3 operatorë ekonomikë në përputhje me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 59 si dhe duke bashkëlidhur listën me artikuj dhe specifikimet teknike bashkëlidhur lista e mallrave që do të prokurohen.

Titullari i AK me Urdhrin e Prokurimit Nr. 26, datë 07.03.2018 ka miratuar procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës.

SP i KPK RC ka miratuar ftesën për ofertë Nr. 2369/3, Prot, datë 12.03.2018, ku pasqyrohen specifikimet teknike të mallrave dhe kërkesat e veçanta për kualifikim.

KBV me proces verbalin Nr.2369/9 datë 19.03.2018 ka shpallur fitues OE “GP” i renditur i pari me ofertë ekonomike 288,000 lekë pa TVSH.

OE “GP” është likuiduar nëpërmjet **Urdhër Shpenzimit Nr. 41, datë 27.03.2018**, në vlerën prej **345,600 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes Nr. 36, datë 19.03.2018. Artikujt u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet fletë-hyrjes Nr. 9 datë 20.03.2018.

Konstatim;

Bashkëlidhur procedurës së prokurimit blerje e vogël mungon procesverbali i marrjes në dorëzim të mallrave, veprime në kundërshtim me UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” paragrafi 37.

5. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “**Blerje bojë për fotokopje**”, Nr. REF-77487-07-03-2018, me fond limit 150,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën Nr. 5018/1 Prot, datë 02.07.2018 është bërë kërkesë për blerje tonerash, , për plotësimin e nevojave urgjente të institucionit, sasi 18 copë. .

KBV, me shkresën Nr. 5018 Prot, datë 02.07.2018 ka hartuar raportin “Mbi specifikimet teknike për objektin e prokurimit “Blerje bojë për printer”, si dhe ka kryer përlllogaritjen e fondit limit duke testuar tregun me 3 operatorë ekonomikë në përputhje me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 59 si dhe duke bashkëlidhur listën me artikuj dhe specifikimet teknike bashkëlidhur lista e mallrave që do të prokurohen.

Titullari i AK GT Urdhrin e prokurimit Nr. 75, datë 02.07.2018 ka miratuar procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës.

SP i KPK RC ka miratuar ftesën për ofertë Nr. 5018/3 Prot, datë 02.07.2018, ku pasqyrohen specifikimet teknike të mallrave.

KBV me proces verbalin Nr.5018/6, datë 05.07.2018 ka shpallur fitues OE “K” sh.p.k, i renditur i pari me ofertë ekonomike 127,800 lekë pa TVSH.

OE “K” sh.p.k është likuiduar nëpërmjet **Urdhër Shpenzimit Nr. 125, datë 10.07.2018**, në vlerën prej **153,360 lekë** bazuar në faturën tatimore të shitjes Nr. 939, datë 06.07.2018. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen Nr. 26, datë 06.07.2018.

Konstatim;

Bashkëlidhur procedurës së prokurimit blerje e vogël mungon procesverbali i marrjes në dorëzim të mallrave, veprime në kundërshtim me UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” paragrafi 37.

6. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “**Blerje televizorësh**”, Nr. REF-57164-03-20-2018, me fond limit 500,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën Nr. 2498 Prot, datë 15.03.2018 është bërë kërkesë për blerje televizorësh, për plotësimin e nevojave të institucionit, sasi 11 copë.

Titullari i AK GT me Urdhrin e prokurimit Nr. 29, datë 15.03.2018 ka miratuar procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës.

SP i KPK RC ka miratuar ftesën për ofertë Nr. 2498/2 Prot, datë 20.03.2018, ku pasqyrohen specifikimet teknike të mallrave dhe kërkesat e veçanta për kualifikim.

KBV me proces verbalin Nr.5018/5, datë 27.03.2018 është sqaruar se OE i renditur i pari me ofertë ekonomike 375,000 lekë pa TVSH dhe OE i renditur në vend të dytë me ofertë ekonomike 425,000 lekë pa TVSH, pasi janë shpallur fitues nuk janë paraqitur pranë AK për dorëzimin e dokumentacionit.

KBV ka shpallur fitues OE i renditur në vend të tretë “PS” me ofertë ekonomike 435,000 lekë pa TVSH.

OE “PS” sh.p.k është likuiduar nëpërmjet **Urdhër Shpenzimit Nr. 51, datë 04.04.2018**, në vlerën prej **522,000 lekë** bazuar në faturën tatimore të shitjes Nr. P 412, datë 27.03.2018. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen Nr. 11, datë 27.03.2018.

Konstatim;

Në dosje mungon raporti i hartuar nga KBV “Mbi specifikimet teknike për objektin e prokurimit “Blerje televizorësh”, si dhe përllogaritja e fondit limit sipas përcaktimeve të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 59.

7. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “**Blerje bojë për printer**”, Nr. REF-55680-03-13-2018, me fond limit 300,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën Nr. 2453 Prot, datë 12.03.2018 është bërë kërkesë për blerje tonerash, për plotësimin e nevojave të institucionit, sasi 25 copë.

KBV, me shkresën Nr. 2453/1 Prot, datë 12.03.2018 ka hartuar raportin “Mbi specifikimet teknike për objektin e prokurimit “Blerje bojë për printer”, si dhe ka kryer përllogaritjen e fondit limit duke testuar tregun me 3 operatorë ekonomikë në përputhje me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 59 si dhe duke bashkëlidhur listën me artikuj dhe specifikimet teknike bashkëlidhur lista e mallrave që do të prokurohen.

Titullari i AK GT me Urdhrin e prokurimit Nr. 28, datë 12.03.2018 ka miratuar procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës.

SP i KPK RC ka miratuar ftesën për ofertë Nr. 2453/2 Prot, datë 12.03.2018, ku pasqyrohen specifikimet teknike të mallrave.

KBV me proces verbalin 2453/6, datë 19.03.2018 ka shpallur fitues OE “JG” sh.p.k, i renditur i pari me ofertë ekonomike 249,000 lekë pa TVSH, i cili është skualifikuar pasi OE nuk është paraqitur. KBV ka kaluar tek operatori i dytë OE “IO” sh.p.k me ofertë ekonomike 262,700 lekë pa TVSH, i cili është shpallur fitues.

Komisioni i marrjes në dorëzim, me proces verbalin Nr.2453/5 datë 19.03.2018 ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave.

OE “IO” sh.pk. është likuiduar nëpërmjet **Urdhër Shpenzimit Nr. 40, datë 26.03.2018**, në vlerën prej **315,240 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes Nr. 228941107, datë 19.03.2018. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen Nr. 8, datë 19.03.2018.

8. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “**Blerje bojë për printer**”, Nr. REF-42077-01-25-2018, me fond limit 180,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën Nr. 897 Prot, datë 24.01.2018 është bërë kërkesë për blerje tonerash, për plotësimin e nevojave emergjente të institucionit, sasi 12 copë.

Titullari i AK GT me Urdhrin e prokurimit Nr. 7, datë 24.01.2018 ka miratuar procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës.

SP i KPK RC ka miratuar ftesën për ofertë Nr. 897/2 Prot, datë 24.01.2018, ku pasqyrohen specifikimet teknike të mallrave, kërkesat e veçanta për kualifikim.

KBV me proces verbalin 897/4, datë 02.02.2018 ne hapjen dhe vlerësimin e ofertave ka konstatuar se OE “EO” sh.p.k dhe OE “A” sh.p.k kanë ofertuar me ofertë te njëjtë ekonomike 110,000 lekë pa TVSH, KBV bazuar në Udhëzimin Nr.3 datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” pika 15 e tij, kanë njoftuar OE nëpërmjet sistemit SPE për tu paraqitur për hedhjen e shortit më datë 31.01.2018 ora 10. OE “EO” sh.p.k, është tërhequr nga procedura e prokurimit, ndërsa OE “A” sh.p.k nuk është paraqitur për procedurën e njoftuar. Më pas, KBV ka kaluar tek OE “R” sh.p.k i renditur i treti me ofertë ekonomike 128,000 lekë pa TVSH, i cili nuk është paraqitur pranë AK sipas afateve ligjore. KBV ka kaluar tek “PS” sh.p.k i renditur i katërti me ofertë ekonomike 140,900 lekë pa TVSH, i cili është paraqitur pranë AK me dokumentacionin e kërkuar sipas ftesës për ofertë dhe me mallin (mostrën) e kërkuar, i cili është shpallur fitues. Komisioni i marrjes në dorëzim, me proces verbalin Nr.915/1 datë 02.02.2018 ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave.

OE “PS” sh.pk. është likuiduar nëpërmjet **Urdhër Shpenzimit Nr. 23, datë 02.03.2018**, në vlerën prej **169,080 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes Nr. P 388, datë 02.02.2018. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen Nr. 3, datë 02.02.2018.

9. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje boje për printer”, Nr. REF-85090-09-10-2018, me fond limit 800,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën Nr. 5949 Prot, datë 07.09.2018 është bërë kërkesë për blerje tonerash, për plotësimin e nevojave të institucionit, sasi 74 copë.

KBV, me shkresën Nr. 5949/1 Prot, datë 07.09.2018 ka hartuar raportin “Mbi specifikimet teknike për objektin e prokurimit “Blerje boje për printer”, si dhe ka kryer përlllogaritjen e fondit limit duke testuar tregun me 3 operatorë ekonomike në përputhje me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 59 si dhe duke bashkëlidhur listën me artikuj dhe specifikimet teknike bashkëlidhur lista e mallrave që do të prokurohen.

Titullari i AK GT me Urdhrin e prokurimit Nr. 85, datë 07.09.2018 ka miratuar procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës.

Titullari i AK GT ka miratuar ftesën për ofertë Nr. 5949/2 Prot, datë 10.09.2018, ku pasqyrohen specifikimet teknike të mallrave, si dhe kërkesat e veçanta për kualifikim.

KBV me proces verbalin 5949/6, datë 19.09.2018 është sqaruar se OE ekonomik renditur në vend të parë me ofertë ekonomike 285,000 lekë pa TVSH, OE ekonomik renditur në vend të dytë me ofertë ekonomike 590,000 lekë pa TVSH, OE ekonomik renditur në vend të tretë me ofertë ekonomike 666,000 lekë pa TVSH, OE ekonomik renditur në vend të katërt me ofertë ekonomike 735,000 lekë pa TVSH, OE ekonomik renditur në vend të pestë me ofertë ekonomike 760,000 lekë pa TVSH, nga të cilët katër OE janë tërhequr nga procedura për arsyen teknike dhe OE i renditur në vend të dytë nuk ka njoftuar për arsyen e pjesëmarrjes.

KBV ka shpallur fitues OE i renditur në vend të gjashta me ofertë ekonomike 766,026 lekë pa TVSH, i cili ka plotësuar kërkesat e përcaktuara në ftesën për ofertë.

Komisioni i marrjes në dorëzim, me proces verbalin Nr.5949/5 datë 19.09.2018 ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave.

OE “C” sh.pk. është likuiduar nëpërmjet **Urdhër Shpenzimit Nr. 169, datë 26.09.2018**, në vlerën prej **920,431 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes Nr. 4645, datë 19.09.2018. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë nëpërmjet fletë-hyrjes Nr. 33, datë 19.09.2018.

10. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje orendi mobilim zyrash”, me nr. REF-95192-11-21-2018, me fond limit 458,333 lekë pa TVSH.

Me shkresën Nr. 7888 Prot, datë 21.11.2018 është bërë kërkesë për blerje pajisje zyre, për plotësimin e nevojave të institucionit, pasi institucionit sipas organikës i janë shtuar 14 pozicione pune.

KBV, me shkresën Nr. 7888/1 Prot, datë 21.11.2018 ka hartuar raportin “Mbi specifikimet teknike për objektin e prokurimit “Blerje orendi mobilim zyrash”, si dhe ka kryer përlllogaritjen e fondit limit duke testuar tregun me 3 operatorë ekonomikë në përputhje me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 59 si dhe duke bashkëlidhur listën me artikuj dhe specifikimet teknike bashkëlidhur lista e mallrave që do të prokurohen.

Titullari i AK GT me Urdhrin e Prokurimit Nr. 112, datë 21.11.2018 ka miratuar procedurën e prokurimit sipas kërkesës.

SP i KPK GM ka miratuar ftesën për ofertë Nr. 7888/2 Prot, datë 21.11.2018, ku pasqyrohen specifikimet teknike të mallrave, kërkesat e veçanta për kualifikim.

KBV me proces verbalin 7888/5 dhe 7888/6, datë 05.12.2018 është sqaruar se OE ekonomik renditur në vend të parë me ofertë ekonomike 199,800 lekë pa TVSH, OE ekonomik renditur në vend të dytë me ofertë ekonomike 243,750 lekë pa TVSH janë tërhequr nga procedura, OE ekonomik renditur në vend të tretë me ofertë ekonomike 244,600 lekë pa TVSH nuk është paraqitur pranë institucionit dhe nuk ka njoftuar për tërheqjen.

KBV ka shpallur fitues OE i renditur në vend të katërt me ofertë ekonomike 273,300 lekë pa TVSH, i cili ka plotësuar kërkesat e përcaktuara në ftesën për ofertë.

OE “TTC” sh.p.k është likuiduar nëpërmjet **Urdhër Shpenzimit Nr. 233, datë 27.12.2018**, në vlerën prej 327,960 lekë, bazuar në faturën tatimore të shitjes Nr. 90, datë 07.12.2018. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me Fletë-hyrjen Nr. 44, datë 24.12.2018.

Zbatimi i kontratave:

1. Zbatimi i kontratës me objekt Loti III “Blerje auto veturë me kalueshmëri të lartë SUV për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, për vitin 2018;

Me shkresën Nr.3927 Prot, datë 03.05.2018, Titullari i AK i ka dërguar kërkesë për blerje automjeti për nevoja të institucionit ABP.

Si dhe nëpërmjet shkresës Nr.3927/3 Prot, datë 18.06.2018, Titullari i AK ka dërguar të dhëna mbi specifikimet teknike ABP.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, ka rezultuar se:

Nëpërmjet shkresës administruar në KPK me Nr. 7318 Prot, datë 30.10.2018, Drejtori i Përgjithshëm i ABP autorizon për lidhjen e kontratës të llojit “procedurë e hapur” me afat 2 vjet, me OE të shpallur fitues “Hyundai Auto Albania” sh.p.k, duke dërguar dokumentacionin e nevojshëm të procedurës së prokurimit dhe deklaratat e OE të shpallur fitues..

Ndërmjet AK dhe OE “HAA” sh.p.k është lidhur kontrata me Nr. 7318/1 Prot, datë 07.11.2018 me vlerë 3,240,000 lekë me TVSH.

Me shkresën Nr. 7318/2 Prot, datë 07.11.2018, KPK ka dërguar njoftimin e kontratës së nënshkruar ABP.

Me Urdhrin Nr.109, date 19.11.2018 “Për marrjen në dorëzim të prokurimit me objekt “Blerje auto veturë me kalueshmëri të lartë SUV për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, për vitin 2018, SP i KPK ka caktuar E H., A.N, F. M.

Grupi i mësipërm me proces verbalin Nr. 7318/4 Prot, datë 19.11.2018 ka dokumentuar marrjen në dorëzim të automjetit duke administruar dhe dokumentacionin shoqërues certifikate origjine etj.

Konstatim;

Ky Komisioni nuk ka në përbërje specialist të fushës, në mospërputhje me pikën 43 të UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

-Akt marrje në dorëzim datë 19.11.2018, midis O.E dhe komisionit të marrjes në dorëzim.

OE “HAA” është likuiduar nëpërmjet **Urdhër Shpenzimit Nr. 207, datë 22.11.2018**, në vlerën prej **3,240,000 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes Nr. 833, datë 15.11.2018. Automjeti është bërë hyrje në magazinë me Fletë-hyrjen Nr. 38, datë 19.11.2018.

Për vitin 2019

- **Titullari i AK** është znj. G.T, me detyrë Kryetar i KPK.

- **Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël** ka në përbërje, si më poshtë:

Sipas Urdhrit nr. 1, datë 04.01.2019: E.D, kryetar (specialist pritje me popullin), E.D (specialist finance/ buxhet), A.D (specialist sekretarie gjyqësore);

Sipas Urdhrit nr. 1/1, datë 14.02.2019: A.D. zëvendësohet me O. G. (specialiste e sekretarisë gjyqësore).

- **Komisioni i marrjes në dorëzim** ka në përbërje, si më poshtë:

Sipas Urdhrit nr. 2, datë 04.01.2019: S.SH, E.M, A.I;

Sipas Urdhrit nr. 2/1, datë 13.03.2019: A.I zëvendësohet me Y.SH;

Sipas Urdhrit nr. 2/2, datë 10.07.2019: S.SH zëvendësohet me E. H.

Në Regjistrin e realizimeve të prokurimit publik për vitin 2019, janë pasqyruar gjithsej 30 procedura prokurimi, 8 prej të cilave procedura prokurimi me vlerë të vogël, me vlerë totale 10,484,413 lekë pa TVSH. Pas konfirmimit nga KPK, procedurat e prokurimit ku KPK është autoritet kontraktor rezultojnë, si më poshtë:

Lloji i procedurës	Numri i procedurave	Vlera totale e kontraktuar (lekë pa TVSH)
Kërkesë për propozim	3	10,650,100
Blerje me vlerë të vogël	8	2,510,700
Blerje shkresore	20	1,103,316
Blerje bileta	2	270,275
TOTALI	31	14,534,391

Burimi: Drejtoria Ekonomike në KPK

Sa i përket procedurave “Kërkesë për propozim”, për vitin 2019 rezultojnë, si më poshtë:

Nr.	Objekti	Fondi limit (pa TVSH)	Vlera e kontratës (pa TVSH)	Data e lidhjes së kontratës	Organi qendror blerës
1	Sigurim jete dhe shëndeti për 12 Komisionerët	4,600,000	4,392,000	13/06/2019	ABP
2	Blerje pajisje elektronike/ TIK	1,500,000	1,181,500	03/01/2019	AKSHI
3	Blerje tonera	5,111,520	5,076,000	30/09/2019	ABP
TOTALI		11,213,520	10,649,500		

Burimi: Drejtoria Ekonomike në KPK

I. Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Shpenzime për mobilim zyre”, nr. REF-07416-02-12-2019, me fond limit 700,000 lekë pa TVSH.

Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, ka hartuar relacionin nr. 1161 prot., datë 11.02.2019, mbi specifikimet teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për objektin e prokurimit “Mobilim zyresh”, ku citohet se fondit limit është 700,000 lekë pa TVSH, pa dokumentuar se si ky

komision ka kryer përllogaritjen e fondit limit, duke përcaktuar tabelën e mobilimit të zyrave, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Kolltuk tek	Copë	5
2	Kolltuk dysh	Copë	8
3	Raft me 4 kapakë melamine me përmasa 90*40*220h	Copë	12
4	Kapak melamin për raft me përmasa 45*115cm	Copë	4

Titullari i AK ka miratuar Urdhrin e prokurimit nr. 42, datë 11.02.2019, për procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës.

Sekretari i Përgjithshëm i KP2K ka miratuar ftesën për ofertë nr. 1161/2 prot., datë 11.02.2019, ku pasqyrohen specifikimet teknike të mallrave dhe citohet ndër të tjera se “OE duhet të paraqesë certifikatat ISO “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” dhe “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”. Në këtë dokument, sa i përket kolltukëve të zyrës, specifikohet se “Modeli, seti, ngjyra, etj., do të përcaktohet nga AK në momentin e lidhjes së kontratës”.

Komisioni i Procedurave me vlerë të vogël ka shpallur fitues OE “E” ShPK, me ofertë ekonomike 448,500 lekë pa TVSH. OE ka paraqitur dokumentacionin fizik, administruar në KPK me nr. 1161/7 prot., datë 15.02.2019.

Komisioni i Procedurave me vlerë të vogël ka hartuar procesverbalin nr. 1161/8 prot., datë 15.02.2019, ku pasqyrohet ecuria e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, ku citohet se “në datën 27.02.2019, OE solli të gjithë mallin e kërkuar sipas specifikimeve teknike të kërkuar në ftesën për ofertë”. Nëpërmjet procesverbalit nr. 1161/9 prot., datë 27.02.2019, Komisioni i marrjes në dorëzim ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave. Ky PV nuk është nënshkruar nga A.I.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 63, datë 03.04.2019**, në vlerën prej **538,200 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes nr. 25, datë 27.02.2019. Mallrave u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 9, datë 28.02.2019.

2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje kancelari”, nr. REF-12830-03-07-2019, me fond limit 800,000 lekë pa TVSH.

Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël ka hartuar kërkesën nr. 2027 prot., datë 07.03.2019, për blerje kancelari për nevoja të institucionit, duke përcaktuar se “fondi limit është 800,000 lekë pa TVSH”, si dhe duke bashkëlidhur listën me artikuj. Në shkresën nr. 2027/1 prot., datë 07.03.2019, ky komision ka hartuar raportin mbi specifikimet teknike, ku shprehet se fondi limit është përllogaritur bazuar në çmimet përkatëse të publikuara nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara në faqen zyrtare, pa pasqyruar çmimet përkatëse për secilin artikull, nga ku të rezultojë totali prej 800,000 lekë pa TVSH.

Titullari i AK ka miratuar Urdhrit e prokurimit nr. 65, datë 07.03.2019, sipas kërkesës së komisionit.

KPV ka shpallur fitues OE “IO” me ofertë ekonomike 471,600 lekë pa TVSH. OE ka përcjellë dokumentacionin fizik, administruar në KPK me nr. 2027/5 prot., datë 12.03.2019. KPV ka hartuar procesverbalin nr. 2027/6 prot., datë 12.03.2019, ku janë listuar ofertuesit sipas vlerës së ofruar, ku citohet se “OE i renditur i pari nuk u paraqit deri në orën e përcaktuar dhe as nuk njoftoi nëpërmjet sistemit për largimin e tij”. Më pas komisioni kaloi tek OE i renditur i dyti “IO” ShPK... pasi OE u paraqit dhe u shqyrtua gjithë dokumentacioni dhe nuk u konstatua ndonjë mangësi, KVO shpall fitues OE “IO”.

Nëpërmjet procesverbalit nr. 2027/7 prot., datë 13.03.2019, Komisioni i marrjes në dorëzim ka dokumentuar marrjen në dorëzim të artikujve. OE “IO” është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 67, datë 03.04.2019**, në vlerën prej **565,920 lekë**, bazuar në Faturën tatimore të shitjes nr. 228069847, datë 13.03.2019. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjeve nr. 11/1, 11/2, 11/3, 11/4, datë 13.03.2019.

3. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Mirëmbajtje e pajisjeve elektronike”, nr. REF-16793-04-04-2019, me fond limit 200,000 lekë pa TVSH.

Nëpërmjet shkresës nr. 2581 prot., datë 03.04.2019, E.A (specialist IT) ka informuar mbi nevojën për shërbim servisi, si vijon: 8 njësi, 8 UPS, 2 monitor.

Nëpërmjet shkresës nr. 2581/1 prot., datë 03.04.2019, Komisioni i Blerjeve të Vogla ka kryer përlllogaritjen e fondit limit bazuar sikurse cituar në 3 oferta, në vlerën prej 200,000 lekë pa TVSH, duke përcaktuar gjithashtu specifikimet teknike të shërbimit.

Titullari i AK ka miratuar Urdhrin e prokurimit nr. 85, datë 03.04.2019, duke kërkuar realizimin e procedurës me objekt “Mirëmbajtje e pajisjeve elektronike”, duke përcaktuar zërat, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi/ përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Motherboard për HP 280 G2 MT	Copë	2
2	HP PSU P/N 848049-003	Copë	5
3	Formatim	Copë	4
4	Risetim password-i	Copë	4
5	Servis UPS	Copë	4
6	Motherboard për laptop HP 250G6, P/N: LA-E811P	Copë	12

Sekretari i Përgjithshëm i KPK ka miratuar ftesën për ofertë nr. 2581/3 prot., datë 03.04.2019, ku janë përcaktuar edhe kriteret e veçanta të kualifikimit. Në pikën 1 të këtij dokumenti përcaktohet se OE duhet të jetë i certifikuar me certifikatat ISO, si ISO 9001:2015, ISO IEC 27001:2013, ISO IEC 20000-1:2011, ISO IEC 22301:2012. Komisioni nuk ka dokumentuar argumentimin teknik të këtij kriteri, në mospërputhje me nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

Pas mosparaqitjes së 2 OE, Komisioni ka shpallur fitues OE “A” sh.p.k, me ofertë ekonomike 194,000 lekë pa TVSH, i cili ka paraqitur dokumentacionin fizik administruar në KPK me nr. 2581/9 prot., datë 10.04.2019.

OE ka paraqitur certifikatën ISO 22301:2012 nga kompania R dhe certifikatën ISO 20000-1:2011 nga kompania “C”, që nuk rezultojnë në listën e organeve të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (<https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>).

Komisioni i Blerjeve të Vogla ka hartuar procesverbalin nr. 2581/10 prot., datë 10.04.2019, ku ka pasqyruar ecurinë e procedurës së prokurimit.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 90, datë 08.05.2019**, në vlerën prej **232,800 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes nr. 765, datë 17.04.2019. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton që artikujt/ shërbimi të jetë marrë në dorëzim nga Komisioni i marrjes në dorëzim, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

4. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje grirëse dokumentash”, nr. REF-28323-06-25-2019, me fond limit 320,000 lekë pa TVSH.

Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël ka hartuar relacionin nr. 4486 prot., datë 25.06.2019, mbi specifikimet teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për objektin e prokurimit “Blerje grirëse profesionale dokumentesh”, ku bazuar në 3 oferta të cituara është përlllogaritur fondi limit në vlerën 320,000 lekë pa TVSH. Nëpërmjet shkresës nr. 4486/1 prot., datë 25.06.2019, Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël kërkon miratimin e titullarit të AK për fillimin e procedurës. Titullari i AK ka miratuar Urdhrin e prokurimit nr. 120, datë 25.06.2019, për procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës. Sekretari i Përgjithshëm i KPK ka miratuar ftesën për ofertë nr. 4486/3 prot., datë 25.06.2019.

OE “IO” ShPK i shpallur fitues, me ofertë ekonomike 317,000 lekë pa TVSH, ka paraqitur dokumentacionin fizik, administruar në KPK me nr. 4486/5 prot., datë 10.07.2019.

Nëpërmjet procesverbalit nr. 4486/6 prot., datë 11.07.2019, Komisioni i marrjes në dorëzim ka dokumentuar marrjen në dorëzim të 14 grirëse dokumentesh, ku citohet se “*pasi testoi mallin e kërkuar...rezultoi që malli ishte i saktë dhe në sasinë e kërkuar*”.

Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël ka hartuar procesverbalin nr. 4486/7 prot., datë 11.07.2019, ku pasqyrohet ecuria e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, ku citohet se OE “IO” ShPK ishte renditur i dhjeti, por është shpallur fitues pas tërheqjes ose mosparaqitjes së OE me ofertë ekonomike më të ulët.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 152, datë 01.08.2019**, në vlerën prej **380,400 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes nr. 279813405, datë 11.07.2019. Pajisjeve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 25/1, datë 11.07.2019.

5. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Mobilim zyrash (karrige zyre profesionale)”, me nr. REF-35011-09-04-2019, me fond limit 252,000 lekë pa TVSH.

Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël ka hartuar relacionin nr. 5506 prot., datë 04.09.2019, mbi specifikimet teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për objektin e prokurimit “*Mobilim zyrash (karrige zyre profesionale, të përshtatshme për qëndrim me orë të tejzgjatura pune për 12 anëtarët e Komisionit*”, bazuar në 3 oferta të cituara ka përllogaritur fondin limit në vlerën prej 252,000 lekë pa TVSH. Titullari i AK ka miratuar Urdhrin e prokurimit nr. 133, datë 04.09.2019, për procedurën e prokurimit sipas kërkesës. Sekretari i Përgjithshëm i KPK ka miratuar ftesën për ofertë nr. 5506/3 prot., datë 04.09.2019, ku janë përcaktuar edhe specifikimet teknike të poltronëve/ karrigeve të kërkuara.

Komisioni i Blerjeve të Vogla, pas mosparaqitjes së disa OE, si dhe skualifikimit të 4 OE me arsyen sikurse cituar se “*pas testimit të mostrës... OE nuk plotëson kushtet e përcaktuara*”, ka shpallur fitues OE “P”, me ofertë ekonomike 228,000 lekë pa TVSH, i cili ka paraqitur dokumentacionin fizik, administruar në KPK me nr. 5506/5 prot., datë 16.09.2019. Pavarësisht se Komisioni citon se ka vlerësuar mostrat e paraqitura nga 4 OE të skualifikuar, nuk rezulton të ketë dokumentuar rast pas rasti administrimit dhe procesin e vlerësimit të tyre, duke mos garantuar gjurmën e auditimit për 4 OE të skualifikuar, në mospërputhje me nenin 12, pika 2, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar. Në formularin sipas shtojcës 6, OE deklaroi se përmbush të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara në DST dhe citon se “*e vërteton këtë me certifikata e dokumente (nëse kërkohen nga AK)*”. Komisioni i Blerjeve të Vogla ka hartuar procesverbalin nr. 5506/6 prot., datë 19.09.2019, ku ka pasqyruar ecurinë e procedurës së prokurimit, deri në marrjen në dorëzim të mallrave. Komisioni i marrjes në dorëzim ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave nëpërmjet procesverbalit nr. 5506/7 prot., datë 19.09.2019.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 180, datë 27.09.2019**, në vlerën prej **273,600 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes nr. 049, datë 19.09.2019. Mallrave u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 32, datë 19.09.2019.

6. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Riparim (mirëmbajtje) pajisjesh elektronike”, nr. REF-44178-11-20-2019, me fond limit 600,000 lekë pa TVSH.

Nëpërmjet shkresës nr. 7261 prot., datë 19.11.2019, E.A (specialist IT) ka informuar mbi nevojën për riparim të pajisjeve elektronike (kompjuterëve, skanerëve, UPS, etj.), si më poshtë:

Nr.	Pajisja	Shërbimi	Njësia	Sasia
1	Fotokopje XEROX Versalink B7030	Profilaksi e plotë, zëvendësim i setit të gominave, transfer roller, feed roller assembly, separation roller	Copë	11
2	Skaner Epson DS-1630	Profilaksi e plotë, zëvendësim i setit të gominave, transfer roller, feed roller assembly, separation roller	Copë	25
3	Skaner Epson DS-1630	Zëvendësim motherboard	Copë	6
4	Skaner Epson DS-1630	Zëvendësim i llambës	Copë	8
5	UPS	Ndërrim i baterive, riparim board-i	Copë	16
6	Shërbim për kompjuter	Formatim, pastrim fizik/ ndërrim i pastës termike	Copë	15

7	Motherboard HP (P/N 849959-602)		Copë	4
---	---------------------------------	--	------	---

Nëpërmjet shkresës nr. 7261/2 prot., datë 19.11.2019, Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka hartuar relacionin për përlogaritjen e fondit limit, sikurse cituar bazuar në 3 oferta, në vlerën prej 600,000 lekë pa TVSH. Titullari i AK ka miratuar urdhrin e prokurimit nr. 155, datë 19.11.2019, sipas përcaktimit në kërkesë.

Sekretari i Përgjithshëm i KPK ka miratuar ftesën për ofertë nr. 7261/3 prot., datë 20.11.2019, ku përcaktohen specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit. Komisioni i blerjeve të vogla nuk rezulton të ketë argumentuar kriteret e vendosura, në mospërputhje me nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

Në këtë dokument janë përcaktuar kriteret si:

“1.OE duhet të disponojë minimalisht 1 person të certifikuar “CompTIA” A+ ose ekuivalente; 2. OE duhet të disponojë certifikata ISO 9001:2008; IEC 20000-1:2011; 27001:2013; 3. OE duhet të disponojë minimalisht 1 person të certifikuar “ITIL” ose ekuivalent; 4. OE duhet të disponojë minimalisht 1 person të certifikuar “Auditing Information Systems Operation, Maintenance and Support” ose ekuivalent”. Grupi i auditimit vlerëson se këto kriteret, përveçse të paargumentuar teknikisht, nuk janë në proporcion me objektin e prokurimit, duke kufizuar konkurrencën dhe pjesëmarrjen e O.E në procedurë.

Pas tërheqjes së 4 OE dhe skualifikimit të OE “PS” me ofertë ekonomike 490,000 lekë pa TVSH, Komisioni ka shpallur fitues OE “A” ShPK, me ofertë ekonomike 578,000 lekë pa TVSH. OE i shpallur fitues “A” ShPK ka paraqitur dokumentacionin fizik administruar në KPK me nr. 7261/5 prot., datë 03.12.2019. OE ka paraqitur certifikatën ISO 9001:2015, ISO/IEC 27001:2013, ISO/IEC 20000-1:2011 nga kompania R dhe certifikatën ISO 20000-1:2011 nga kompania C, që nuk rezultojnë në listën e organeve të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (<https://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/>).

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka hartuar procesverbalin nr. 7261/6 prot., datë 03.12.2019, ku ka pasqyruar ecurinë e procedurës së prokurimit. Në këtë PV, ndër të tjera, komisioni shprehet se: *“Më pas Komisioni kaloi tek OE i renditur i pesti “PS”... gjatë verifikimit të dokumentacionit, rezultoi i pasaktë në pikën e fundit të kërkesave (OE të disponojë minimalisht 1 person të certifikuar “Auditing Information Systems Operation, Maintenance and Support” ose ekuivalent), e cila mungonte”*. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion, nuk rezulton të jetë administruar (duke mos marrë as numër rendor protokolli) dokumentacioni fizik i paraqitur nga ky OE, duke mos garantuar gjurmën e auditimit për ofertat e skualifikuara, sipas përcaktimit në nenin 12, pika 2, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar.

Nëpërmjet procesverbalit nr. 7261/7 prot., datë 04.12.2019, Komisioni ka vendosur ndërprerjen e menjëhershme të procedurës së prokurimit dhe njoftimin e O.E të shpallur fitues, pas njoftimit nga MFE *“Mbi prioritetin e pagesave në kushtet e gjendjes së shpallur të fatkeqësisë natyrore”*. Nga verifikimi edhe në ditarin e bankës, si dhe nga konfirmimi nga KPK, mbështetur në sa më sipër, pavarësisht se rezulton në Regjistrin e realizimit, procedura e prokurimit është ndërprerë, ky shërbim nuk është marrë dhe rrjedhimisht nuk është likuiduar.

II. Zbatimi i kontratave për procedurat e kryera nga organi qendror blerës

1. Zbatimi i kontratës me objekt “Blerje tonerash për printera”, për vitin 2019

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, ka rezultuar se:

Nëpërmjet shkresës administruar në KPK me nr. 5786 prot., datë 16.09.2019, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara autorizon për lidhjen e kontratës të llojit *“marrëveshje kuadër”* me afat 2 vjet, me OE të shpallur fitues *“IO”* ShPK, duke dërguar dokumentacionin e nevojshëm të procedurës së prokurimit dhe deklaratat e OE të shpallur fitues, për mallrat, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Lloji i pajisjes	Sasia (copë)	Çmimi (lekë pa TVSH/ njësi)	Vlera (lekë pa TVSH)
1	Lexmark CS 417 dn, black	Min. 6,000 fletë	110	20,900	2,299,000
2	Lexmark CS 417 dn, yellow	Min. 3,500 fletë	40	19,600	784,000
3	Lexmark CS 417 dn, margenta	Min. 3,500 fletë	40	19,600	784,000
4	Lexmark CS 417 dn, cyan	Min. 3,500 fletë	40	19,600	784,000
5	Xerox Versa Link B7030 black	Min. 3,500 fletë	50	8,500	425,000
Totali (lekë pa TVSH)					5,076,000
Vlera TVSH					1,015,200
Totali (lekë me TVSH)					6,091,200

Ndërmjet AK dhe OE “IO” sh.p.k është lidhur kontrata e furnizimit nr. 5786/1 prot., datë 30.09.2019, me vlerë të përgjithshme 5,076,000 lekë pa TVSH dhe 6,091,200 lekë me TVSH. Nëpërmjet Urdhrit nr. 2/2, datë 15.07.2019, Sekretari i Përgjithshëm i KPK ka krijuar komisionin e marrjes në dorëzim, të përbërë nga E. H. (specialist i sekretarisë gjyqësore), E.M. (specialist përkthimi) dhe Y.SH. (magaziner). Komisioni nuk ka në përbërje specialist të fushës, në mospërputhje me pikën 43 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Komisioni ka hartuar procesverbalin nr. 5787/3 prot., datë 08.10.2019, ku ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave sipas sasive të përcaktuara. Pavarësisht se në dokumentin “Shtojca 10 – Specifikimet teknike” përcaktohet se (i) ambalazhimi luan një rol të rëndësishëm në reduktimin e rreziqeve të sigurisë së produktit, duke specifikuar se mbi ambalazh duhet të vendoset etiketa me të dhënat, ndër të tjera, pulla e sigurisë, (ii) tonerat për pajisjen Lexmark duhet të jenë origjinale, (iii) marka prodhuese të jetë në ambalazhin dhe në trupin e tonerave, numrat serialë të tonerave të korrespondojnë në të gjitha pjesët e trupit, në pako, në mbështjellës, në vetë tonerin, (iv) për tonerat “Xerox” boja të jetë me pullë sigurie, afati i skadencës të jetë jo më pak se 2 vjet nga data e dorëzimit, si dhe (v) në mënyrë eksplicite shprehet se “tonerat do të jenë bojëra origjinale të prodhuesve të pajisjes për të cilin kërkohet, me pullë sigurie, të pahapura dhe jo të rimbushura”, komisioni nuk shprehet mbi ambalazhimin e mallrave, si dhe nuk ka administruar dokumentacionin shoqërues të mallrave të furnizuara, si certifikata origjine, certifikatë cilësie, në mospërputhje me pikën 42 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

OE është likuiduar nëpërmjet Urdhër-shpenzimit nr. 198, datë 18.10.2019, në vlerën prej 6,091,200 lekë, bazuar në faturën tatimore të shitjes nr. 321857482, datë 08.10.2019. Mallrave u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 36, datë 08.10.2019.

2. Zbatimi i kontratës me objekt “Shpenzime për blerje pajisje elektronike”, për vitin 2019

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, ka rezultuar se:

Nëpërmjet shkresës administruar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit nr. 1956 prot., datë 05.03.2019, Drejtori i Përgjithshëm i AKSHI ka dërguar për zbatim kontratën nr. 1121 prot., datë 01.03.2019, të lidhur ndërmjet AKSHI dhe OE “CCS”, për procedurën e prokurimit me objekt “Furnizim me pajisje elektronike – TIK”, në vlerë totale 1,181,500 lekë pa TVSH dhe 1,417,800 lekë me TVSH, për pajisjet, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Sasia	Çmimi (lekë pa TVSH/ njësi)	Vlera (lekë pa TVSH)
1	Komputera Desktop 1 – HP 290 G2 PCI PC + HP ProDisplay P223a 21.5-inch Monitor	10	58,500	585,000
2	LapTop Advanced – HP ZBook 15v G5 Mobile WS	4	129,500	518,000
3	UPS 600 VA – Power Tree UPS 650 VA	10	4,000	40,000
4	Skaner Tipi 1 – Canon CanoScan LiDE 300	5	7,700	38,500
Totali (lekë pa TVSH)				1,181,500
Vlera TVSH				236,300
Totali (lekë me TVSH)				1,417,800

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 68, datë 05.04.2019**, në vlerën prej **1,417,800 lekë**, bazuar në Faturën tatimore të shitjes nr. 74055149, datë 12.03.2019. Pajisjeve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 10, datë 12.03.2019.

Procesverbali i datës 12.03.2019 bashkëlidhur USH është nënshkruar nga E.A. për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, dhe nga 2 persona të tjerë, përfaqësues përkatësisht për AKSHI-n dhe për OE, dhe jo nga Komisioni i marrjes në dorëzim, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011.

Për vitin 2020

- **Titullari i AK**, si më poshtë:

Nga data 01.01.2020 – G.T, me detyrë Kryetar i KPK;

Nga data 20.07.2020 – P.Q, me detyrë Kryetar i KPK.

- **Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël** ka patur në përbërje, si më poshtë:

Sipas Urdhrit nr. 2, datë 06.01.2020: A.P, E.D, D.K.

- **Komisioni i marrjes në dorëzim** ka patur në përbërje, si më poshtë:

Sipas Urdhrit nr. 1, datë 06.01.2020: F. M., G.H, Y.SH;

Sipas Urdhrit nr. 6729 prot., datë 13.10.2020: Fjorela Mandro zëvendësohet me E.D.

Në Regjistrin e realizimeve të prokurimit publik për vitin 2020, janë pasqyruar gjithsej 25 procedura prokurimi, 8 prej të cilave procedura prokurimi me vlerë të vogël, me vlerë totale 4,987,461 lekë pa TVSH. Pas konfirmimit nga KPK, procedurat e prokurimit ku KPK është autoritet kontraktor rezultojnë, si më poshtë:

Lloji i procedurës	Numri i procedurave	Vlera totale e kontraktuar (lekë pa TVSH)
Kërkesë për propozim	2	10,004,100
Blerje me vlerë të vogël	9	3,915,222
Blerje shkresore	19	1,270,739
TOTALI	30	15,190,061

Burimi: Drejtoria Ekonomike në KPK

Sa i përket procedurave “Kërkesë për propozim”, për vitin 2020 rezultojnë, si më poshtë:

Nr.	Objekti	Fondi limit (pa TVSH)	Vlera e kontratës (pa TVSH)	Data e lidhjes së kontratës	Organi qendror blerës
1	Blerje PC Desktop për nevoja të KPK	2,000,000	1,152,000	24/12/2020	AKSHI
2	Sigurimi i jetës dhe shëndetit	10,000,000	8,852,100	17/07/2021	ABP
TOTALI		12,000,000	10,004,100		

Burimi: Drejtoria Ekonomike në KPK

I. Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje kancelari për vitin 2020”, nr. REF-48234-01-27-2020, me fond limit 800,000 lekë pa TVSH.

Nëpërmjet shkresës nr. 1055 prot., datë 27.01.2020, KBV, i përbërë nga A.P, E.T, D.K, ka hartuar raportin mbi specifikimet teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kancelari për vitin 2020”, ku citohet se fondi limit është përlllogaritur në vlerën prej 800,000 lekë pa TVSH bazuar në çmimet përkatëse të procedurës së realizuar një vit më parë me të njëjtin objekt, duke përcaktuar specifikimet teknike për dosjet e kartonit dhe letrën A4 të kërkuar. Titullari i AK ka miratuar Urdhrin e prokurimit nr. 12, datë 27.01.2020 për artikujt e kërkuar.

Pas hapjes së ofertave, si dhe tërheqjes së dy OE me ofertën ekonomike më të ulët, KBV ka shpallur fitues OE “IO”, me ofertë ekonomike 661,000 lekë pa TVSH. OE ka paraqitur dokumentacionin fizik, administruar në KPK me nr. 1055/5 prot., datë 30.01.2020.

Komisioni i marrjes në dorëzim, nëpërmjet PV nr. 1055/7 prot., datë 31.01.2020, ka dokumentuar marrjen në dorëzim të artikujve, ku sikurse citohet “*nuk u konstatua asnjë mangësi*”.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 30, datë 14.02.2020**, në vlerën prej **793,200 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes nr. 321867431, datë 31.01.2020. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 1, datë 31.01.2020.

2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “*Shpenzime për mirëmbajtjen (riparim) e pajisjeve elektronike*”, nr. REF-55464-04-03-2020, me fond limit 800,000 lekë pa TVSH.

Nëpërmjet shkresës nr. 2542 prot., datë 02.04.2020, specialisti IT E.A ka kërkuar kryerjen e shpenzimeve për mirëmbajtje (riparim) të pajisjeve elektronike, për pajisjet, si më poshtë:

Nr.	Pajisja	Shërbimi	Njësia	Sasia
1.	Fotokopje XEROX Versalink B7030	Profilaksi e plotë, zëvendësim i setit të gomave, transfer roller, feed roller assembly, separation roller	Copë	11
2.	Skaner EPSON DS-1630	Profilaksi e plotë, zëvendësim i setit të gomave, transfer roller, feed roller assembly, separation roller	Copë	25
3.	Skaner EPSON DS-1630	Zëvendësim i motherboard	Copë	8
4.	Skaner EPSON DS-1630	Zëvendësim i llampës	Copë	8
5.	Shërbimi për kompjuter	Formatim, pastrim fizik, ndërrimi i pastës termike	Copë	60
6.	Motherboard HP (P/N 849959-602)		Copë	9

Komisioni i Blerjeve të Vogla ka hartuar relacionin nr. 2542/1 prot., datë 02.04.2020, mbi specifikimet teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit, ku është përcaktuar fondi limit prej 800,000 lekë pa TVSH. Titullari i AK ka miratuar Urdhrin e prokurimit nr. 43, datë 02.04.2020. KBV ka shpallur fitues OE “EH” me ofertë ekonomike 584,000 lekë pa TVSH, i cili ka paraqitur dokumentacionin fizik administruar në KPK me nr. 2542/5 prot., datë 07.04.2020. Ndërmjet OE dhe AK është lidhur kontrata e shërbimit nr. 2542/8 prot., datë 07.04.2020 me afat përgjatë gjithë vitit 2020. Në PV e mbajtur me shkrim dore nr. 2542/9 prot., datë 08.04.2020, nënshkruar nga specialisti IT E.A dhe përfaqësuesi i subjektit EH, është dokumentuar dorëzimi për riparim i 22 skanerëve. Nëpërmjet PV nr. 2542/10 prot., datë 17.04.2020, Komisioni i marrjes në dorëzim ka dokumentuar marrjen në dorëzim të një pjese të shërbimeve të parashikuara.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 70, datë 22.04.2020**, në vlerën prej **491,280 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes nr. 351, datë 17.04.2020.

3. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “*Blerje maska dhe doreza në kuadër të masave mbrojtëse për shëndetin Anti - Covid, për anëtarët e Komisionit dhe stafin e tij, për vitin 2020*”, nr. REF-57893-05-12-2020, me fond limit 795,000 lekë pa TVSH.

Nëpërmjet shkresës nr. 3383 prot., datë 08.05.2020, KBV ka kërkuar blerjen e maskave dhe dorezave, si më poshtë:

- Doreza një përdorimshe lateks/ nitrile: 12,000 copë (120 kuti, me paketim 100 copë/ kutia);
- Maska kirurgjikale, një përdorimshe: 1,500 copë (30 kuti, me paketim 50 copë/ kutia);
- Maska tip KN95 shumëpërdorimshe: 1,700 copë (paketim individual ose me kuti).

Bazuar në këtë kërkesë, Titullari i AK ka miratuar Urdhrin e prokurimit nr. 51, datë 08.05.2020. KBV ka hartuar relacionin nr. 3383/2 prot., datë 08.05.2020, mbi specifikimet teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit, ku sikurse cituar “*pasi analizoi çmimet e tregut*”, ka përcaktuar fondin limit prej 795,000 lekë pa TVSH, por pa dokumentuar se ka ndjekur një nga alternativat e përcaktuara në nenin 59, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

Në këtë relacion, KBV ka përcaktuar specifikimet teknike të artikujve doreza dhe maska, ku nuk është përcaktuar (i) afati i skadencës të paktën 6 muaj nga koha e furnizimit dhe (ii) që artikujt të jenë të ambalazhuar në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes,

në mospërputhje me Udhëzimin e përbashkët të APP dhe MShMS nr. 294, datë 06.05.2020 “Për përcaktimin e listës së mallrave dhe shërbimeve për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia Covid-19”, në të cilin janë përcaktuar specifikimet teknike që duhet të kenë artikujt (përfshirë doreza e maska) që do të prokurohen në kuadër të Covid-19, me qëllim që të jenë efektive.

Pas hapjes së ofertave, KBV ka shpallur fitues OE “AM”, me ofertën ekonomike më të ulët, në vlerën prej 456,000 lekë pa TVSH. OE ka paraqitur dokumentacionin fizik, administruar në KPK me nr. 3383/5 prot., datë 14.05.2020.

Komisioni i marrjes në dorëzim ka hartuar procesverbalin nr. 3383/7 prot., datë 15.05.2020, ku dokumenton marrjen në dorëzim të artikujve sipas kërkesës. Komisioni përcakton sasinë e artikujve, duke cituar “mori në dorëzim të gjithë artikujt sipas listës dhe sasive të mësipërme dhe nuk u konstatua asnjë mangësi”, por nuk rezulton të ketë administruar dokumentacion shoqërues certifikata cilësie, sipas përcaktimit në ftesën për ofertë, ku kërkohet që artikujt të jenë “Certifikuar Standard Ndërkombëtar i miratuar nga OBSH”, si dhe asnjë të dhënë tjetër mbi ambalazhimin dhe cilësinë e artikujve, për të garantuar se janë në përputhje me specifikimet teknike të miratuara në Udhëzimin e përbashkët të APP dhe MShMS nr. 294, datë 06.05.2020.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 104, datë 12.06.2020**, në vlerën prej **547,200 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes nr. 710, datë 15.05.2020. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 14, datë 15.05.2020.

4. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje covers (kapuçë/mbështjellës) një përdorimesh për mikrofonta dhe kufje të seancave publike që zhvillon KPK, për vitin 2020”, nr. REF-58677-05-20-2020, me fond limit 798,750 lekë pa TVSH.

Nëpërmjet shkresës nr. 3629 prot., datë 19.05.2020, KPV ka kërkuar zhvillimin e procedurës për blerjen e artikujve kapuçë mbështjellës një përdorimesh për mikrofontat dhe kufjet në seanca publike (dëgjimore dhe shpallje të vendimeve) që zhvillon KPK. Titullari i AK ka miratuar Urdhrin e prokurimit nr. 55, datë 19.05.2020, duke kërkuar realizimin e procedurës së prokurimit për mallrat, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi ose përshkrimi	Njësia	Sasia
1.	Covers (kapuçë/ mbështjellës) një përdorimesh për mikrofonta CS-1DU (20-30mm diametër)	Copë	1,600
2.	Covers (kapuçë/ mbështjellës) një përdorimesh për kufje (50-60mm diametër)	Copë	4,500

Komisioni i Prokurimit me Vlerë të vogël ka hartuar relacionin nr. 3629/3 prot., datë 19.05.2020, mbi specifikimet teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për mallrat e kërkuar, ku sikurse cituar “pasi analizoi çmimet e tregut”, ka përcaktuar fondin limit prej 798,750 pa TVSH, por pa dokumentuar se ka ndjekur një nga alternativat e përcaktuara në nenin 59, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Pas hapjes së ofertave, KBV ka shpallur fitues OE “EH” me ofertën ekonomike më të ulët, në vlerën prej 484,000 lekë pa TVSH, i cili ka paraqitur dokumentacionin fizik administruar në KPK me nr. 3629/5 prot., datë 22.05.2020. Komisioni i marrjes në dorëzim ka hartuar procesverbalin nr. 3629/7 prot., datë 25.05.2020, ku dokumenton marrjen në dorëzim të artikujve sipas kërkesës.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 116, datë 18.06.2020**, në vlerën prej **580,800 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes nr. 366, datë 25.05.2020. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 15, datë 25.05.2020.

5. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje pjesë ndërrimi për fotokopje drum, fuser, roller, etj.”, me nr. REF-71033-09-09-2020, me fond limit 800,000 lekë pa TVSH.

Nëpërmjet shkresës nr. 5955 prot., datë 08.09.2020, specialistja IT E.A ka kërkuar fillimin e procedurës së prokurimit “*Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës (pjesë ndërrimi për fotokopjet)*”, për fotokopjet Xerox B7030 Versalink Black, me artikujt, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Pjesa e instaluar	Numri i kopjeve	Sasia
1	Drum Cartridge	113R00779	80,000	20
2	Fuser R8	115R00115	100,000	5
3	Transfer Roller R7	115R00116	200,000	5
4	Set Gomina ADF			10
5	Gomina e marrjes së letrës			20
6	Sensor të temperaturës			3
7	Gomina sirtari			30
8	Bordi i komandave			1
9	Bordi i ushqimit			3
10	Sensor i letrës			3
11	Bypass Try Roll			2
12	Bypass Feed Clutch			2

Nëpërmjet relacionit nr. 5955/1 prot., datë 08.09.2020, KBV ka hartuar specifikimet teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, sikurse cituar bazuar në ofertat e 3 subjekteve të ndryshme, në vlerën prej 800,000 lekë pa TVSH. Bashkëlidhur është shkresa e nënshkruar nga E.A, specialist IT, me kriteret e vendosura në ftesën për ofertë, ku listohen certifikatat ISO të nevojshme për OE. Titullari i AK ka miratuar Urdhrin e prokurimit nr. 5955/2 prot., datë 08.09.2020.

Në ftesën për ofertë nr. 5955/3 prot., datë 08.09.2020, rezulton të jetë vendosur kriteri në pikën 3, ku kërkohet që “*OE të ketë të paktën 1 specialist të kualifikuar me diplomë në inxhinieri elektronike*”. KBV nuk rezulton të ketë argumentuar vendosjen e këtij kriteri, në mospërputhje me nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

KBV ka hartuar relacionin nr. 5955/6 prot., datë 18.09.2020, ku paraqitet ecuria e procedurës së prokurimit. Në këtë relacion citohet se “*Më pas komisioni kaloi tek OE i renditur i katërti “A” (me ofertë ekonomike 676,000 lekë pa TVSH), i cili pas njoftimit të shpallur fitues, u paraqit pranë AK me dokumentacionin përkatës. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, rezultoi se certifikatat ISO të kërkuara në ftesën për ofertë mungonin. Për këtë arsye, komisioni vendosi skualifikimin e OE*”. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion, nuk rezulton të jetë administruar (duke mos marrë as numër rendor protokolli) dokumentacioni fizik i paraqitur nga ky OE, duke mos garantuar gjurmën e auditimit për ofertat e skualifikuara, sipas përcaktimit në nenin 12, pika 2, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

Pas tërheqjes së 6 OE dhe skualifikimit të 1 OE, KBV ka shpallur fitues OE “EH” me ofertë ekonomike 744,000 lekë pa TVSH, i cili ka paraqitur dokumentacionin fizik administruar në KPK me nr. 5955/5 prot., datë 18.09.2020.

Nëpërmjet PV nr. 5955/7 prot., datë 18.09.2020, Komisioni i marrjes në dorëzim ka dokumentuar marrjen në dorëzim të pajisjeve, duke cituar “*sipas listës dhe sasive dhe nuk u konstatua asnjë mangësi*”. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nuk administrohet dokumentacioni shoqërues të artikujve, si certifikata cilësie dhe origjine, për të garantuar se pjesët janë origjinale, me pulla sigurie, të reja, të pahapura dhe të ambalazhuara dhe certifikatë garancie 1-vjeçare (sipas përcaktimit në Ftesën për ofertë).

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 178, datë 25.09.2020**, në vlerën prej **892,800 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes nr. 425, datë 18.09.2020. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 25, datë 18.09.2020.

6. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Shpenzime orendi zyre”, nr. REF-74035-10-06-2020, me fond limit 450,000 lekë pa TVSH.

Komisioni i Blerjeve të Vogla ka hartuar relacionin nr. 6581/1 prot., datë 05.10.2020 mbi specifikimet teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për artikujt, si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1.	Raft me 4 kapakë melamine me përmasa 90*45*200 (cm)	Copë	20
2.	Tavolinë pune rang drejtuesi me përmasa 160*75*220 (cm)	Copë	1

Në relacion, anëtarët e KBV citojnë se “*në përputhje me fondin limit të tavolinës së punës u morën çmimet nga 3 subjekte... bazuar në eksperiencën e viteve më përpara, dollapët melamin me dy kapakë me përmasa 90*45*200 kushtojnë rreth 20,000 lekë pa TVSH/ copa*”, duke përcaktuar fondin limit prej 450,000 lekë pa TVSH. Titullari i AK ka miratuar Urdhrin e prokurimit nr. 6581/2, datë 05.10.2020. Në ftesën për ofertë nr. 6581/3 prot., datë 05.10.2020, përcaktohen specifikimet teknike të mallit. Në këtë dokument janë paraqitur edhe kriteret e kualifikimit, ku ndër të tjera kërkohet që OE të paraqesë certifikatat ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015. KBV nuk ka argumentuar teknikisht këtë kriter të vendosur, në mospërputhje me nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

Pas tërheqjes së 2 OE, KBV ka shpallur fitues OE “SH”, me ofertë ekonomike 376,500 lekë pa TVSH, i cili ka paraqitur dokumentacionin fizik administruar në KPK me nr. 6581/7 prot., datë 09.10.2020. Nëpërmjet PV nr. 6581/9 prot., datë 19.10.2020, Komisioni i marrjes në dorëzim ka dokumentuar marrjen në dorëzim të pajisjeve, duke cituar “*sipas listës dhe sasive dhe nuk u konstatua asnjë mangësi*”.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 198, datë 26.10.2020**, në vlerën prej **451,800 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes nr. 881/2, datë 19.10.2020. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 31, datë 19.10.2020.

II. Zbatimi i kontratave për procedurat e kryera nga organi qendror blerës

Zbatimi i kontratës me objekt “Shpenzime për blerje kompjuterësh”, për vitin 2020.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, ka rezultuar se:

Nëpërmjet shkresës nr. 7281 prot., datë 19.11.2020 dhe nr. 7281/1 prot., datë 02.12.2020, Kryetari i KPK i drejton AKSHI-t kërkesën urgjente për kryerjen e procedurave të prokurimit me objekt “*Blerje laptopë për nevoja të KPK*”, në total 20 laptop me fond në dispozicion 2,000,000 lekë. Pas njoftimit për anulim të procedurës nga AKSHI, administruar në KPK me nr. 7281/3 prot., datë 09.12.2020, Kryetari i KPK i drejton AKSHI-t kërkesën nr. 8113 prot., datë 11.12.2020, ku paraqet nevojën për blerjen e 15 kompjuterëve desktop për nevoja të KPK, me fond në dispozicion 2,000,000 lekë.

Drejtori i Përgjithshëm i AKSHI ka dërguar autorizimin për lidhje kontrate, administruar në KPK me nr. 24.12.2020, ku citohet “*duke bashkëlidhur Urdhrin e prokurimit, marrëveshjen kuadër, njoftimin e fituesit, formularin e ofertës dhe specifikimet teknike*”. Pavarësisht sa më sipër, në dokumentacionin e vënë në dispozicion nuk administrohet formuari i ofertës, ku të jenë përcaktuar të dhënat mbi origjinën dhe firmën prodhuese të pajisjeve që janë pranuar në ofertë.

Kryetari i KPK ka autorizuar Sekretarin e Përgjithshëm të KPK për nënshkrimin e kontratës me objekt “*Blerje pajisje TIK (kompjuter) për KPK*”. Ndërmjet KPK dhe BOE “IS&GJK” ShPK është lidhur kontrata nr. 8312/2 prot., datë 24.12.2020, me vlerë totale 1,152,000 lekë pa TVSH ose 1,382,400 lekë me TVSH.

Specialisti i IT E.A ka hartuar Akt-konstatimin nr. 8312/4 prot., datë 28.12.2020, ku citohet se “*pas testimit dhe verifikimit të njërit prej 15 kompjuterëve desktop 2, të zgjedhur në mënyrë rastësore, konstatohet që kompjuteri është sipas parametrave të kërkuar...*”. Specialisti i IT shprehet se ka testuar vetëm një prej kompjuterëve, pa përcaktuar nëpërmjet numrit serial kompjuterin specifik, si dhe pa u shprehur nëse të gjithë kompjuterët kanë parametra të njëjtë.

Komisioni i marrjes në dorëzim ka marrë në dorëzim 15 copë kompjuter desktop, dokumentuar nëpërmjet procesverbalit nr. 8312/5 prot., datë 28.12.2020. Bashkëlidhur këtij dokumenti, anëtarët e këtij komisioni kanë nënshkruar së bashku me përfaqësues të OE akt-dorëzimi, të pa protokolluar, ku përcaktohet se janë marrë në dorëzim 15 kompjuter sipas specifikimeve teknike të markës “D”. Komisioni i marrjes në dorëzim, i cili ka hartuar PV nr. 8312/5 prot., datë 28.12.2020, nuk ka në përbërje specialist të fushës, në kundërshtim të pikës 43 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Komisioni i marrjes në dorëzim nuk rezultoi të ketë administruar dokumentacionin shoqërues të pajisjeve kompjuter, për të garantuar cilësinë e tyre, si certifikatë cilësie, certifikatë origjine, raport teste, apo çdo dokument tjetër që shërben për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike dhe cilësinë që mallrat duhet të kenë në momentin e dorëzimit pranë AK.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 253, datë 29.12.2020**, në vlerën prej **1,382,400 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes nr. 270221942, datë 28.12.2020. Pajisjeve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 39, datë 28.12.2020.

Për vitin 2021

- **Titullari i AK** – PQ, me detyrë Kryetar i KPK.
- **Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël** ka patur në përbërje, si më poshtë:
Sipas Urdhrit nr. 1, datë 06.01.2021: A.P, E.D (Tufi), S.Sh.

- **Komisioni i marrjes në dorëzim** ka patur në përbërje, si më poshtë:
Sipas Urdhrit nr. 2, datë 06.01.2021: E.D, E.A, Y.SH.

Në Regjistrin e realizimeve të prokurimit publik për vitin 2021, janë pasqyruar gjithsej 26 procedura prokurimi, 8 prej të cilave procedura prokurimi me vlerë të vogël, si dhe një modifikim kontrate, me vlerë totale 7,134,575 lekë pa TVSH. Pas konfirmimit nga KPK, procedurat e prokurimit ku KPK është autoritet kontraktor rezultojnë, si më poshtë:

Lloji i procedurës	Numri i procedurave	Vlera totale e kontraktuar (lekë pa TVSH)
Kërkesë për propozim	3	12,542,536
Blerje me vlerë të vogël	9	5,880,228
Blerje shkresore	17	1,254,347
TOTALI	29	19,677,111

Burimi: Drejtoria Ekonomike në KPK

Sa i përket procedurave “Kërkesë për propozim”, për vitin 2021 rezultojnë, si më poshtë:

Nr.	Objekti	Fondi limit (pa TVSH)	Vlera e kontratës (pa TVSH)	Data e lidhjes së kontratës	Organi qendror blerës
1	Sigurim jete Loti I (Për Komisionerët)	4,500,000	4,452,000	24/12/2021	ABP
2	Sigurim jete Loti II (për familjarët, këshilltarët dhe staf admin.)	6,500,000	6,401,436	29/10/2021	ABP
3	Blerje Laptop Loti VI	2,566,667	1,499,100	17/06/2021	AKSHI
4	Blerje UPS Loti I	833,333	190,000	17/06/2021	AKSHI
TOTALI		14,400,000	12,542,536		

Burimi: Drejtoria Ekonomike në KPK

I. Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje kancelari të ndryshme dhe letër A4”, nr. REF-85528-02-02-2021, me fond limit 800,000 lekë pa TVSH.

Nëpërmjet shkresës nr. 1111 prot., datë 01.02.2021, Komisioni i Blerjeve të Vogla (këtej e tutje KBV) ka kërkuar kryerjen e procedurës së prokurimit me objekt “blerje kancelari”. Nëpërmjet

shkresës nr. 1111/1 prot., datë 01.02.2021, KBV ka hartuar relacionin mbi specifikimet teknike, duke përllogaritur fondin limit bazuar në kontratën me të njëjtin objekt për vitin 2020, në vlerën prej 800,000 lekë pa TVSH. Titullari i AK ka miratuar Urdhrin e prokurimit nr. 1111/2 prot., datë 01.02.2021, sipas kërkesës. Sekretari i Përgjithshëm i KPK ka miratuar ftesën për ofertë nr. 1111/3 prot., datë 01.02.2021.

Pas mosparaqitjes së 1 OE, KBV shpalli fitues OE “LD” me ofertë ekonomike 666,666 lekë pa TVSH. OE ka paraqitur dokumentacionin fizik, administruar në KPK me nr. 1111/6 prot., datë 05.02.2021. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion, administrohet deklarata nga OE mbi cilësinë e artikujve, por jo skeda teknike ose katalogu i letrës dhe/ ose vërtetim/ deklaratë/ autorizim (të përkthyer dhe noterizuara) për specifikimet teknike të letrës, të lëshuar/ konfirmuar nga prodhuesi i letrës.

Komisioni i marrjes në dorëzim ka dokumentuar marrjen në dorëzim të artikujve në PV nr. 1111/8 prot., datë 08.02.2021. Komisioni nuk rezulton të ketë administruar dokumentacionin shoqërues të artikujve (për sa aplikohet), si certifikatat ISO të specifikuara në Ftesën për ofertë për letrën A4, apo vërtetim/ deklaratë/ autorizim për specifikimet teknike të lëshuar nga prodhuesi i letrës, sipas përcaktimeve në Ftesën për ofertë, për të garantuar jo vetëm sasinë e artikujve të furnizuar, por edhe cilësinë e tyre.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 25, datë 24.02.2021**, në vlerën prej **544,340 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 4/2021, datë 08.02.2021. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjeve 1, 1/1, 1/2, datë 08.02.2021.

2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje tonera – bojë për fotokopje”, nr. REF-94036-04-27-2021, me fond limit 225,000 lekë pa TVSH.

Nëpërmjet shkresës nr. 3422 prot., datë 26.04.2021, KBV ka hartuar relacionin mbi specifikimet teknike për objektin e prokurimit “furnizime dhe materiale të tjera zyre dhe të përgjithshme”, për sasinë prej 30 copë të produktit “Bojë për fotokopje”, duke u bazuar në çmimin e kontratave të mëparshme në përllogaritjen e fondit limit, në vlerën prej 8,500 lekë pa TVSH/ njësi ose 225,000 lekë pa TVSH në total. Titullari i AK ka miratuar Urdhrin e prokurimit nr. 69, datë 27.04.2021 për artikujt sipas kërkesës. Sekretari i Përgjithshëm i KPK ka miratuar ftesën për ofertë nr. 3432/3 prot., datë 27.04.2021.

Pas tërheqjes së 1 OE, KBV ka shpallur fitues OE “IO”, me ofertë ekonomike 189,666 lekë pa TVSH. OE ka paraqitur dokumentacionin fizik, administruar në KPK me nr. 3432/6 prot., datë 04.05.2021. Pjesë e dokumentacionit të paraqitur është dokumenti “*Deklaratë për origjinën dhe cilësinë*”, ku OE citon “*artikujt janë prodhuar sipas standardeve ndërkombëtare të cilësisë, certifikuar ISO 9001 për cilësinë. Të gjitha mallrat janë të standardeve europiane ose të njësuara me to. Tonerat janë prodhuar në Japoni*”.

Komisioni i marrjes në dorëzim ka dokumentuar marrjen në dorëzim të artikujve në PV nr. 3432/8 prot., datë 04.05.2021. Pavarësisht specifikimeve në Ftesën për ofertë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk rezulton që Komisioni i marrjes në dorëzim të ketë administruar dokumentacionin shoqërues të artikujve, si certifikata origjine, cilësie, apo të jenë shprehur mbi ambalazhimin e artikujve, duke u mjaftuar vetëm me vetëdeklarimin e OE, për të garantuar jo vetëm sasinë, por edhe cilësinë e mallit të prokuruar.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 77, datë 10.05.2021**, në vlerën prej **227,600 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 252/2021, datë 04.05.2021. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 8, datë 04.05.2021.

3. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Shpenzime për mirëmbajtjen (riparimin) e pajisjeve elektronike”, me nr REF-98328-06-16-2021, me fond limit 800,000 lekë pa TVSH.

Nëpërmjet shkresës nr. 4624 prot., datë 16.06.2021, E.A. (specialist IT) ka kërkuar kryerjen e procedurës së prokurimit për mirëmbajtjen dhe funksionimin e pajisjeve elektronike fotokopje, skaner, kompjuter, laptop, etj. Nëpërmjet shkresës nr. 4624/1 prot., datë 16.06.2021, KBV ka hartuar relacionin mbi specifikimet teknike dhe përlogaritjen e fondit limit për objektin e prokurimit “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve elektronike”, ku bazuar në 3 oferta u përcaktua fondi limit prej 800,000 lekë pa TVSH. Titullari i AK ka miratuar Urdhrin e prokurimit nr. 78, datë 16.06.2021. Sekretari i Përgjithshëm i KPK ka miratuar ftesën për ofertë nr. 4624/3 prot., datë 16.06.2021.

Pas tërheqjes së 1 OE, KPV ka shpallur fitues OE “EH”, me ofertë ekonomike 644,000 lekë pa TVSH. OE ka paraqitur dokumentacionin fizik administruar në KPK me nr. 4624/6 prot., datë 22.06.2021.

Ndërmjet AK dhe OE është lidhur kontrata e shërbimit nr. 4624/8 prot., datë 23.06.2021, me afat përgjatë gjithë vitit 2021.

OE është likuiduar në total në vlerën prej **772,800 lekë**, si më poshtë nëpërmjet:

1. Urdhër shpenzimit nr. 189, datë 21.10.2021, në vlerën prej **541,800 lekë**: bazuar në faturën elektronike nr. 80/2021, datë 14.10.2021 dhe PV nr. extra prot., datë 23.06.2021, nënshkruar nga specialisti IT, E.A. dhe E.H, ku citohet se “u riparuan 7 fotokopje XEROX Versalink B7030 (profilaksi e plotë, zëvendësim i setit të gominave, transfer roller, feed roller assembly, separation roller)” dhe faturën elektronike nr. 80/2021, datë 14.10.2021. Shërbimet e faturuara nuk janë në përputhje me procesverbalin ngjitur Urdhër-shpenzimit. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion, administrohen edhe 2 PV, të paprotokolluara, të cilat nuk i janë bashkëngjitur Urdhër-shpenzimit, si më poshtë:

- PV i datës 01.07.2023, i nënshkruar nga specialisti IT, E.A dhe E.H, ku citohet se “u rregulluan 6 kompjuter dhe 2 fotokopje. Kompjuterët kishin riparim të sistemit, ndërsa fotokopjet kishin pastrim të skanerit ADF, pastrim nga telat e hapëseve tek dy fotokopjet”;
- PV i datës 12.07.2023, i nënshkruar nga specialisti IT, E.A dhe E.H, ku citohet se “u rregulluan 6 fotokopje, të cilat kishin profilaksi dhe konfigurim”.

2. Urdhër-shpenzimit nr. 242, datë 20.12.2021, në vlerën prej **231,000 lekë**: bazuar në 7 (shtatë) procesverbale, të nënshkruara nga specialisti IT, E.A dhe E.H, të pa protokolluar dhe faturën elektronike nr. 114/2021, datë 10.12.2021.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, ka rezultuar se procesverbalet e hartuara për marrjen në dorëzim të shërbimit, në cilësinë e dokumentacionit vërtetues, përpos faktit se nuk janë të protokolluar dhe në 1 nga rastet nuk i janë bashkëngjitur Urdhër-shpenzimit, janë nënshkruar vetëm nga E.A për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, dhe nga 1 person për O.E dhe jo nga Komisioni i marrjes në dorëzim, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011.

4. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës”, nr. REF-07829-10-12-2021, me fond limit 800,000 lekë pa TVSH.

Nëpërmjet shkresës nr. 6968 prot., datë 12.10.2021, E.A (specialist IT) ka kërkuar kryerjen e procedurës së prokurimit për mirëmbajtjen dhe funksionimin e pajisjeve të zyrës, pjesë ndërrimi për fotokopje dhe printera, për artikujt, si më poshtë:

Nr.	Përshkrim	Pjesa e instaluar	Nr. i kopjeve	Sasia
Versalink XEROX B7030				
1	Drum cartridge	113R00779	80,000	13
2	Fuser R8	115R00115	100,000	6
3	Transfer roller R7	115R00116	120,000	6
4	Set gomina ADF			2
5	Gomina e marrjes së letrës			2

6	Ndërrim hard-drive			1
7	Riparim firmware + sistem			1
8	Ndërrim/ riparim i portave USB			1
9	Gomina sirtari			5
Lexmark CS417dn				
1	Drum – Black	700D1	40,000	2
2	Drum – Magenta	70C030	40,000	2
3	Drum – Cyan	70C0D20	40,000	2
4	Drum – Yellow	700D4	40,000	2
5	Gomina e marrjes së letrës			5
6	Ndërrim/ riparim roller fuser			2

KPV ka hartuar relacionin nr. 6968/1 prot., datë 12.10.2021 mbi specifikimet teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit, ku bazuar në ofertat e marra, është përcaktuar fondi limit prej 800,000 lekë pa TVSH. Bashkëlidhur këtij relacioni, specialisti i IT, E.A ka përcaktuar certifikatat ISO që OE duhet të paraqesë për t'u kualifikuar.

Titullari i AK ka miratuar Urdhrin e prokurimit nr. 6968/2 prot., datë 12.10.2021, sipas kërkesës. Sekretari i Përgjithshëm i KPK ka miratuar ftesën për ofertë nr. 6968/3 prot., datë 12.10.2021. Pas tërheqjes dhe mosparaqitjes së 5 OE, KPV ka shpallur fitues OE “EH” me ofertë ekonomike 724,000 lekë pa TVSH, i cili ka paraqitur dokumentacionin fizik, administruar në KPK me nr. 6968/10 prot., datë 22.10.2021.

Komisioni i marrjes në dorëzim ka hartuar procesverbalin nr. 6968/12 prot., datë 27.10.2021, duke dokumentuar marrjen në dorëzim të artikujve të përcaktuar. Ky komision nuk rezulton të ketë administruar dokumentacionin shoqërues të artikujve (për sa aplikohet), si certifikatë cilësie dhe origjine, për të garantuar se pajisjet janë prodhime të firmave përkatëse, sipas përcaktimeve në Ftesën për ofertë, për të garantuar jo vetëm sasinë e artikujve të furnizuar, por edhe cilësinë e tyre.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 221, datë 26.11.2021**, në vlerën prej **868,800 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 61/2021, datë 27.10.2021. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 19, datë 27.10.2021.

5. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje tonera për printer”, nr. REF-13268-11-26-2021, me fond limit 610,000 lekë pa TVSH.

Nëpërmjet shkresës nr. 9429 prot., datë 26.11.2021, KBV ka kërkuar kryerjen e procedurës së prokurimit për furnizimet me artikujt, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1.	Lexmark CS417dn black	Min. 6,000 fletë	Copë	9
2.	Lexmark CS417dn yellow	Min. 3,500 fletë	Copë	10
3.	Lexmark CS417dn magenta	Min. 3,500 fletë	Copë	10
4.	Lexmark CS417dn cyan	Min. 3,500 fletë	Copë	10
5.	Toner për fotokopje XEROX Versalink B7030	15,500 – 31,000 fletë	Copë	14

Nëpërmjet shkresës nr. 9429/1 prot., datë 26.11.2021, KBV ka hartuar relacionin mbi specifikimet teknike për objektin e prokurimit “furnizime dhe materiale të tjera zyre dhe të përgjithshme”, për të cilat është përlllogaritur fondi limit bazuar në ofertat në treg në vlerën 610,000 lekë pa TVSH. Titullari i AK ka miratuar Urdhrin e prokurimit nr. 115, datë 26.11.2021, sipas kërkesës. Sekretari i Përgjithshëm i KPK ka miratuar ftesën për ofertë nr. 9429/3 prot., datë 26.11.2021.

KBV ka hartuar procesverbalin nr. 9429/6 prot., datë 03.12.2021, pas hapjes së ofertave, ku janë refuzuar ofertat e 3 OE për shkak se janë nën 50% të fondit limit.

KBV ka hartuar procesverbalin nr. 9429/13, datë 14.12.2021, ku citohet se “për arsye të skualifikimit (për shkak të tërheqjes ose mosparaqitjes) të OE të parë të shpallur nga sistemi si fitues dhe të skualifikuar sipas PV bashkëlidhur, bazuar në kriterin e çmimit më të ulët, komisioni kaloi tek OE “EH”, me ofertë ekonomike prej 584,000 lekë pa TVSH, i cili ka paraqitur dokumentacionin fizik administruar në KPK me nr. 9423/12 prot., datë 14.12.2020. OE ka paraqitur, ndër të tjera, vetëdeklarim të origjinës së mallit, cilësisë dhe garancisë, ku citohet se “produktet janë produkte të Bashkimit Europian, si vend origjine Hollandë,

Gjermani, Itali, etj. Produktet janë prodhuar nga fabrikat respektive dhe përmbushin të gjitha standardet e cilësisë”.

Komisioni i marrjes në dorëzim ka dokumentuar marrjen në dorëzim të artikujve në PV nr. 9429/14 prot., datë 15.12.2021. Pavarësisht specifikimeve në Ftesën për ofertë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk rezulton që Komisioni i marrjes në dorëzim të ketë administruar dokumentacionin shoqërues të artikujve, si certifikata origjine, cilësie, si dhe nuk janë shprehur mbi ambalazhimin e artikujve, për të garantuar jo vetëm sasinë, por edhe cilësinë e mallit të prokuruar.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 244, datë 20.12.2021**, në vlerën prej **700,800 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 124/2021, datë 16.12.2021. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 28, datë 16.12.2021.

II. Zbatimi i kontratave për procedurat e kryera nga organi qendror blerës

1. Mbi sigurimin e jetës dhe shëndetit

Neni 25 i Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” përcakton se anëtarët e institucioneve të rivlerësimit, personat e lidhur me ta dhe personeli i institucioneve të rivlerësimit gëzojnë të drejtën për mbrojtje të veçantë nga shteti për jetën, shëndetin dhe pasurinë e tyre, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e veçantë. Në zbatim e në mbështetje të kësaj dispozite, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka prokuruar shërbimin e sigurimit të shëndetit dhe/ ose jetës përgjatë viteve periudhë auditimi, si më poshtë:

Nr.	Viti	Objekti	Fondi limit (lekë pa TVSH)	Lloji i procedurës	Vlera e kontratës (lekë pa TVSH)	Data e lidhjes së kontratës	Organi qendror blerës	U-SH	
								Nr.	Datë
1	2019	Sigurim jete dhe shëndeti për 12 Komisionerët	4,600,000	Kërkesë për propozim	4,392,000	13/06/2019	ABP	124	21/06/2019
2	2020	Sigurimi i jetës dhe shëndetit	10,000,000	Kërkesë për propozim	8,852,100	17/07/2020	ABP	147 156	07/08/2020 27/08/2020
3	2021	Modifikim kontrate +20%	890,000	Shtesë kontrate	890,000	29/07/2021	-	144	05/08/2021
4	2021	Loti I (për Komisionerët)	4,500,000	Kërkesë për propozim	4,452,000	24/12/2021	ABP	249	29/12/2021
5	2021	Loti II	6,500,000	Kërkesë për propozim	6,401,436	29/10/2021	ABP	205	08/11/2021
6	2022	Loti I (sigurim jete për Komisionerët)	1,392,000	Kërkesë për propozim	1,380,000	13/12/2022	ABP	237	22/12/2022
7	2022	Loti II (sigurim shëndeti për Komisionerët)	3,060,000	Kërkesë për propozim	3,009,600	13/12/2022	ABP	242	27/12/2022
8	2022	Loti III	6,537,637	Kërkesë për propozim	6,432,000	28/10/2022	ABP	210 231	15/11/2022 14/12/2022
9	2023	Loti I (sigurim jete për Komisionerët)	1,380,000	Kërkesë për propozim	1,356,000	12/04/2023	ABP	328	27/12/2023
10	2023	Loti II (sigurim shëndeti për Komisionerët)	3,009,600	Kërkesë për propozim	2,963,400	01/11/2023	ABP	301	01/12/2023
11	2023	Loti III	6,432,000	Kërkesë për propozim	6,336,000	26/10/2023	ABP	269	31/10/2023
TOTALI			48,301,237		46,464,536				

Burimi: Drejtoria Ekonomike në KPK

Shtesa 20% e kontratës me objekt “Sigurimi i jetës dhe shëndetit të komisionerëve të KPK-së”, Loti 1, për vitin 2020

Ndërmjet KPK dhe BOE “SUGA” sh.a & “SLUGA” sh.a & SC” sh.a është lidhur kontrata nr. 1299/9, datë 30.07.2020 me objekt “Sigurim jete dhe shëndeti për Komisionerët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, me vlerë totale 4,452,000 lekë, ku specifikohet se policat e sigurimit janë të vlefshme deri më datë 29.07.2021. OE është likuiduar nëpërmjet Urdhër-shpenzimit nr. 156, datë 27.08.2020, në vlerën prej 4,452,000 lekë.

Nëpërmjet shkresës nr. 3849/1 prot., datë 18.05.2021 drejtuar Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, Kryetari i KPK ka kërkuar kryerjen me prioritet të procedurës së prokurimit me objekt *“Shpenzimet e siguracionit të jetës dhe/ose shëndetit për KPK”*. Nëpërmjet shkresës nr. 3849/2 prot., datë 06.07.2021 drejtuar Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, Kryetari i KPK ka kërkuar informacion mbi ecurinë e kësaj procedure, duke kërkuar marrjen e masave *“me qëllim që personat e siguruar të mos mbeten pa mbulim siguracioni jetë/ shëndeti, pas datës 16 dhe 29 korrik”*. Nëpërmjet shkresës administruar në KPK me nr. 3849/3 prot., datë 21.07.2021, Titullari i Organit Qendror Blerës ABP N.M ka bërë me dije se *“KVO, pasi mori në shqyrtim dhe vlerësoi të gjitha ofertat e paraqitura, ka skualifikuar të gjithë operatorët pjesëmarrës në këtë procedurë. Aktualisht, kjo procedurë prokurimi është në fazën e pritjes së afateve ligjore të ankimimit nga OE të interesuar”*.

Nëpërmjet Vendimit nr. 5730/1 prot., datë 28.07.2021, Kryetari i KPK ka vendosur modifikimin e kontratës bazë fillestare nr. 1299/9 prot., datë 30.07.2020, për sigurimin e shëndetit dhe jetës së anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Loti 1, deri në 20% të çmimit bazë dhe deri në shpalljen e fituesit për kontratën e re të sigurimit. Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion shkresa nr. 5730 prot. Në nenin 17 të kontratës fillestare përcaktohet se *“AK rezervon të drejtën të porosisë shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me procedura e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik”*.

Nëpërmjet shkresës nr. 5732 prot., datë 28.07.2021, Kryetari i KPK i drejtohet përfaqësuesit të BOE “SUGA” sh.a & “SLUGA” sh.a & SC” sh.a, ku bën me dije mbi nevojën për mbulim me sigurim jete/ shëndeti të komisionerëve të KPK-së dhe shtyrjen e afatit të kontratës së lidhur ndërmjet palëve. Në këtë shkresë ndër të tjera citohet se *“duke qenë se ABP-ja duhet të përsërisë procedurat e prokurimit, pas anulimit të procedurës së parë, dhe kontrata aktuale e sigurimit të jetës dhe shëndetit të komisionerëve të KPK-së përfundon në datën 29.07.2021, në këtë rast gjen zbatim neni 76, pika 4, e VKM-së nr. 914/2014, e ndryshuar, ku për nevoja të mbulimit me këtë shërbim, AK duhet të lidhë një shtesë-kontratë përpara mbarimit të afatit të kontratës në fuqi me BOE-n”*. VKM nr. 914/2014, e përdorur si bazë ligjore për të mbështetur këtë veprim, është shfuqizuar nëpërmjet pikës 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*. Pra, në momentin e kërkesës për modifikim të kontratës, ky akt që është përdorur si bazë ligjore, ka qenë i shfuqizuar. Për rrjedhojë, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit duhet t’i referojë Rregullave të Prokurimit Publik, të miratuara nëpërmjet VKM nr. 285, datë 19.05.2021. Në nenin 23, pika 2, të këtij VKM, përcaktohet se modifikimi i kontratave bëhet vetëm në rastet e parashikuara në nenin 127 të Ligjit nr. 162/2021 *“Për prokurimin publik”*, kur autoriteti kontraktor mund të argumentojë se *ndodhet në njërin nga këto raste*. Në nenin 127, pika 1, të këtij Ligji janë përcaktuar rastet kur mund të modifikohet kontrata publike pa zhvilluar procedurë të re prokurimi. Në *germën c* të kësaj dispozite, një nga rastet e parashikuara është kur modifikimi është bërë i nevojshëm *për shkak të rrethanave të paparashikueshme* nga AK dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike.

Nëpërmjet shkresës nr. 5732/1 prot., datë 29.07.2021, Kryetari i KPK ka autorizuar Sekretarin e Përgjithshëm të KPK për nënshkrimin e modifikimit të kontratës. Ndërmjet AK dhe BOE është nënshkruar modifikimi i kontratës nr. 5732/2 prot., datë 29.07.2021, me objekt *“Sigurim i jetës dhe shëndetit të komisionerëve të KPK-së”*, Loti 1, me vlerë 890,000 lekë, e barabartë me 20% të vlerës së kontratës fillestare, me afat nga data 30.07.2021, për 75 ditë, deri në datën 12.10.2021. Nëpërmjet shkresës nr. 5732/3 prot., datë 06.08.2021, Kryetari i KPK i dërgon APP njoftimin e formularit të modifikimit të kontratës gjatë zbatimit.

Në dokumentacionin e vënë në dispozicion administrohet listë-dorëzimi i kartave të shëndetit, i datës 04.08.2021, i nënshkruar nga secili prej 12 Komisionerëve.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 144, datë 05.08.2021**, në vlerën prej **890,000 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 2915/2021, datë 04.08.2021.

2. Zbatimi i kontratës me objekt “Shpenzime për blerje pajisje elektronike laptop”, për vitin 2021

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, ka rezultuar se:

Nëpërmjet shkresës nr. 2398 prot., datë 10.03.2021, Kryetari i KPK ka dërguar drejt AKSHI kërkesën me objekt “*Kërkesë për kryerjen e procedurave të prokurimit me objekt “Blerje laptop dhe UPS për nevoja të KPK”*”, duke cituar se fondi limit i përlllogaritur, bazuar në specifikimet teknike të publikuara në faqen e AKSHI-t për vitin 2021, si dhe listës së çmimeve, është 2,046,737 lekë pa TVSH për 19 laptop. Nëpërmjet shkresës nr. 3285 prot., datë 19.04.2021, Kryetari i KPK ka dërguar drejt AKSHI-t kërkesën me objekt “*Kërkesë e përsëritur për procedurën “Blerje laptop dhe UPS për nevoja të KPK”*”, duke cituar se fondi limit për blerjen e 19 laptopëve është 2,046,737 lekë pa TVSH.

Nëpërmjet shkresës administruar në KPK me nr. 2398/2 prot., datë 14.06.2021, Drejtori i Përgjithshëm i AKSHI i dërgon KPK autorizimin për lidhjen e kontratës me objekt “*Blerje pajisje TIK – Loti 6 – Blerje kompjutera*”, me OE “CCS” ShPK, me ofertë ekonomike 1,499,100 lekë pa TVSH, duke bashkëlidhur dokumentacionin e procedurës së prokurimit dhe ofertës së paraqitur nga OE. Në formularin e ofertës ekonomike të paraqitur nga OE, administruar si dokumentacion shoqërues i dërguar nga AKSHI, rezulton se OE ka ofertuar për pajisje “*Laptop Basic HP ProBook 450 G8 Notebook PC*”.

Kryetari i KPK ka autorizuar Sekretarin e Përgjithshëm të KPK për nënshkrimin e kontratës së furnizimit ndërmjet AK dhe OE “CCS” ShPK, për Lotin 6 “*Blerje kompjutera*”, sikurse cituar “*të cilët janë shpallur fitues sipas dokumentacionit të përcjellë me shkresën nr. 3956 prot., datë 10.06.2021 nga organi qendror blerës AKSHI*”.

Ndërmjet KPK dhe OE “CCS” ShPK është lidhur kontrata nr. 2398/5 prot., datë 17.06.2021, me vlerë totale prej 1,499,100 lekë pa TVSH ose 1,798,920 lekë me TVSH.

Komisioni i marrjes në dorëzim ka dokumentuar marrjen në dorëzim të 19 “Laptop HP ProBook 450 G8 Notebook PC”, nëpërmjet PV nr. 2398/8 prot., datë 21.06.2021, duke cituar se “*grupi i marrjes në dorëzim, mori në dorëzim të gjithë artikujt në sasinë përkatëse dhe nuk u konstatua asnjë mangësi*”. Komisioni i marrjes në dorëzim nuk rezulton të ketë administruar dokumentacionin shoqërues të pajisjeve, si certifikata cilësie, certifikata origjine, raport teste, si dhe çdo dokument tjetër që shërben për të vërtetuar respektimin e specifikimeve teknike dhe cilësinë që mallrat duhet të kenë, në momentin e dorëzimit pranë Autoritetit Kontraktor.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 109, datë 22.06.2021**, në vlerën prej **1,798,920 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 1245/2021, datë 21.06.2021. Pajisjeve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr. 12, datë 21.06.2021.

Për vitin 2022

Titullari i AK është znj. P.Q, me detyrë Kryetar i KPK-së.

Për vitin 2022, Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël i ngritur me Urdhrin Nr.3, datë 06.01.2022 në përbërje A.P -Kryetare, E.D -Anëtare, S.Sh –Anëtare, i ndryshuar me Urdhrin Nr.3/1, datë 25.08.2022: E.D -Anëtare, zëvendësohet me A.K –Anëtar, i ndryshuar me Urdhrin Nr.99, datë 13.09.2022: A.K -Anëtar, zëvendësohet me DS -Anëtare.

Për vitin 2022, Komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur me Urdhrin Nr. 2, datë 06.01.2022 në përbërje E.D-Kryetar, E.A-Anëtare, Y.SH-Anëtar, i ndryshuar me:

1. Urdhrin Nr. 2, datë 06.01.2022, E.D-Kryetar, E.A-Anëtare, Y.SH-Anëtar.
2. Urdhrin Nr. 69, datë 22.06.2022, E.A-Anëtare, zëvendësohet me B.C -Anëtar.
3. Urdhrin Nr. 91, datë 22.06.2022, B.C -Anëtare, zëvendësohet me R.B -Anëtar.

4. Urdhrin Nr. 91/1, datë 01.09.2022, E.A, rikthehet anëtare e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave, shërbimeve dhe punëve gjatë vitit 2022, Urdhri Nr.91, datë 22.06.2022 shfuqizohet.

Në regjistrin e realizimeve të prokurimit publik për vitin 2022, janë pasqyruar gjithsej 19 procedura prokurimi, 6 prej të cilave procedura prokurimi me vlerë të vogël, me vlerë totale 3,975,336 lekë pa TVSH, 11 procedura shkresore nën 100 mijë lekë si dhe 1 procedurë për blerje biletash avioni. Pas konfirmimit nga KPK, procedurat e prokurimit ku KPK është autoritet kontraktor rezultojnë, si më poshtë:

Lloji i procedurës	Numri i procedurave	Vlera totale e kontraktuar (lekë pa TVSH)
Kërkesë për propozim	1	10,821,600
Blerje me vlerë të vogël	6	3,975,336
Blerje shkresore (nën 100.000 leke)	11	909,580
Blerje Bileta Avioni	1	34,196
TOTALI	19	15,740,712

Burimi: Drejtoria Ekonomike në KPK, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

I. Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt **“Blerje shërbim mirëmbajtje për lyerje godine për KPK”**, Nr. REF-34142-06-24-2022, me fond limit 800,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën Nr. 2558 Prot, datë 23.06.2022 është bërë kërkesë për blerje **shërbim mirëmbajtje për lyerje godine** për KPK. Bazuar në urdhrin tuaj paraprak lidhur me lyerjen e një pjese të sipërfaqes së brendshme të godinës së KPK-së, si dhe parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik për vitin 2022, sugjerojmë realizimin e procedurës së prokurimit “Blerje shërbim mirëmbajtje për lyerje godine për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.”. Për sa më lart, bazuar në refuzimin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore me shkresën nr. 512/1 prot, datë 24.3.2022, ardhur në përgjigje të shkresës sonë nr.1089, datë 16.3.2022 “Kërkesë për asistencë teknike me specialist/ekspert të IKTK për hartimin e relacionit teknik dhe preventivit përkatës”, (bashkangjitur, kopje të korrespondencës zyrtare), matjet janë realizuar nga punonjësit mbështetës të stafit të KPK-së, duke përdorur aparat matës profesional me laser dhe kanë rezultuar në total afërsisht 2800 m2.

KBV, me shkresën Nr. 2558/1 Prot, datë 23.06.2022 ka hartuar relacion “Mbi specifikimet teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për objektin e prokurimit “Blerje shërbim mirëmbajtjeje për lyerje godine për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, si dhe ka kryer përllogaritjen e fondit limit duke testuar tregun me 3 operatorë ekonomikë në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 76 si dhe duke bashkëlidhur situacionin e prokurimit.

Titullari i AK PQ me Urdhrin e prokurimit Nr. 71, datë 23.06.2022 ka miratuar procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës.

SP i KPK E. V. ka miratuar ftesën për ofertë Nr. 2558/3 Prot, datë 23.06.2022, ku pasqyrohen specifikimet teknike të mallrave, kërkesat e veçanta për kualifikim.

KBV me proces verbalin Nr.2558/5, datë 29.06.2022 “Për kalimin tek operatori ekonomik i radhës” ka skualifikuar OE “AB” sh.p.k, i renditur i pari me ofertë ekonomike 554,000 lekë pa TVSH, për shkak të mos paraqitjes pranë AK sipas ftesës për ofertë.

KBV me proces verbalin Nr.2558/6, datë 30.06.2022 “Për kalimin tek operatori ekonomik i radhës” ka skualifikuar OE “4C” sh.p.k, i renditur i dyti me ofertë ekonomike 557,200 lekë pa TVSH, për shkak të mos paraqitjes pranë AK sipas kushteve të përcaktuara në ftesën për ofertë.

KBV me proces verbalin Nr.2558/8, datë 01.07.2022 “Për kalimin tek operatori ekonomik i radhës” ka skualifikuar OE “A” sh.p.k, i renditur i treti me ofertë ekonomike 560,000 lekë pa TVSH, për arsye të mungesës së deklaratës së furnizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, të vlefshme sipas pikës 8 të kërkuar në ftesën për oferte. Autorizimi i dorëzuar nga

ana juaj është i pavlefshëm pasi nuk është i firmosur (vetëm i vulosur). Gjithashtu sipas këtij dokumenti është autorizim distributori, ndërkohë që në faqen zyrtare të web-it të kësaj shoqërie rezulton se Shoqëria Deutschcolor sh.a është prodhuese. Nuk rezultojnë të jenë paraqitur certifikatat e cilësisë së materialeve/mallrave të shoqëruara me raportet e testimit nga laboratorë të akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente, sipas pikës 9 të kërkuar në ftesën për oferte. Certifikata e paraqitura nga ana juaj është certifikatë ISO e Menaxhimit të Cilësisë 9001 e prodhuesit, ndërkohë që kërkohet certifikata e cilësisë së materialit. Gjithashtu kjo certifikatë rezulton e skaduar (Vlefshmëria deri në 30.3.2021)

KBV me proces verbalin Nr.2558/10, datë 07.07.2022 ka shpallur fitues OE “VK” sh.p.k, i renditur i katërti me ofertë ekonomike 750,000 lekë pa TVSH.

OE “VK” është likuiduar nëpërmjet **Urdhër Shpenzimit Nr. 148, datë 18.08.2022**, në vlerën prej **900,000 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes Nr.116/2022 , datë 09.08.2022.

2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje material pastrimi dhe higjieno sanitare 2022”, Nr. REF-21894-03-11-2022, me fond limit 335,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën Nr. 1049/4 Prot, datë 11.03.2022 është bërë kërkesë për blerje material pastrimi dhe higjieno sanitare 2022 për plotësimin e nevojave të institucionit.

KBV, me shkresën Nr. 1049/1 Prot, datë 11.03.2022 ka hartuar relacion “Mbi specifikimet teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për objektin e prokurimit “Blerje materiale për pastrim, dezinfektim”, si dhe ka kryer përllogaritjen e fondit limit duke testuar tregun me 3 operatorë ekonomikë në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 76 si dhe duke bashkëlidhur listën me artikuj dhe specifikimet teknike bashkëlidhur lista e mallrave që do të prokurohen.

Titullari i AK PQ me Urdhrin e prokurimit Nr. 32, datë 11.03.2022 ka miratuar procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës.

SP i KPK E. V. ka miratuar ftesën për ofertë Nr. 1049/2 Prot, datë 11.03.2022, ku pasqyrohen specifikimet teknike të mallrave dhe kërkesat e veçanta për kualifikim.

KBV ka shpallur fitues OE “MV” sh.p.k, i renditur i pari me ofertë ekonomike 279,560 lekë pa TVSH me proces verbalin Nr.1049/7, datë 17.03.2022.

Komisioni i marrjes në dorëzim, me proces verbalin Nr. 1049/8 datë 17.03.2022 ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave.

OE “M.V” është likuiduar nëpërmjet **Urdhër Shpenzimit Nr. 56, datë 30.03.2022**, në vlerën prej **335,472 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes Nr.31/2022 , datë 18.03.2022. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen Nr. 3, Nr. 3/ 1 datë 17.03.2022.

3. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje dhe montim rafte metalike për arkivë”, Nr. REF-53388-12-13-2022, me fond limit 827,700 lekë pa TVSH.

Me shkresën Nr. 4943 Prot, datë 13.12.2022 është bërë kërkesë për blerje dhe montim rafte metalike për arkivë për plotësimin e nevojave të institucionit.

KBV, me shkresën Nr. 4943/2 Prot, datë 13.12.2022 ka hartuar relacion “Mbi specifikimet teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për objektin e prokurimit “Blerje dhe montim rafte metalike për arkivë”, si dhe ka kryer përllogaritjen e fondit limit duke testuar tregun me 3 operatorë ekonomikë në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 76 si dhe duke bashkëlidhur listën me artikuj dhe specifikimet teknike bashkëlidhur lista e mallrave që do të prokurohen.

Titullari i AK PQ me Urdhrin e prokurimit Nr. 132, datë 13.12.2022 ka miratuar procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës.

SP i KPK E.V. ka miratuar ftesën për ofertë Nr. 4943/3 Prot, datë 13.12.2022, ku pasqyrohen specifikimet teknike të mallrave dhe kërkesat e veçanta për kualifikim.

KBV me proces verbalin Nr.4943/4, datë 14.12.2022 ka shpallur fitues OE “F” sh.p.k, i renditur i pari me ofertë ekonomike 628,276 lekë pa TVSH, pasi ka skualifikuar në sistem OE “OH” sepse vlera e ofertuar është më e vogël se 50% e vlerës së fondit limit përlllogaritur nga AK, ndërsa OE e tjerë kanë ofertuar me vlerë më të lartë se fondi limit.

Komisioni i marrjes në dorëzim, me proces verbalin Nr. 4943/5 datë 19.12.2022 ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave.

OE “F sh.p.k” është likuiduar nëpërmjet **Urdhër Shpenzimit Nr. 238, datë 22.12.2022**, në vlerën prej **753,932 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes Nr.597/2022 , datë 19.12.2022. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen Nr. 15, datë 19.12.2022.

4. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje Kancelarie”, Nr. REF-18376-02-01-2022, me fond limit 1,000,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën Nr. 347 Prot, datë 01.02.2022 është bërë kërkesë për blerje kancelari për plotësimin e nevojave të institucionit.

KBV, me shkresën Nr. 347/1 Prot, datë 01.02.2022 ka hartuar raport “Mbi specifikimet teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për objektin e prokurimit “Blerje kancelari” ka kryer përlllogaritjen e fondit limit duke u bazuar në listën e artikujve të kancelarisë së blerë gjatë vitit 2021.

Titullari i AK PQ me Urdhrin e prokurimit Nr. 13, datë 01.02.2022 ka miratuar procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës.

SP i KPK E. V. ka miratuar ftesën për ofertë Nr. 347/3 Prot, datë 01.02.2022, ku pasqyrohen specifikimet teknike të mallrave dhe kërkesat e përgjithshme për kualifikim.

KBV me proces verbalin Nr.347/5, datë 04.02.2022 “Për kalimin tek operatori ekonomik i radhës” ka skualifikuar OE “EQ” sh.p.k, i renditur i pari me ofertë ekonomike 760,667 lekë pa TVSH, për arsye të njoftimit në SPE se tërhiqet nga procedura për arsye përlllogaritjes gabim të vlerës së ofertuar.

KBV me proces verbalin Nr.347/6, datë 07.02.2022 “Për kalimin tek operatori ekonomik i radhës” ka skualifikuar OE “MM” sh.p.k, i renditur i dyti me ofertë ekonomike 768,000 lekë pa TVSH, për arsye të njoftimit në SPE se tërhiqet nga procedura për mospërputhje të specifikimeve teknike dhe pamjaftueshmërisë të kohës fizike për furnizim.

KBV me proces verbalin Nr.347/7, datë 08.02.2022 “Për kalimin tek operatori ekonomik i radhës” ka skualifikuar OE “AA” sh.p.k, i renditur i treti me ofertë ekonomike 789,000 lekë pa TVSH, sepse sipas njoftimit në SPE, OE tërhiqet nga procedura për arsye të angazhimeve të tjera aktuale që ka.

KBV me proces verbalin Nr.347/9, datë 09.02.2022 ka shpallur fitues OE “IO” sh.p.k, i renditur i katërti me ofertë ekonomike 841,000 lekë pa TVSH.

Komisioni i marrjes në dorëzim, me proces verbalin Nr. 347/10 datë 10.02.2022 ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave.

OE “IO” është likuiduar nëpërmjet **Urdhër Shpenzimit Nr. 36, datë 24.02.2022**, në vlerën prej **868,944 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes Nr.1741/2022 , datë 10.02.2022. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me fletë-hyrjen Nr. 1, Nr. 1/1, Nr. 1/2, Nr. 1/3 datë 10.02.2022.

Zbatimi i kontratave:

1. Zbatimi i kontratës me objekt “Sigurim shëndeti për familjarët e Komisionerëve këshilltarët të NJSHL dhe stafit administrativ për KPK Loti III”, për vitin 2022

Kryetarja e KPK me Vendimin Nr. 11, datë 07.04.2022 ka vendosur të kryhet sigurimi i jetës dhe shëndetit të anëtarëve, familjarëve të tyre, si dhe të stafit administrativ të KPK-së mbështetur në nenin C të aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 25 të ligjit Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Kryetarja e KPK me Urdhrin 65, datë 08.06.2022 ka ngritur grupin e punës për hartimin e termave të referencës për sigurimin e jetës dhe/ose shëndetit për KPK me anëtarë AP-Kryetar, E.D - anëtare dhe S.Sh anëtare.

Nëpërmjet Memos me Nr. 1423/8 Prot., datë 29.06.202, grupi i mësipërm i punës pas konsultimit me ekspert të fushës nga AMF kanë përcaktuar tabelat e përfitimeve për lotin 3 si dhe kategoritë përfituese gjithsej 96 persona nga të cilët 91 aktual dhe 5 vakanca përkatësisht 2 vakanca tek Këshilltarët dhe 3 tek Stafi Administrativ.

Grupi i punës me shkresën Nr.1423/10 Prot., datë 18.07.2022 ka hartuar raport për hartimin e termave të referencës, specifikimeve teknike dhe studimit të tregut, për procedurën e prokurimit “Shpenzime siguracion jete dhe/ose shëndeti për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, viti 2022”. Për sa i përket lotit 3 (niveli i dyte) numri i te siguruarve për kontratën e re të sigurimit është 96 persona, nga të cilët 36 këshilltarë (34 aktual dhe 2 vakanca), 32 familjarë të Komisionerëve (nga 33 që ishin vitin e kaluar) dhe 28 staf administrativ (25 aktual dhe 3 vakanca) të ndara sipas grup moshave. Fondi limit për këtë procedurë është 6,500,000 lekë pa TVSH, referuar mesatares së ofertave të marra nga 8 OE në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 76.

Titullari i KPK me shkresën Nr.1423/10 Prot., datë 18.07.2022 i ka dërguar AShPP kërkesën për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Shpenzime siguracion jete dhe/ose shëndeti për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, viti 2022” bashkëlidhur Urdhrin Nr. 65 datë 08.06.2022, ofertat e operatoreve ekonomike dhe relacionin e hartimit të specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit (përfshirë lotin 3).

Nëpërmjet shkresës administruar në KPK me Nr. 4056 Prot., datë 27.10.2022, Drejtori i Përgjithshëm i AShPP ka dërguar njoftimin për lidhje kontrate për Lotin 3 “***Sigurimi i shëndetit për familjarët e Komisionerëve, këshilltarët e Njësisë së shërbimit ligjor, dhe stafin administrativ jetës***” Nr. REF-40434-09-01-2022 me OE “SVIG”, me vlerë ekonomike 6,432,000 lekë pa TVSH.

Titullari i AK me shkresën Nr. 4056/1 Prot., datë 27.10.2022 ka autorizuar SP e KPK të nënshkruajë kontratën e sigurimit për lotin 3.

Ndërmjet KPK dhe OE është lidhur kontrata e blerjes së shërbimit Nr. 4506/2 Prot., datë 28.10.2022, me afat 12 muaj, me vlerë totale 6,432,000 lekë. Në Aneksin nr. 1 janë paraqitur listat e personave të siguruar, në total 96 persona ku ndër të tjera përfshihen 2 vakanca në pikën 1.2 “Këshilltarët e Nj. Ligjore”, me nr. rendorë 35-36 dhe 2 vakanca në pikën 1.3 “Stafi administrativ”, me nr. rendor 27-28, në total 4 vende vakante.

Titullari i KPK me shkresën Nr.4056/3 Prot, datë 02.11.2022 “Autorizim” ka autorizuar Drejtorin Ekonomik dhe Shërbimeve Mbështetëse A.P. dhe Drejtorin për menaxhimin e Çështjeve A.P. për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, Loti 3 Nr. REF-40434-09-01-2022.

Me shkresën Nr.4056/4 Prot, datë 03.11.2022 është hartuar plani i zbatimit të kontratës midis KPK dhe OE.

OE “SIVIG” është likuiduar në total në vlerën prej 6,432,000 lekë, si me poshtë:

1. Nëpërmjet **Urdhër Shpenzimit Nr. 210, datë 15.11.2022**, në vlerën prej **6,164,000 lekë**, bazuar në faturën elektronike Nr.2022241212/2022 , datë 28.10.2022 si dhe proces verbalin Nr.4056/9 Prot., 11.11.2022 ku është dokumentuar marrja në dorëzim e certifikatave dhe kartat e sigurimit të shëndetit për familjarët e Komisionerëve, këshilltarëve të shërbimit ligjor dhe stafin administrativ, në total për 92 persona.

2. Nëpërmjet **Urdhër Shpenzimit Nr. 231, datë 14.12.2022**, në vlerën prej **268,000 lekë**, bazuar në faturën elektronike Nr.2788/2022 , datë 09.12.2022 për 4 persona.

Për vitin 2023

Titullar i AK është znj. P.Q. me detyrë Kryetare e KPK-së deri më 20.07.2023 ku me vendimin nr.38 Kryetar i KPK-së është zgjedhur z.R.I. Me urdhrin nr. 91, datë 25.07.2023 Kryetari i KPK z. R.I. ka deleguar kompetencat tek z. E.V. si Titullar i AK.

Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël ka patur në përbërje, si më poshtë:

Sipas Urdhrit nr.3, datë 06.01.2023: A.P, kryetar, D.S, D.J.

Sipas Urdhrit nr. 39, datë 09.03.2023, D.S zëvendësohet me G.H.

Komisioni i marrjes në dorëzim ka patur në përbërje, si më poshtë:

Sipas Urdhrit nr. 5, datë 06.01.2023: Y.SH, S.SH, E.A;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se për vitin 2023:

KPK ka parashikuar zhvillimin e 26 procedurave me objekt blerje mallra dhe kryerje shërbimesh, nga të cilat 7 procedura “Prokurime me vlera të vogla”, 17 blerje nën vlerën 100,000 lekë, 1 procedurë “Kërkesë për propozim” dhe 1 procedurë blerje bilete.

Procedurat e prokurimit për vitin 2023 për KPK rezultojnë, si më poshtë:

Lloji i procedurës	Nr.	Vlera e kontraktuar (lekë pa TVSH)
Procedurë e hapur		
Kërkesë për propozim	1	10,655,400
Blerje me vlerë të vogël	7	3,912,016
Blerje shkresore (nën 100,000 ALL)	17	1,217,263.32
Blerje bileta	1	195,000
TOTALI	26	15,979,679.32

Burimi: Drejtoria Ekonomike në KPK, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje tonerash për printera”, nr. REF-56173-01-17-2023, me fond limit 997,462 lekë pa TVSH.

Komisioni i prokurimit publik me vlerë të vogël i përbërë nga A.P, D.J, D.S nëpërmjet shkresës me nr. 144 datë 17.01.2023 drejtuar kryetarit të KPK shprehet se bazuar në gjendjen e magazinës për bojëra fotokopje dhe printeri për tipin Lexmark CS417dn dhe XEROX Versalink B7030 kërkon fillimin e procedurës “Blerje bojëra për printer dhe fotokopje” në zërin furnizime dhe materiale tjera zyre të përgjithshme” si më poshtë;

Nr.	Emertimi i artikujve	Njësia	Kodi	Sasia
1	Lexmark CS417dn black minimumi 3,000 fletë	COPE	71B1OKO	19
2	Lexmark CS417dn yellow min 2,300 fletë	COPE	71B1OYO	14
3	Lexmark CS417dn magenta min 2,300 fletë	COPE	71B1OMO	24
4	Lexmark CS417dn cyan min 2,300 fletë	COPE	71B1OCO	19
5	Toner për fotokopje Xerox Versalink B7030-min 30,000 flete	COPE	106R03396	19

Titullari i AK PQ ka miratuar urdhrin e prokurimit nr. 8, datë 17.01.2023, sipas përcaktimit në kërkesë.

Nëpërmjet shkresës nr.144/2 prot., datë 17.01.2023, Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, i përbërë nga A.P, D.J, D.S, ka hartuar relacionin për përllogaritjen e fondit limit, sikurse cituar bazuar në 2 oferta, në vlerën mesatare të përllogaritur prej 997,462 lekë pa TVSH

Sekretari i Përgjithshëm i KPK ka miratuar ftesën për ofertë nr. 144/3 prot., datë 17.01.2023, ku përcaktohen specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit. Në asnjë rast, komisioni i blerjeve të vogla nuk rezulton të ketë argumentuar kriteret e vendosura.

Në këtë dokument janë përcaktuar kriteret si:

- Bojërat për fotokopje duhet të jenë të pajisura me certifikatë origjine;
- Të gjithë artikujt duhet të jenë prodhim konform standardit të Komunitetit Europian, cilësi e parë dhe të shoqëruara me certifikatën e origjinës së mallit;
- Artikujt duhet të jenë në ambalazhim origjinal i cili të shoqërohet me logon e sigurisë;

- Kopje të certifikatës elektronike për fiskalizimin për tatimpaguesin që përdorin platformën qendrore të faturave:

- Kopje të certifikatës elektronike për fiskalizimin dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar për zgjidhjen software-ike në përdorim për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes software-ike.

Grupi i auditimit vlerëson se këto kritere janë të paargumentuar teknikisht. Me procesverbalin me nr. 144/4 datë 18.01.2023 Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël pasi ka bërë vlerësimin e ofertave bazuar në çmimin më të ulët, ku ka konstatuar se kanë ofertuar me të njëjtën vlerë 2 OE, “AP” dhe “IO”, për këtë arsye janë njoftuar për hedhje shorti në mënyrë që të bëhet e mundur përcaktimi i vendit të parë dhe të dytë.

Me procesverbalin me nr. 144/5 prot datë 19.01.2023 mbajtur nga Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël sqarohet se subjekti IO ka dërguar mesazh në SPE për pamundësi për tu paraqitur në datën dhe orën e përcaktuar nga AK, për këtë arsye komisioni ka viiuar duke renditur të parin OE “AP”. Me procesverbalin me nr. 144/6 datë 20.01.2023 KPVV ka vijuar me njoftimin e fituesit të renditur në vendin e dytë pasi mostrat e sjella nga OE “AP” nuk i plotësonin kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë lidhur me origjinalitetin e mallit. Pas tërheqjes dhe skualifikimit të 7 OE (MM, BC, A, MO, EL, SRr, BB) pasqyruar rast pas rasti nëpërmjet procesverbaleve përkatëse me numrat 144/6, datë 20.01.2023, nr.144/7 datë 23.01.2023, nr.144/8, datë 24.01.2023, nr.144/9 datë 26.01.2023, nr.144/10, datë 26.01.2023, nr.144/11 datë 27.01.2023, 144/12 datë 30.01.2023, nr.144/13 datë 31.01.2023, nr.144/14 datë 01.02.2023, 144/15 datë 02.02.2023, Komisioni i vlerësimit të blerjeve të vogla ka kaluar tek operatori ekonomik i renditur në vendin e dhjetë “GjK” në vlerën 939,000 lekë.

OE i shpallur fitues “GjK” ka paraqitur dokumentacionin fizik administruar në KPK nëpërmjet postës. Komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga Y.SH, E.A, S.SH, ka mbajtur procesverbalin me nr. 144/16, datë 06.02.2023

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 42, datë 27.02.2023**, në vlerën prej **1,126,800 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 611/2023, datë 09.02.2023. Malli është bërë hyrje në magazinë me fletëhyrjen nr. 2.datë 09.02.2023.

2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve elektronike”, nr. REF-65359-04-07-2023, me fond limit 998,800 lekë pa TVSH.

Nëpërmjet shkresës nr. 1209 prot., datë 15.03.2023, E.A. (specialist IT) ka informuar Titullari i AK z. P.Q. mbi nevojën për riparim të pajisjeve elektronike (kompjuterëve, skanerëve, UPS, etj.), si më poshtë:

Nr.	Pajisja	Shërbimi	Njësia	Sasia
1	Fotokopje XeroxVersalink B7030	Profilaksi e plotë, zëvendësim i setit të gominave, transfer roller, feed roller assembly, seperation roller	Copë	11
2	Fotokopje Xerox Versalink B7030	Profilaksi e plot, riparim i sensoreve te letrës	Cope	3
3	Fotokopje Xerox Versalink B7030	Konfigurim dhe instalim në rrjeti fotokopjeve	copë	11
4	Fotokopje Xerox Versalink B7030	Riparim dhe pastrim i lazerit	Cope	5
5	Fotokopje Xerox Versalink B7030	Riparim dhe pastrim i skanerit	Cope	5
6	Fotokopje XeroxVersalink B7030	Riparim i garkut të ushqimit	Copë	4
7	Fotokopje XeroxVersalink B7030	Riparim i bordit	Copë	4
8	Fotokopje XeroxVersalink B7030	Ndërrim gominave ADF	Copë	10
9	Fotokopje XeroxVersalink B7030	Riparim i panelit të komandave	Copë	3
10	Fotokopje XeroxVersalink B7030	Profilaksi e plot, ndërrimi harddrive, firmware	Copë	3
11	Skaner Epson DS-1630	Profilaksi e plotë, zëvendësim i setit të gominave, transfer roller, feed roller assembly, seperation roller	Copë	12
12	Skaner Epson DS-1630	Zëvendësim motherboard	Copë	10
13	Skaner Epson DS-1630	Zëvendësim i llambës profilaksi e plot	Copë	6
14	Shërbim për kompjuter	Formatim, pastrim fizik/ ndërrim i pastës termike	Copë	60
15	Shërbim për kompjuter	Riparim i bllokut të ushqimit pastrim fizik	Copë	30
16	Shërbim për kompjuter Motherboard HP	(P/N 849959-602)	Copë	20
17	Shërbimi për kompjuter	Riparim ram 4GB DDR\$ 24 mgz DIMM PC4-1920 UDIMM Non -ECC	Copë	50
18	Shërbimi për kompjuter riparim	240GB 3D NAND 2.2 SATA III internal solid state Drive (SSD)	Copë	50

19	Shërbimi për kompjuter	DVD-RĒ serial-ATA Internal OEM optical drive DRĒ	Copë	5
20	Shërbimi për laptop	Formatim, pastrim fizik, ndërrim i pastës termike	Copë	10
21	Shërbimi për laptop	Riparim bord	Copë	5
22	Shërbimi për laptop	15.6 slim led LCD screen panel, fisha LVDS	Copë	5
23	Shërbim për laptop	Riparim bazë karikimi	Copë	5
24	Printer Lexmark CS417DN	Profilaksi e plotë	Copë	20
25	Printer lexmark CS417DN	Zevendesim i setit te gominave, feedroller, transfer roller	Copë	20
26	Printer lexmark CS417DN	Profilaksi e plot, riparim i portës USB	Copë	5
27	Printer lexmark CS417DN	Profilaksi e plot, riparim i qarkut të ushqimt	Copë	10
28	Kamera të brendshme, IR dome 3mp high resolution		Cope	6
29	Shërbim NVR 24, IP kanale up to 32-ch IP cameras input, third-party netëork cameras supported, ONVIF protokoll up to 5 megapilses resolution rekording		Copë	2
30	Shërbim kamera të brendshme, IRDome kamera 3MP 2.8 mm, 3MP high Resoluton, Hd real-Time video 3D Dnr&DWDR&BLC, IR Led s:up to 30m, IP 66, Vandal, proof, PoE		Copë	16
31	Shërbim kamer të brendshme me audio, VIDEO STANDARD ntsc/PAL IR Dome kamera 4 MP Hight Resolution, HD real time Video, Lens 2.8 mm		Copë	8
32	Shërbim kaera të jashtme, IR Bullet kamera 3MP, VF Lens 2.8-12mm, 3megapixel hight resolution		Copë	17
33	Shërbim kamera PTZ		Copë	2

Nëpërmjet memos me nr. 1209/1 prot., datë 15.03.2023, Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, i përbërë nga A.P, G.H, D.J, ka hartuar relacionin për specifikimet teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit, sikurse cituar bazuar në 3 oferta (IP, SS, E.AM), në vlerën prej 998,800 lekë pa TVSH. Titullari i AK P.Q. ka miratuar urdhrin e prokurimit nr. 53, datë 07.04.2023, sipas përcaktimit në kërkesë, protokolluar me nr.1542 datë 07.04.2023.

Në këtë dokument janë përcaktuar për kapacitetin teknik:

Për sigurimin e cilësisë së produkteve që prokurohet dhe mbarëvajtjes së punës kërkohet që operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certifikatat e mëposhtme:

- a) ISO 9001:2015 Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë;
- b) ISO 27001:2013 Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit;
- c) ISO 20000-1:2011 Teknologjinë e Informacionit- Menaxhimi Shërbimit;
- d) ISO 14001:2015 Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit;
- e)ISO 45001:2018 Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë;
- f)Bs PAS 99:2012 Për sistemin e menaxhimit të integruar;

Të paktën 1 Ing. Elektronik të diplomuar në Ing. Elektronike/Informatikë, i punësuar me kontratë pune dhe i deklaruar në sigurimet shoqërore;

Të paktën 1 Specialist në Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK) i punësuar dhe i deklaruar në sigurimet shoqërore.

Certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akredituese të njohura nga Republika e Shqipërisë, origjinale ose të noterizuara.

Në asnjë rast, komisioni i blerjeve të vogla nuk rezulton të ketë argumentuar kriteret e vendosura. Grupi i auditimit vlerëson se këto kriteret nuk janë të paargumentuar teknikisht.

Titullari i KPK PQ ka miratuar ftesën për ofertë nr.1542/1 prot., datë 07.04.2023, ku përcaktohen specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit. Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka hartuar procesverbalin nr. 1542/2 prot., datë 11.04.2023, ku ka pasqyruar ecurinë e procedurës së prokurimit dhe ka shpallur fitues operatorin "SRr" bazuar në kriterin e çmimit më të ulët. Bazuar në shkresat me nr. 1542/3 prot., datë 11.04.2023 dhe me nr. 1542/4 prot., datë 12.04.2023 Komisioni pas tërheqjes së 2 OE, me shkresën nr. 1542/5 datë 13.04.2023 ka shpallur fitues OE "E.H", me ofertë ekonomike 834,000 lekë pa TVSH. OE i shpallur fitues "E.H" ka paraqitur dokumentacionin fizik administruar në KPK pa protokoll.

Ndërmjet KPK dhe OE fitues është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 1542/7 datë 18.04.2023. Për këtë kontratë, për secilin shërbim të kryer është mbajtur procesverbal (i pa protokolluar) ndërmjet specialistit të IT dhe OE fitues, në bazë të të cilit janë kryer pagesat përkatëse.

Me shkresën 1542/8 datë 15.12.2023 Komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga S.SH, E.A dhe Y.SH konfirmon kryerjen e shërbimeve.

Likuidimi i shërbimit është kryer me urdhër shpenzimin nr.154 datë 13.07.2023 në shumën 407,400 lekë, bazuar në procesverbalet për riparimin e pajisjeve elektronike në KPK të mbajtur ndërmjet specialistes së IT E.A dhe OE në datat 19-20-24-27-28 prill 2023; 02-03-08-16-17-29-30 maj 2023; 05-07-12-13-15-19-22-23 qershor 2023 për faturën me nr.88/2023 datë 30.06.2023 dhe urdhër shpenzimin nr. 329 datë 27.12.2023 në shumën 593,400 lekë bazuar në procesverbalet për riparimin e pajisjeve elektronike në KPK të mbajtur ndërmjet specialistes së IT, E.A dhe OE në datat 07-12-15-19-29.09.2023; 11-18-20-26-26-30-31.10.2023; 01-02-03-10-16.11.2023; 01-04-07-10-12-13-14.12.2023.

Likuidimi i OE është kryer nëpërmjet urdhër shpenzimit me nr. 330 datë 27.12.2023 për likuidim shpenzimesh për riparim fotokopjesh në shumën 220,800 lekë.

3. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje materiale kancelarie”, nr. REF-57015-01-26-2023, me fond limit 999,911 lekë pa TVSH.

Komisioni i prokurimit publik me vlerë të vogël i përbërë nga A.P, D.J, D.S, nëpërmjet shkresës me nr. 292 datë 25.01.2023 drejtuar kryetarit të KPK shprehet se bazuar në nevojat e institucionit dhe duke pasur në konsideratë gjendjen e magazinës është i domosdoshëm zhvillimi i procedurës së prokurimit “Blerje materiale kancelarie” për 61 artikujt kancelarie.

Titullari i AK PQ ka miratuar urdhrin e prokurimit nr. 10, datë 25.01.2023, sipas përcaktimit në kërkesë protokolluar me nr.292/1, datë 25.01.2023.

Nëpërmjet shkresës nr. 292/2, datë 25.01.2023, Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, i përbërë nga A.P, D.J, D.S, ka hartuar relacionin për përllogaritjen e fondit limit, sikurse cituar bazuar në 3 oferta, në vlerën mesatare të përllogaritur prej 999,911 lekë pa TVSH.

Sekretari i Përgjithshëm i KPK ka miratuar ftesën për ofertë nr. 292/3 prot., datë 25.01.2023, ku përcaktohen specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit.

Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka hartuar procesverbalin nr. 292/4 prot., datë 27.01.2023, ku ka pasqyruar ecurinë e procedurës së prokurimit dhe ka shpallur fitues operatorin “M&D” bazuar në kriterin e çmimit më të ulët. Komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur me urdhrin nr.5, datë 01.02.2023, i përbërë nga E.A, Y.SH dhe S.SH, ka hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim me nr.292/5, datë 01.02.2023

Likuidimi i faturave është kryer me urdhër shpenzimin nr. 40 datë 22.02.2023 në shumën 785,760 lekë, me urdhër shpenzimin nr. 102 datë 12.05.2023 në shumën 68,160 lekë, me urdhër shpenzimin nr. 241 datë 13.09.2023 në shumën 34,080 lekë. Fletëhyrje në magazinë 1/1;1/2;1/3;1/4 datë 01.02.2023 dhe nr.25, datë 11.09.2023.

4. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje materiale pastrimi dhe higjeno sanitare”, nr. REF-57286-01-27-2023, me fond limit 499,823 lekë pa TVSH.

Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje materiale pastrimi dhe higjeno sanitare 2023”, nr. REF-57286-01-27-2023, me fond limit 499,823 lekë pa TVSH.

Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël nëpërmjet memos me nr. 339 datë 27.01.2023 drejtuar kryetarit të KPK ka hartuar kërkesën për blerje *materiale pastrimi dhe higjeno sanitare* për nevoja të institucionit, sipas parashikimeve të nevojave të pasqyruara në regjistrin e vitit 2023. Titullari i AK PQ ka miratuar Urdhrin e Prokurimit nr.12, datë 27.01.2023, për procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës “Blerje materiale për pastrim”.

Me shkresën nr.339/2 prot., datë 27.01.2023 Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, ka hartuar duke përcaktuar dhe sasinë dhe llojin e artikullit, procesverbalin për përllogaritjen e fondin limit për procedurën e prokurimit me objekt prokurimi “Blerje materiale për pastrim”, ku citohet se fondi limit është 499,823 lekë pa TVSH, i përllogaritur bazuar në çmimet e tregut bazuar në tre oferta duke marrë oferta nga Operatorët Ekonomikë: M.V, XH-N-SH, B (bashkëlidhur procesverbalit).

Sekretari i Përgjithshëm i KPK EV ka miratuar ftesën për ofertë nr. 339/3 prot., datë 27.01.2023, ku pasqyrohen specifikimet teknike të mallrave, sasia dhe afati i dorëzimit të mallit.

Komisioni i Procedurave me vlerë të vogël ka mbajtur procesverbalin me nr. 339/4 datë 30.01.2023 ku bazuar në kriterin e çmimit më të ulët ka shpallur fitues OE “BK”, me ofertë ekonomike 308.000 lekë pa TVSH. OE ka paraqitur dokumentacionin fizik, pa u administruar në KPK me nr. protokolli.

Komisioni i marrjes në dorëzim, i përbërë nga E.A, Y.SH, S.SH, ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave me procesverbalin me nr. 339/7 datë 13.02.2023.

OE është likuiduar nëpërmjet Urdhër-shpenzimit nr. 41, datë 22.02.2023, në vlerën prej 399,600 lekë, bazuar në faturën tatimore të shitjes nr.8/2023 datë 14.02.2023. Mallrave u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 3, datë 14.02.2023.

5. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Shërbim pastrimi dhe mirëmbajtje për sistemin e kondicionimit”, nr. REF-88673-11-22-2023, me fond limit 86,000 lekë pa TVSH.

Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Shërbim pastrimi dhe mirëmbajtje për sistemin e kondicionimit”, nr. REF-88673-11-22-2023, me fond limit 86,000 lekë pa TVSH.

Punonjësi i mirëmbajtjes z. A.K, nëpërmjet memos me nr. 4567 datë 22.11.2023 drejtuar kryetarit të KPK ka parashtruar kërkesën për zëvendësimin e tri paketave elektronike me qëllim funksionimin e kondicionerëve të cilët janë konstatuar që janë jashtë funksioni.

Titullari i AK EV ka miratuar Urdhër e Prokurimit nr.122, datë 22.11.2023, për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim pastrimi për sistemin e kondicionimit” për kondicionerin “General AUXB18GALH”.

Titullari i AK EV me shkresën nr.4567/1 prot., datë 22.11.2023 ka miratuar ftesën për ofertë ku pasqyrohen specifikimet teknike të mallrave, sasia dhe afati i kryerjes së shërbimit.

Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël, ka mbajtur në datë 20.11.2023 (2 dite para se të lindte nevoja për prokurim) procesverbalin pa numër protokolli të firmosur vetëm nga dy anëtar GH dhe DJ, ku citohet se fondi limit është përcaktuar duke patur parasysh ofertën e firmës Klimateknika në vlerën 85,700 lekë pa TVSH, (7 ditë para se të lindte nevoja) e cila është e vetmja që ofron shërbim për kondicionerët e markës General. Në këtë procesverbal sqarohet se fondi limit nuk është mundur të përlogaritet bazuar në çmimin e tregut, pasi pesë kompani të listuara (A, B, O., D, P. K, D.) të cilat kryejnë veprimtarinë e riparimit dhe shërbimit të kondicionerëve janë kontaktuar për të marr ofertat e tyre, por asnjëra prej tyre nuk ka paraqitur oferte pasi nuk e ofronin këtë shërbim për kondicionerët e markës GENERAL.

Komisioni i Procedurave me vlerë të vogël i përbërë nga znj. A.P, znj. G.H. dhe znj. D.J, ka hartuar procesverbalin me nr. 4567/3 prot., datë 23.11.2023 për procedurën e prokurimit me objekt prokurimi “Shërbim pastrimi dhe mirëmbajtje për sistemin e kondicionimit” e hapur në datë 23.11.2023. Për këtë objekt prokurimi kanë ofertuar 11 subjekte, 10 nga të cilët KVO i ka s kualifikuar për shkak se kanë ofertuar vlerë më të lartë se fondi limit dhe ka kualifikuar OE “Klima Teknika” të renditur të parin me fond limit në vlerën 86,000 lekë. Me procesverbalin me nr. 4567/4 datë 24.11.2023 KVO “Procesverbal fituesi” ka verifikuar dokumentacionin ligjor të administruar nga OE i shpallur i pari në të cilin nuk ka konstatuar mangësi dhe e ka shpallur fitues OE “KT”.

OE ka paraqitur dokumentacionin fizik, pa u administruar në KPK me nr. protokolli.

Komisioni i marrjes në dorëzim, i përbërë nga E.A, Y.SH, S.SH, ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave me procesverbalin me nr. 4567/5 datë 12.12.2023. OE është likuiduar nëpërmjet Urdhër-shpenzimit nr. 318, datë 15.12.2023, në vlerën prej 101,520 lekë, bazuar në faturën tatimore të shitjes nr.2775/2023 datë 12.12.2023.

6. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës”, nr. REF-83088-10-10-2023, me fond limit 691,167 lekë pa TVSH.

Nëpërmjet memos me nr. 4029 datë 03.10.2023 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, specialistja e IT, E.A, ka parashtruar kërkesën për fillimin e procedurës për pjesë ndërrimi për fotokopjet të cilat kanë shfaqur probleme, disi më poshtë:

Xerox B7030Versal Link Black			
	Part Installed	Nr. kopjeve	Sasia
Drum Cartrige	113R00779	80.000	12
Fuser R8	115R00115	100.000	5
Transfer Roller R7	115R00116	200.000	5

Përlllogaritja e fondit limit është bërë duke përcaktuar dhe sasinë dhe llojin e artikullit nga 2 nga anëtarët e Komisionit të Prokurimit me vlerë të vogël, D.J dhe G.H, nëpërmjet testimit të tregut duke marr oferta nga tre operatorë ekonomik “IP” “EA M” dhe “SS” (bashkëlidhur procesverbalit), përlllogaritur në vlerën 691,167 lekë.

Titullari i AK z. E.V, ka miratuar Urdhrin e Prokurimit nr.109, datë 10.10.2023, për procedurën e prokurimit me objekt “Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës” ku pasqyrohen specifikimet teknike dhe sasia e mallrave.

Ftesa për ofertë është miratuar nga Titullari i AK me shkresën me nr.4029/1 prot., datë 10.10.2023 ku është përcaktuar edhe dokumentacioni ligjor, kapaciteti teknik dhe specifikimet teknike të mallrave në të cilin ka kërkuar tre certifikata ISO pa e argumentuar teknikisht nevojën.

Komisioni i Procedurave me vlerë të vogël ka mbajtur procesverbalin me nr. 4029/3 datë 11.10.2023 ku bazuar në kriterin e çmimit më të ulët ka renditur të parin OE “A”, me ofertë ekonomike 395.000 lekë pa TVSH.

OE nuk ka paraqitur dokumentacionin për këtë arsye me shkresën me nr. 4029/4 datë 12.10.2023 nga KVO është mbajtur procesverbal për kalimin tek operatori radhës “AD” me fond limit 416,667 lekë pa TVSH. Me procesverbalim me nr 4029/5 datë 16.10.2023 është kaluar të operatori i radhës “IO” me vlerë 437,000 lekë pa TVSH. Me shkresën me nr. 4029/6 datë 17.10.2023 është mbajtur një procesverbal i dorëzimit të mostrave nga KVO dhe specialistit të IT në prani të përfaqësuesit të OE fitues.

Komisioni i marrjes në dorëzim, i përbërë nga E.A, Y.SH, S.SH, ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave me procesverbalin me nr. 4029/7 datë 23.10.2023

OE është likuiduar nëpërmjet Urdhër-shpenzimit nr. 295, datë 22.11.2023, në vlerën prej 524,400 lekë, bazuar në faturën tatimore të shitjes nr.14970/2023 datë 23.10.2023. Mallrave u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 31, datë 23.10.2023.

7. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Riparim fotokopjesh”, nr. REF-88232-11-20-2023, me fond limit 260,000 lekë pa TVSH. (nën zërin materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës)

Nëpërmjet memos me nr. 4535 datë 17.11.2023 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, specialistja e IT, E.A, ka parashtruar kërkesën për fillimin e procedurës për pjesë ndërrimi për fotokopjet të cilat kanë shfaqur probleme.

Përlllogaritja e fondit limit është bërë bazuar në ofertat e ardhura nga tre operatore ekonomik IT duke përcaktuar dhe sasinë dhe llojin e artikullit nga 2 prej anëtareve të Komisionit të Prokurimit me vlerë të vogël, DJ dhe GH nëpërmjet testimit të tregut duke marr oferta nga tre operatorë ekonomik “IP” “EA M” dhe “SS” (bashkëlidhur procesverbalit), përlllogaritur në vlerën 260,000 lekë.

Titullari i AK z. E.V. ka miratuar Urdhrin e Prokurimit nr.4535/2, datë 17.11.2023, për procedurën e prokurimit me objekt “Riparim fotokopje” ku pasqyrohen specifikimet teknike dhe sasia e mallrave.

Ftesa për ofertë është miratuar nga Titullari i AK me shkresën me nr. 4535/1 prot., datë 17.11.2023 ku është përcaktuar edhe dokumentacioni ligjor, kapaciteti teknik dhe specifikimet teknike të mallrave.

Komisioni i Procedurave me vlerë të vogël ka mbajtur procesverbalin me nr. 4535/3 datë 21.11.2023 ku bazuar në kriterin e çmimit më të ulët ka renditur të parin OE “AD”, me ofertë ekonomike 150.000 lekë pa TVSH.

OE nuk ka paraqitur dokumentacionin për këtë arsye me shkresën me nr. 4535/4 datë 22.11.2023 nga KVO është mbajtur procesverbal për skualifikimin e këtij operatori dhe kalimin tek operatori radhës “Jupiter on line trade” me fond limit 166,667 lekë pa TVSH.

Me procesverbalin me nr. 4535/5 datë 23.11.2023 është skualifikuar “Jupiter on line trade” dhe merr njoftim fituesi OE i tretë “E.H” me fond limit 184,000 lekë. OE ka sjellë dokumentacionin sipas ftesës për ofertë ku AK e vlerëson fitues. Me shkresën me nr. 4535/6 datë 24.11.2023 është mbajtur nga KVO një procesverbal fituesi.

Komisioni i marrjes në dorëzim, i përbërë nga E.A, Y.SH, S.SH, ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave me procesverbalin me nr. 4535/7 datë 30.11.2023.

OE është likuiduar nëpërmjet Urdhër-shpenzimit nr.330, datë 27.12.2023, në vlerën prej 220,800 lekë, bazuar në faturën tatimore të shitjes nr.220/2023 datë 20.12.2023. Mallrave u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 38, datë 20.12.2023.

- Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave/punëve dhe shërbimeve.

Për viti 2023

Zbatimi i kontratës me objekt Loti 3 “Sigurim shëndeti për familjarët e komisionerëve, këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor dhe stafin administrativ të KPK”

Nëpërmjet shkresës nr. 1850 prot., datë 28.04.2023, Sekretari i Përgjithshëm i KPK ka vendosur ngritjen e grupit të punës për hartimin e termave të referencës për sigurimin e jetës dhe/ ose shëndetit për KPK-në. Nëpërmjet Urdhrit të Prokurimit nr. 61, datë 28.04.2023, Kryetari i KPK ka caktuar anëtarët e grupit të punës për hartimin e termave të referencës së prokurimit, të përbërë nga A.P., G.H, D.J. Komisioni ka hartuar procesverbalin nr. 1850/2 prot., datë 16.05.2023, ku është përcaktuar se numri i personave që duhen siguruar, sa i përket familjarëve të anëtarëve të KPK, këshilltarëve dhe stafit administrativ, konsiston në 32 familjarë, 36 këshilltarë (32 aktual + 4 vende vakante) dhe 28 punonjës administrativ, në total 96 persona. Sa i përket fondit limit, grupi i punës ka marrë për referencë mesataren aritmetike të vlerave të kontratave të realizuara të vitit 2021 – 2022, duke përcaktuar fondin limit prej 6,484,818.24 lekë për Lotin 3 “Sigurim shëndeti për familjarët e komisionerëve, këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor dhe stafin administrativ të KPK”. Nëpërmjet shkresës nr. 1850/4 prot., datë 16.05.2023, grupi i punës ka paraqitur për miratim nga Sekretari i Përgjithshëm i KPK tabelat e përfitimeve lidhur me hartimin e specifikimeve teknike dhe termave të referencës.

Nëpërmjet Vendimit nr. 24, datë 25.05.2023, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur kryerjen e sigurimit të jetës dhe shëndetit të anëtarëve, familjarëve të tyre, si dhe stafit administrativ të KPK, në mbështetje të nenit 25 të ligjit nr. 84/2016.

Nëpërmjet shkresës nr. 1850/5 prot., datë 26.05.2023, Sekretari i Përgjithshëm i KPK ka dërguar kërkesën për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Shpenzime për siguracionin e jetës dhe/ ose shëndetit për KPK”. Nëpërmjet shkresës nr. 1850/7 prot., datë 13.06.2023, Sekretari i Përgjithshëm i KPK ka dërguar drejt AShPP termat e referencës dhe specifikimet teknike, tabelën dhe kontratat e vitit 2022.

Nëpërmjet shkresës administruar në KPK me nr. 1850/9 prot., datë 16.08.2023, Drejtori i Përgjithshëm i AShPP ka dërguar njoftimin për lidhje kontrate për Lotin 3 me OE “SVIG”, me ofertë ekonomike 6,336,000 lekë pa TVSH.

Ndërmjet KPK dhe OE është lidhur kontrata e blerjes së shërbimit nr. 1850/23 prot., datë 26.10.2023, me afat 12 muaj, me vlerë totale 6,336,000 lekë. Në Aneksin nr. 1 janë paraqitur listat e personave të siguruar, ku ndër të tjera përfshihen 4 vakanca në pikën 1.2 “Këshilltarët e Nj. Ligjore”, me nr. rendorë 33-36 dhe 1 vakancë në pikën 1.3 “Stafi administrativ”, me nr. rendor 28, në total 5 vende vakante.

Nëpërmjet Vendimit nr. 55, datë 16.10.2023, Kryetari i KPK ka vendosur miratimin e kontratës për Lotin 3 “Sigurimi i shëndetit për familjarët e tyre, si dhe për stafin administrativ të KPK-së”, për vitin 2023, me afat 12 muaj.

Nëpërmjet PV nr. 1850/26-1, datë 30.10.2023, Komisioni i marrjes në dorëzim, i përbërë nga SSH, E.A, YSH ka dokumentuar marrjen në dorëzim të kartave të sigurimit të shëndetit për familjarët e anëtarëve të KPK (gjithsej 32 persona), stafin administrativ (gjithsej 27 persona dhe 1 vakancë) dhe këshilltarët e njësisë ligjore (gjithsej 32 persona dhe 4 vakanca), në total 91 persona dhe 5 vakanca (gjithsej 96 persona).

Nëpërmjet shkresës nr. 1850/32 prot., datë 14.11.2023, Sekretari i Përgjithshëm i KPK ka dërguar aplikimet për sigurimin e shëndetit për personat që kanë hyrë për herë të parë në skemën e sigurimit dhe për ata që nuk e kanë plotësuar nga viti i mëparshëm, gjithsej 13 persona, duke bashkëlidhur listën emërore të personave.

Nëpërmjet PV nr. 1850/33 prot., datë 14.11.2023, Komisioni i marrjes në dorëzim ka dokumentuar marrjen në dorëzim të kartave të shëndetit për 2 punonjës, 1 për të cilin duhej saktësuar mbiemri dhe 1 që nuk e ka plotësuar nga viti i mëparshëm.

Komisioni i marrjes në dorëzim ka dokumentuar marrjen në dorëzim të kartave të sigurimit të shëndetit për plotësimin e 5 vakancave me punonjësit e shtuar në skemën e sigurimit, si më poshtë:

- Nëpërmjet PV nr. 110/3 prot., datë 02.02.2024, për 2 punonjës;
- Nëpërmjet PV nr. 1120 prot., datë 22.04.2024, për 1 punonjës;
- Nëpërmjet PV nr. 697 prot., datë 05.03.2024, për 1 punonjës;
- Nëpërmjet PV nr. 2135 prot., datë 21.10.2024, për 1 punonjës.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 269, datë 31.10.2023**, në vlerën prej **6,336,000 lekë**, bazuar në faturën elektronike nr. 2023430167/2023, datë 27.10.2023.

Për vitin 2024 (periudhën objekt auditimi)

Me urdhrin nr. 91, datë 25.07.2023 Kryetari i KPK z. R.I. ka deleguar kompetencat tek z. E.V. si Titullar i AK.

Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël ka patur në përbërje, si më poshtë:

Sipas Urdhrit nr.3, datë 09.01.2024: A.P, kryetar, D.S, D.J.

Sipas Urdhrit nr.38, datë 09.04.2024, D.J, zëvendësohet me E.D.

Komisioni i marrjes në dorëzim ka patur në përbërje, si më poshtë:

Sipas Urdhrit nr. 5, datë 09.01.2024: Y.SH, S.SH, E.A.

Sipas Urdhrit nr. 14, datë 16.01.2024: E.A. zëvendësohet me D. A.

Sipas Urdhrit nr. 73, datë 04.10.2024: D. A. zëvendësohet me N. P.

Sipas Urdhrit nr. 78, datë 30.10.2024: S.SH. (Sh) zëvendësohet me D.J.

Procedurat e prokurimit për vitin 2024 për KPK rezultojnë, si më poshtë:

Lloji i procedurës	Nr.	Vlera totale e kontraktuar (lekë pa TVSH)
Procedurë e hapur		
Kërkesë për propozim		
Blerje me vlerë të vogël	6	1,764,148.50
Blerje shkresore (nën 100,000 ALL)	6	399,655
Blerje bileta		
TOTALI	12	2,163,803.50

Burimi: Drejtoria Ekonomike në KPK, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.

KPK ka zhvilluar 12 procedura me objekt blerje mallra dhe kryerje shërbimesh, nga të cilat 6 procedura prokurimi me vlerë të vogël dhe 6 blerje nën vlerën 100,000 lekë.

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje materiale kancelarie 2024”, nr. REF-94368-02-02-2024, me fond limit 753,913 lekë pa TVSH.

Nëpërmjet Memos me nr. 301 datë 01.02.2024 KPV të vogël drejtuar Titullarit të Autoritetit kontraktor E. V. ka parashtruar kërkesën për blerjen e materialeve të kancelarive. Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël ka hartuar procesverbalin nr. 301/1 prot., datë 01.02.2024, mbi specifikimet teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për objektin e prokurimit “**Blerje materiale kancelarie**” për 47 artikuj, ku citohet se bazuar në tre oferta të marra fondi limit është përlllogaritur në vlerën 993.806 lekë pa TVSH. Në vijim të procesverbalit të datës 30.01.2024, Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël ka hartuar një tjetër procesverbal në datë 31.01.2024 (*i paprotokolluar*), për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit, sipas këtij procesverbali dhe bazuar në konsulencën e specialistit IT janë rishikuar disa artikuj të cilët nevojiten më cilësor dhe me kapacitet më të lartë mbajtës, duke hequr 3 artikuj nga lista prej 47 artikujve dhe duke i kaluar ato në procedurën e prokurimit me objekt “Materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës”. Fondi limit i ri i përcaktuar për 44 artikuj është në vlerën prej 753.913 lekë, vlerë me të cilën është vijuar me prokurimin në SPE.

Titullari i AK EV ka miratuar Urdhrin e Prokurimit nr.20, datë 01.02.2024, për procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës. Sekretari i Përgjithshëm i KPK Edmond Veçani ka miratuar ftesën për ofertë nr. 301/3 prot., datë 01.02.2024, ku pasqyrohen specifikimet teknike të mallrave, sasia dhe afati i dorëzimit të mallit.

Komisioni i Procedurave me vlerë të vogël bazuar në kriterin e çmimit më të ulët ka shpallur fitues OE “IO”, me ofertë ekonomike 561.000 lekë pa TVSH. O.E ka paraqitur dokumentacionin fizik, i cili administrohet në dosje, por nuk ka praktikë hyrëse në institucion. Komisioni i marrjes në dorëzim ka dokumentuar marrjen në dorëzim të mallrave me shkresën me nr. 301/5 datë 13.02.2024. Mallrave u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet fletë-hyrjes nr. 2, datë 13.02.2024.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 47, datë 05.03.2024**, në vlerën prej **673,200 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes nr.2266/2024.

2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje tonerash për fotokopje”, nr. REF-99441-03-27-2024, me fond limit 274,470 lekë pa TVSH.

Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël ka hartuar kërkesën nr. 879 prot., datë 27.03.2024, për blerje “Bojë për Fotokopje” për nevoja të institucionit, sipas parashikimeve të nevojave të pasqyruara në regjistrin e vitit 2024 (*bashkëlidhur memos*). Me shkresën nr. 879/1 prot., datë 27.03.2024, KPVV ka hartuar procesverbalin për përlllogaritjen e fondit limit duke përcaktuar fondin limit në vlerën 274.470 lekë pa TVSH bazuar në 3 oferta, si dhe duke përcaktuar sasinë dhe llojin e artikullit. Titullari i AK E.V. ka miratuar Urdhrit e prokurimit nr.34, datë 27.03.2024, sipas kërkesës së komisionit. Ftesa për ofertë është miratuar me shkresën e Titullari i AK me nr. 879/3 datë 27.03.2024. Në ftesën për ofertë, përcaktohen specifikimet teknike të mallit. Në këtë dokument janë paraqitur edhe kriteret e kualifikimit, ku ndër të tjera kërkohet që OE të paraqesë certifikatat ISO 9001:2015 (*ose ekuivalente të vlefshme*) të sistemit të menaxhimit të cilësisë. KBV nuk ka argumentuar teknikisht këtë kriter të vendosur, në mospërputhje me nenin 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021. Nga KBV është mbajtur procesverbal për hapjen dhe vlerësimin e ofertave me nr. 879/4 prot., datë 28.03.2024. Operatorët ekonomik pjesëmarrës janë 21 nga të cilët 14 janë skualifikuar me motivacionin e ofertimit me vlerë më të lartë se fondi limit.

Pas tërheqjes së 2 OE, evidencuar në shkresën nr. 879/5 prot., datë 02.04.2024 dhe nr. 879/6 prot., datë 03.04.2024, KBV ka shpallur fitues OE “K” me ofertë ekonomike në vlerën 219,000

lekë pa TVSH. Komisioni i marrjes në dorëzim ka mbajtur procesverbalin me nr. 879/7 datë 08.04.2024 i cili konfirmon marrjen në dorëzim sipas listës dhe sasive të kërkuara.

OE “K” është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr.84, datë 29.04.2024**, në vlerën prej **262,800 lekë**, bazuar në Faturën tatimore të shitjes nr. 829/2024 datë 08.04.2024. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet Fletë-hyrjes nr.05.datë 08.04.2024.

3. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës”, nr. REF-96572-02-27-2024, me fond limit 418,333 lekë pa TVSH.

Nëpërmjet shkresës me nr. 605 prot., datë 27.02.2024, KPVV drejtuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor z. E.V. është njoftuar nevoja për fillimin e procedurës “Blerje USB, DVD, External portable DVD drive” nën zërin “Blerje material për funksionimin e pajisjeve të zyrës” bazuar në gjendjen e magazinë dhe për nevojat e institucionit.

Nëpërmjet shkresës nr. 605/1 prot., datë 27.02.2024, Komisioni i Blerjeve të Vogla ka kryer duke përcaktuar gjithashtu specifikimet teknike të shërbimit, përllogaritjen e fondit limit bazuar sikurse cituar në 3 oferta, në vlerën prej 418,333 lekë pa TVSH.

Titullari i AK EV ka miratuar Urdhrin e Prokurimit nr.29, datë 27.02.2024, për realizimin e procedurës duke përcaktuar zërat, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi/ përshkrimi	Njësia	Sasia
1	DVD-R 16x 4.7 GB	Copë	1000
2	UUB 128 GB 3.2 (madhësi standarde e USB)	Copë	100
3	USB 16 GB 3.0 (madhësi standarde e US)	Copë	50
4	External portable DVD drive USB 3.0 Portable +/- RW Slim për leximin dhe shkrimin e CD/DVD	Copë	10

Sekretari i Përgjithshëm E.V. ka miratuar ftesën për ofertë nr. 605/3 prot., datë 27.02.2024, ku janë përcaktuar edhe kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike të mallit. Komisioni i Blerjeve të Vogla ka hartuar procesverbalin për hapjen dhe vlerësimin e ofertave me nr.605/4 prot., datë 28.02.2024, ku ka pasqyruar ecurinë e procedurës së prokurimit dhe bazuar në kriterin çmimin më të ulët ka renditur në vend të parë “IO” në vlerën 209,166 lek pa TVSH. OE “IO” ShPK i shpallur fitues, ka paraqitur dokumentacionin fizik, i cili administrohet në dosje, por nuk ka praktikë hyrëse në institucion. Komisioni i marrjes në dorëzim ka dokumentuar marrjen në dorëzim të pajisjeve, me shkresën me nr. 605/5 prot., datë 08.03.2024 duke cituar “sipas listës dhe sasive dhe nuk u konstatua asnjë mangësi”.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr. 48, datë 18.03.2024**, në vlerën prej **251,000 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes nr.3489/2024, datë 08.03.2024. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet fletëhyrjes numër 03.date 08.03.2024.

4. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Blerje SSD, sata cable, USB 3.0 docking dhe RAM 8GB DD R4-2400 Mhz ”, nr. REF-04126-05-09-2024, me fond limit 175,547 lekë pa TVSH.

Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël ka hartuar relacionin nr. 1255 prot., datë 09.05.2024, mbi nevojën për kryerjen e procedurës së prokurimit me objekt Blerje SSD, sata cable, USB 3.0 docking dhe RAM 8GB DD R4-2400 Mhz, bazuar në relacionin e datës 30.04.2024 të specialistit të IT, D. A. i cili konstaton problematika në kompjuterët e KPK-se (*bashkëlidhur relacioni i datës 30.04.2024*). Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël me shkresën me nr.1255/1 datë 09.05.2024 ka përllogaritur specifikimet teknike, sasinë, njësinë si dhe fondin limit në vlerën 175,547 lekë, bazuar në studimin e tregut me 3 OE. Nëpërmjet shkresës nr. 1255/2 prot., datë 09.05.2024, Titullari i AK, E.V. ka miratuar Urdhrin e Prokurimit nr.44, datë 09.05.2024, për procedurën e prokurimit me objekt sipas kërkesës.

Sekretari i Përgjithshëm i KPK ka miratuar ftesën për ofertë nr. 1255/3 prot., datë 09.05.2024, ku citohet ndër të tjera se “në momentin e furnizimit të mallrave, OE duhet ta shoqërojë atë me fletën e garancisë 1 vit nga data e lëvrimit të mallit”.

OE i renditur i pari duhet të paraqitet brenda 24 orëve nga shpallja e fituesit në sistem me dokumentacionin e kërkuar si dhe mostrat e produkteve.

KBV ka dokumentuar hapjen dhe vlerësimin e ofertave me shkresën nr. 1255/4 prot., datë 10.05.2024, ku ka pasqyruar ecurinë e procedurës së prokurimit dhe bazuar në kriterin çmimin më të ulët ka renditur në vend të parë “IO” në vlerën 115,000 lek pa TVSH. OE “IO” ka paraqitur dokumentacionin fizik, i cili administrohet në dosje, por nuk ka praktikë hyrëse në institucion. Nëpërmjet procesverbalit me nr. 1255/5 datë 13.05.2024 OE “IO”, ku citohet se “*OE depozitoi dokumentacionin fizik...*”, njoftohet se pasi depozitoi dokumentacionin dhe mostrat e kërkuara nga AK, rezultoi se produktet e kërkuara nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë, për këtë arsye AK vendosi njoftimin e operatorit të rradhës. Në dosje nuk administrohet dokumentacioni fizik i paraqitur (dhe nuk ka marrë numër rendor protokolli), si dhe nuk administrohet procesverbali mbi administrimin dhe vlerësimin e mostrës.

Pas tërheqjes së 2 OE të renditur i dyti dhe i treti, KBV ka kaluar të OE i renditur i katërti “E.H”, me ofertë ekonomike 134,000 lekë pa TVSH, dokumentuar me nr. 1255/7 prot., datë 15.05.2024. Nëpërmjet PV nr. 1255/8 prot., datë 16.05.2024, KBV ka skualifikuar OE “E.H”, pasi sikurse citohet “pasi depozitoi dokumentacionin dhe mostrat e kërkuara, rezultoi që një nga produktet nuk e kishin në gjendje në sasinë dhe specifikimet e kërkuara në ftesë për ofertë”. Në dosje nuk administrohet dokumentacioni fizik i paraqitur (dhe nuk ka marrë numër rendor protokolli), si dhe nuk administrohet procesverbali mbi administrimin dhe vlerësimin e mostrës.

Pavarësisht se Komisioni citon se ka kaluar një proces vlerësimi mostrash, nëpërmjet së cilit ka skualifikuar 2 OE, nuk rezulton të ketë dokumentuar rast pas rasti administrimin dhe procesin e vlerësimit të tyre, duke mos garantuar gjurmën e auditimit për 2 OE të skualifikuar, në mospërputhje me nenin 2, gërma ë), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

KBV ka kaluar te OE i renditur i pesti “IST” me ofertë ekonomike në vlerën 134,780 lekë pa TVSH. OE ka paraqitur dokumentacionin fizik, i cili administrohet në dosje, por nuk ka praktikë hyrëse në institucion.

Nëpërmjet procesverbalit me nr. 1255/9 datë 20.05.2024 të mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim janë marrë në dorëzim artikujt sipas kërkesës në ftesën për ofertë dhe nuk janë konstatuar mangësi.

OE është likuiduar nëpërmjet **Urdhër-shpenzimit nr.105, datë 24.05.2024**, në vlerën prej **161,736 lekë**, bazuar në faturën tatimore të shitjes nr.44/2024, datë 20.05.2024. Artikujve u është bërë hyrje në magazinë nëpërmjet fletëhyrjes nr. 07, datë 20.05.2024.

2.5 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit

Në zbatim të këtij drejtimi të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

1. Urdhër/ Vendime të Titullarit të AK;
2. Korrespondenca me Ministrinë përgjegjëse për financat;
3. Dokumentacion i brendshëm;
4. Çështje të dala gjatë trajtimit të drejtimeve të tjera të auditimit.

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit u realizua bazuar në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, Manualët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në fuqi përgjatë periudhës së auditimit, përkatësisht miratuar (i) me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 dhe (ii) me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 4, datë 26.01.2024, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të këtij Ligji. Sipas përcaktimeve të këtij Ligji, menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar

dhe kontrolluar, për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektivitet të shërbimeve publike.

Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues

Përgjatë periudhës së auditimit, pranë KPK, rezulton, si më poshtë:

Nëpërmjet shkresës nr. 512 prot., datë 22.11.2017, Kryetari i KPK ka caktuar Nëpunësin Autorizues G.T, dhe Nëpunësin Zbatues A.P. Nëpërmjet shkresës nr. 17127/1 prot., datë 05.12.2017, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ka konfirmuar Nëpunësin Zbatues A.P.

Nëpërmjet shkresës nr. 787 prot., datë 06.12.2018, Kryetari i KPK ka caktuar Sekretarin e Përgjithshëm të KPK R.C. si Nëpunës Autorizues. Nëpërmjet shkresës nr. 442 prot., datë 01.06.2018, Kryetari i KPK ka caktuar Nëpunësin Autorizues G.T. Nëpërmjet shkresës nr. 7431 prot., datë 01.11.2018, Kryetari i KPK ka përcaktuar Nëpunësin Autorizues G.M. Nëpërmjet Shkresës nr. 5235, Kryetari i KPK ka përcaktuar Nëpunësin Autorizues P.Q.

Nëpërmjet shkresës nr. 6847 prot., datë 20.10.2020, Kryetari i KPK ka caktuar Nëpunësin Autorizues E.V. Nëpërmjet shkresës nr.19735/1 prot., datë 27.10.2020, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ka konfirmuar Nëpunësin Autorizues E.V.

I. MJEDISI I KONTROLLIT

Ky komponent i kontrollit të brendshëm përshkruan kushtet bazë të nevojshme për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm kontrolli në një njësi të caktuar. Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të njësisë, filozofinë e drejtimit dhe stilin e punës, mënyrën sesi menaxhimi cakton përgjegjësi dhe të drejta dhe organizon e zhvillon stafin, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep niveli drejtues. Ky mjedis ndikohet më tej nga struktura organizative e njësisë dhe marrëdhëniet e llogaridhënies.

Integriteti dhe vlerat etike

Nëpërmjet Vendimit të mbledhjes së Komisionerëve nr.89, datë 25.11.2019, KPK ka miratuar Kodin Etik të personelit administrativ dhe të këshilltarëve të njësisë së shërbimit ligjor të KPK. Në këtë kod janë integruar parimet e përgjithshme të kryerjes së veprimtarisë nga ana e punonjësit të KPK, marrëdhëniet institucionale dhe ndër-institucionale, si dhe mekanizmat e mbikëqyrjes së respektimit të Kodit Etik.

Struktura organizative

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr. 82/2017, datë 17.06.2017, miratoi në bllok listën me 12 Komisionerë. Veprimtaria e Komisionit bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Me Vendimin nr. 100/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të KPK” u miratua struktura, organika dhe klasifikimi i pagave për KPK.

Me Vendimin nr. 83/2020 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, u miratua struktura, organika dhe klasifikimi i pagave në KPK, duke miratuar shtesë në organikë për 12 Këshilltarë të Njësisë së Shërbimit Ligjor.

Me Vendimin nr. 36/2020 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, u miratua struktura, organika dhe klasifikimi i pagave për KPK, ku numri total i punonjësve të përhershëm arriti në 76 punonjës. Me VKM nr. 56, datë 01.02.2023 KPK-së iu miratuan 8 punonjës me kontratë të përkohshme, me kohë të pjesshme.

Me këtë strukturë, KPK, gjatë vitit 2023, ka patur 12 Komisionerë, 1 Sekretar të Kryetarit, 24 Këshilltarë juristë, 12 këshilltarë ekonomikë, 1 Sekretar të Përgjithshëm, drejtoria e menaxhimit të çështjeve me 1 drejtor dhe 15 specialistë, si dhe drejtoria ekonomike dhe

shërbimeve mbështetëse, me 1 drejtor dhe 9 specialistë. Në total, numri i punonjësve të KPK-së gjatë 2023 ka qenë 76 punonjës, si dhe 8 punonjës me kontratë të përkohshme, me kohë të pjesshme.

Rregullorja e brendshme

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, nëpërmjet Vendimit nr. 11, datë 19.02.2018 të mbledhjes së Komisionerëve, ka miratuar Rregulloren “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit*”³, e ndryshuar nëpërmjet Vendimit nr.26, datë 28.06.2022 dhe Rregulloren e miratuar me vendimin nr.2, datë 19.7.2017 “*Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit*”⁴ e ndryshuar nëpërmjet vendimit nr.11, datë 4.3.2024. Në këtë rregullore janë përcaktuar dispozita të përgjithshme mbi misionin e KPK dhe parimet mbi të cilat mbështetet veprimtaria e administratës; struktura dhe veprimtaria e administratës, duke detajuar sipas njësive dhe pozicioneve specifike; rregulla të përgjithshme dhe të veçanta të punës, rregulla mbi çështjet disiplinore.

Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore

Politikat e burimeve njerëzore lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, duke përbërë një pjesë të rëndësishme të kontrollit të brendshëm. Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë, ndër të tjera, një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve, kriteret dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale, një sistem trajnimi dhe kualifikimi që synon t’i përgatisë punonjësit për kryerjen e detyrave, vlerësimin e performancës, si dhe zhvillimin e miratimit të politikave, rregullave dhe procedurave të zbatueshme, në harmoni me dispozitat ligjore të vlefshme për rekrutimin, emërimin, vlerësimin, trajnimin, shpërblimin dhe motivimin e stafit.

Në lidhje me rekrutimin dhe emërimin

Neni 22, pika 2, i Ligjit nr. 84/2016 “*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, përcakton se “*procesi i rekrutimit (sa i përket këshilltarëve ligjorë dhe ekonomikë) bazohet në një procedurë të hapur dhe transparente për përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga komiteti ad hoc i krijuar në institucionin përkatës*”. Në pikën 3 dhe 4 të kësaj dispozite përcaktohen kriteret minimale që kandidati duhet të plotësojë për të qenë *këshilltar ligjor* ose *këshilltar ekonomik* pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Neni 21 i këtij Ligji përcakton se Sekretari i Përgjithshëm ka detyrë, ndër të tjera, të rekrutojë punonjësit administrativë, sipas Kodit të Punës. Neni 17 i Rregullores së brendshme përcakton se Specialisti i burimeve njerëzore ndjek dhe zbaton procedurat ligjore, ndër të tjera, mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në lidhje me rekrutimin, vlerësimin e rezultateve në punë, menaxhimin e dosjeve të personelit, etj.

Për vitin 2019, 2020, 2021, 2022, 2023 është përcaktuar harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Sipas përshkrimeve të procesit, bazuar në Vendimin e Kuvendit Nr.100/2018, nr.100/2019, nr.83/2020, nr.36/2021, nr.36/2022, me fondet buxhetore për pagat e personelit të KPK për buxhetin e vitit 2019,2020,2021,2022,2023 nëpërmjet specialistes së burimeve njerëzore është vendosur për planin e rekrutimit për vitet 2019,2020,2021,2022,2023 dhe është urdhëruar fillimi i procedurave përkatëse të rekrutimit. Procedurat e rekrutimit përfshijnë të gjitha aktivitetet e ndryshme si: publikimet në faqen e KPK të vendeve vakante, dhe të QPZ, ndjekja e procedurave të parashikuara në ligjin 84/2016 “*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”⁵, Rregulloren “*Për veprimtarinë e*

³ Rregullorja “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës së KPK-së*”, miratuar me vendimin nr. 11, datë 19.08.2018, të ndryshuar (*këtej e tutje “**Rregullorja e brendshme**”)

⁴ Rregullorja “*Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit*”, miratuar me vendimin nr.2, datë 19.7.2017, të ndryshuar.

⁵ Ligjin 84/2016 “*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”.

Komisionit të Pavarur të Kualifikimit’’⁶ dhe Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së KPK’’⁷; Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë; organizimin e konkurseve nëpërmjet ndjekjes së fazave përkatëse, nga komiteti ad-hoc, i cili zgjidhet rast pas rasti, paraprake dhe fazës përfundimtare, përzgjedhjes; shpalljet e listës së fituesve (për Njësinë e Shërbimit Ligjor) në portalin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ndjekja e afateve kohore për shpalljen e fituesit ; emërimin e fituesve në vendet e zgjedhura prej tyre.

Në lidhje me trajnimet e punonjësve

Neni 27, pika 1, i Rregullores së brendshme përcakton se punonjësi i KPK u nënshtrohet trajnimeve, brenda dhe jashtë vendit, për kualifikime të mëtejshme në funksion të pozicionit të punës. Neni 17, pika 4, i rregullores së brendshme përcakton se specialisti i burimeve njerëzore, ndër të tjera, kujdeset për zhvillimin e karrierës së burimeve njerëzore nëpërmjet kualifikimeve, trajnimeve dhe zhvillimit të tyre.

Mbi bazën e vlerësimeve vjetore si dhe analizës së tyre dhe detyrave të realizuara ose jo, mbi bazën e të cilave janë vlerësuar me nivelet përkatëse stafi nga të cilët eprorët kanë dhënë arsyet e tyre të vlerësimit në bashkëpunim me drejtoritë hartohet plani i trajnimeve për vitin aktual, duke pasur parasysh strategjinë e trajnimeve të ASPA dhe institucioneve të tjera APP, DSIK etj., mbi bazën e temave të ofruara apo dhe të paraqitjes së kërkesave specifike në rast mundësie zhvillimi. Trajnimet janë kryer nga Ministria e Financës dhe e Ekonomisë lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollin; DSIK-ja, lidhur me sigurinë e informacionit të klasifikuar; ASPA, për prokurimet publike, menaxhim burimesh njerëzore.

Ka pasur trajnime për sa i përket hartimit të PBA-ve, çështjeve të ndryshme nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financës, ASPA.

II. MENAXHIMI I RISKUT

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen për arritjen e objektivave të vendosura.

Vendosja e objektivave

Objekti kryesor për krijimin e institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përcaktuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në Ligjin nr. 84/2016, është kryerja e procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Misioni i administratës së KPK, i përcaktuar në nenin 3 të Rregullores së brendshme, është kryerja e veprimeve në funksion të përmbushjes së qëllimit të Ligjit nr. 84/2016.

Regjistri i riskut

Institucioni i KPK ka miratuar periodikisht çdo vit regjistrin e riskut, si më poshtë:

- Për vitin 2019 me shkresën nr.998/3prot., datë 5.2.2019, miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm;
- Për vitin 2020 me shkresën nr.1416/5 prot, date 9.2.2021 Regjistri i Riskut miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm;
- Për vitin 2021 me shkresën nr.430/6prot, date 4.2.2022 Vlerësim i riskut për PBA 2023-2025 miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm;

⁶ Rregulloren “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” miratuar me vendimin nr. 2, datë 19.7.2017.

⁷ Rregulloren Për organizimin dhe funksionimin e administratës së KPK” miratuar me vendimin nr. Miratuar me vendimin nr. 11, datë 19.2.2018.

- Për vitin 2023, me shkresën nr.321/4prot, date 5.2.2024 Vlerësimi i Riskut për PBA 2024-2026 miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

III. AKTIVITETET E KONTROLLIT

Ndarja e detyrave

Struktura e KPK përbëhet nga 3 kategori punonjësish:

Sa i përket *Komisionerëve*, detyrat funksionale të tyre rrjedhin nga detyrimet kushtetuese e ligjore për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, si dhe përcaktohen në Kreun III të Ligjit nr. 84/2016.

Sa i përket *këshilltarëve ligjorë/ ekonomikë*, detyrat funksionale të tyre përcaktohen në nenin 23 të Ligjit nr. 84/2016.

Detyrat e *Sekretarit të Përgjithshëm të KPK* përcaktohen në nenin 21 të Ligjit nr. 84/2016, si dhe në Rregulloren e brendshme të KPK “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës së KPK*”, miratuar me Vendimin nr. 11, datë 19.02.2018, i ndryshuar. Sa i përket *punonjësve të administratës së KPK*, detyrat funksionale të tyre përcaktohen në Kreun II të Rregullores “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës së KPK*”, miratuar me Vendimin nr. 11, datë 19.02.2018, i ndryshuar.

a. Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël

Nga auditimi u konstatua se KPK ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Nga KPK është realizuar çdo vit procesi i inventarizimit, siç parashikohet në Paragrafi nr. 74, i UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

b. Regjistrat e parashikimit dhe te realizimit te procedurave te prokurimit

Grupi i auditimit, në zbatim të drejtimit të Programit të Auditimit mbi auditimin e procedurave të prokurimit publik, ka administruar regjistrat e realizimit për secilin prej viteve përgjatë periudhës së auditimit 2017 – 2024. Nga kryqëzimi i të dhënave me ditarin e bankës, grupi i auditimit ka konstatuar se jo të gjitha procedurat e prokurimit të kryera nga KPK ose për llogari të KPK nga organet qendrore blerëse janë pasqyruar në Regjistrin e realizimeve, në mospërputhje me pikën 8 të Udhëzimit të APP nr. 2, datë 27.01.2015 dhe Kreun II të Udhëzimit të APP nr. 04, datë 18.06.2021 (*trajtuar më hollësisht dhe rast pas rasti për vitet përkatëse në Akt-Konstatimet nr. 4, 5 dhe 6, datë 21.02.2025*).

c. Marrja në dorëzim e mallrave dhe shërbimeve

Grupi i auditimit, në zbatim të drejtimit të Programit të Auditimit mbi auditimin e procedurave të prokurimit publik, ka administruar ndër të tjera dokumentacionin e marrjes në dorëzim të mallrave e shërbimeve, të siguruara nëpërmjet procedurave të prokurimit publik.

Sa i përket marrjes në dorëzim të mallrave, nga auditimi u konstatuan parregullsi, që konsistojnë në mungesën e administrimit të dokumentacionit shoqërues, kur bëhej fjalë për pajisje (p.sh. kompjuter, laptop), si certifikatë origjine, certifikatë cilësie, që shërben si dokumentacion vërtetues mbi cilësinë e produkteve. (*trajtuar më hollësisht dhe rast pas rasti për vitet përkatëse në Akt-Konstatimet nr. 4, 5 dhe 6, datë 21.02.2025*).

Sa i përket marrjes në dorëzim të shërbimeve, nga auditimi u konstatuan parregullsi, që konsistojnë në mungesën e hartimit të procesverbalit të marrjes në dorëzim nga Komisioni i marrjes në dorëzim, si dhe hartimi i procesverbalit të marrjes në dorëzim vetëm nga specialisti IT dhe përfaqësuesi i OE, pra jo nga Komisioni i marrjes në dorëzim. (*trajtuar më hollësisht dhe rast pas rasti për vitet përkatëse në Akt-Konstatimet nr. nr. 5, 6 dhe 7, datë 21.02.2025*).

d. Procedurat për dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes personale të secilit punonjës, rezultoi se jo në çdo rast është administruar në dosjen personale procedura e rekrutimit.

- Nga auditimi rezultoi se sa i përket rekrutimit të punonjësve administrativë, nuk rezultoi që KPK të ketë hartuar një procedurë të shkruar, ku të jenë përcaktuar hapat dhe elementët proceduralë që do të ndiqen për këtë kategori punonjësish.

- Nga auditimi rezultoi se nuk ka një procedurë të shkruar dhe të miratuar (*rregullore, udhëzim*) “Për veprimtarinë e komitetit Ad Hoc për administrimin e procesit të emërimeve në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” të miratuar nga Mbledhja e Komisioneve në mbështetje të nenit 179/b e të aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 3, të nenit 69, pikës 3 dhe 4 të nenit 18, pikës 1, 2 të nenit 22 dhe germës dh) të nenit 21 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të pikës 1 të nenit 9 dhe të nenit 22 të rregullores për veprimtarinë e komisionit të pavarur të kualifikimit, si dhe në zbatim të përcaktimeve të Manualit Financiar dhe Kontrollit.

e. Procedurat e shkruara

Njësitë publike, për realizimin e objektivave duhet të organizojnë veprimtarinë jo vetëm bazuar në kuadrin ligjor, por edhe në procedura të brendshme të shkruara dhe të miratuara nga titullarët e tyre, duke synuar garantimin e uniformitetit në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve, përgjegjësitë, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen, së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave.

Nga auditimi nuk rezultoi që KPK të ketë miratuar një procedurë të shkruar në lidhje me rekrutimin e stafit administrativ, ku të përcaktohet qartazi mënyra e shpalljes dhe publikimit të vakancës, mënyra e testimit (verbal dhe/ ose me shkrim), afatet proceduralë të aplikimit, vlerësimit të aplikimeve, paraqitjes së rezultateve, si dhe ankimeve, apo çdo element tjetër për të garantuar një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve.

IV. INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI

Komunikimi luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe kontrollin e aktiviteteve të njësisë. Punonjësit e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë pjesë e rrjetit të komunikimit dhe komunikojnë nëpërmjet tij (info@kpk.al). Përgjatë auditimit, nuk u konstatuan raste të mungesës së komunikimit horizontal efektiv të brendshëm.

Sa i përket *komunikimit me jashtë*:

Në nenin 12 të Rregullores së brendshme, janë përcaktuar detyrat funksionale të *Koordinatorit për median dhe marrëdhëniet me jashtë*, ku ndër të tjera përfshihet komunikimi i informacioneve me interes ndaj medias dhe publikut, përgatitja e informacioneve zyrtare, buletineve periodike me qëllim transparencën ndaj publikut, si dhe u mundëson mediave vizive, të shkruara dhe online, të drejtën për t’u njohur me informacionin publik.

Në nenin 13 të Rregullores së brendshme janë përcaktuar detyrat funksionale të *specialistit për pritjen me popullin*, ku ndër të tjera përfshihet realizimi i pritjeve me popullin, mbajtja dhe përditësimi i regjistrit të denoncimeve, raportimi pranë kryetarit të institucionit lidhur me denoncimet e marra në dorëzim.

V. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Komponenti i pestë i kontrollit të brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficiente me kalimin e kohës. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të MFK-së bëhet nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Vetëvlerësimi

Neni 18 i Ligjit nr. 10296, datë 10.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, përcakton se NA i njësisë publike depoziton te titullari i njësisë raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt i vitit aktual. NPA, më tej, përgatit dhe depoziton te Ministri i Financave raportin vjetor të konsoliduar jo më vonë se fundi i muajit prill.

Nga auditimi u konstatua se, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dërguar pranë Ministrit përgjegjës për financat deklaratat dhe raportin vjetor, së bashku me pyetësorët e vetëvlerësimit, si më poshtë:

- Për vitin 2018 nëpërmjet shkresës nr.1763 prot, date 25.02.2019;
- Për vitin 2019 nëpërmjet shkresës nr.7693/5 Prot , date 18.2.2020;
- Për vitin 2020 nëpërmjet shkresës nr.Prot.1552 date 17.02.2021;
- Për vitin 2021 nëpërmjet shkresës nr.671 Prot, date 16.02.2022;
- Për vitin 2022 nëpërmjet shkresës nr. 639 Prot, date 14.02.2023;
- Për vitin 2023 nëpërmjet shkresës nr.473 Prot., date 14.02.2024.

Nga KPK çdo vit brenda afateve të përcaktuara ligjore janë dërguar Raportet e monitorimit të buxhetit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT